Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 7 (99). KORRIK 2014. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.



Market KEN

Laprakë, Tiranë
Tel: +355 4 22 50 480
Cel. 068 20 36 394

REPORTAZH

Me ëndrrën amerikane në Radomirë

Nga **BUJAR KAROSHI** - FAQE 6-7

VENDLINDJA

Peladhia, një emër që vjen nga legjenda

Nga **DESTAN RAMA** - FAQE 11

HOMAZH

Tani do të jemi edhe pa Naimin

Nga **XHAFER MARTINI** - FAQE 15

BLOGER

Ç'kemi asaj Dibre!

Ditari i një vajze:

Për një burrë

FAQE 10

MIRATOHET NDARJA E RE ADMINISTRATIVE-TERRITORIALE

Qarku i Dibrës me 4 bashki: **Dibër**, **Bulqizë**, **Mat** dhe **Klos**



Në prag të votimit në parlament dhe pas tij, vazhdojnë pakënaqësitë ndaj ndarje së re: Nuk janë marrë parasysh sugjerimet gjatë konsultimeve publike! Në momentin e fundit Klosi miratohet si bashki më vete. Cilat janë avantazhet e ndarjes së re dhe çfarë mendojnë kundërshtarët? Kryeministri Rama: Një hap i madh drejt një atdheu modern

Një kronikë speciale se si rrodhën ngjarjet. Intervista dhe opinione të posaçme nga deputeti Sherefedin Shehu, kryetari i Shoqatës së Komunave Agron Haxhimali, kryetari i komunës Maqellarë Bardhyl Agolli si dhe opinione nga Besnik Alku, Flamur Bala dhe Kasem Muça.

SPECIALE NE FAQET 2,3,4,5,16

Interviste me gazetarin sportiv Defrim Methasani

Profesioni i gazetarit – një mundësi për të njohur njerëzit

Sporti në Shqipëri dhe kudo, ka lidhje me ekonominë dhe financat. Një sport i suksesshëm, nuk mund të bëhet vetëm me dëshirë apo pasion, por do mbështetje financiare. Para disa vitesh mora nismën dhe mblodha 20 biznesmenë dibranë në Tiranë, vendosëm edhe piketat e bashkëpunimit, por kjo "flakë" u shua shpejt për fat të keq. Ndoshta është koha dhe vendi për t'u bërë tani, sepse po shuhet tradita e bukur sportive në Dibër. Më dhemb "Korabi" dhe sporti dibran...

Njerëz si vëllezërit Keta i kam parë jo thjesht si sportistë që arrijnë rezultate apo fitojnë një trofe, por si ambasadorë të vlerave tona kombëtare. Vëllezërit Keta unë s'i kam parë si dibranë, por si shqiptarë dinjitozë, si djem të guximshëm, që në mes të Gjermanisë ngrenë flamurin shqiptar dhe flasin shqip duke falënderuar vendin që i lindi dhe rriti. Të tillë njerëz nuk duhen promovuar dhe mbështetur vetëm nga ne, gazetarët, por së pari nga shteti dhe gjithë opinioni sportiv dhe qytetar...

Përmes rastit të Ambrës, përmes dhimbjes, gjeta shumë humanistë, njerëz të panjohur që m'u bënë familjarë, gjeta një popull që na mbështeti dhe një komb si Gjermania që vuri dorën në zemër, mësova shumë për Dibrën, që ishte pararoja, Shkodrën, Dibrën e Madhe, Tiranën, Durrësin, gjithë Shqipërinë... Gjej rastin t'ju shpreh mirënjohjen time të madhe të gjithë atyre që na kanë ndihmuar dhe na kanë lehtësuar këtë dhimbje dhe uroj që Ambra të rikthehet sa më shpejt fituese...

Bisedoi: **SASHENKA NDREKA** - FAQE 8-9



FALËNDERIM

Ne, familjarët e të ndjerit Prof. Nuri Abdiu, që para disa kohësh humbëm njeriun tonë më të dashur, ndjehemi të obliguar ndaj qëndrimit të mjaft miqve, shokëve dhe sidomos ndaj mjaft vëllezërve dibranë dhe ndaj stafit të Shoqatës Lidhja e Intelektualëve Dibranë, ndaj stafit akademik të Universitetit "Albanian University", ndaj shumë personave që përbënin shoqërinë e tij në të gjitha trojet shqiptare, për kujdesin dhe dashurinë e shprehur për humbjen e tij.

Në këto rrethana, ju shprehim të gjithëve falënderimet tona më të sinqerta për nderimet që i bëtë Nuriut, e në të njëjtën kohë ju premtojmë se do të jemi njëlloj si ai, vëllezër, miq e shokë të dashur për të gjithë, ashtu siç ishte vetë Nuriu.

Fitnete Abdiu, Ismet Abdiu, Fehmi Abdiu.

cyan magenta yelloë black 1

Rruga e Arbërit nr. 99

aktualitet

Kryeministri Rama në parlament: "Kjo reformë rrit cilësinë e shërbimeve për qytetarin. Shkurtojmë 6 herë numrin e njësive vendore, por asnjë zyrë komunale që sot jep shërbimet e përditshme për komunitetin nuk do të mbyllet. Përkundrazi, modernizimi i shërbimeve pranë çdo komuniteti, përmes zyrave aktuale të komunave të sotme, është pjesë e fazës së dytë të kësaj reforme".

Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 7 (99). 1 - 31 Korrik 2014

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.
Njoftojmë zotërinjtë: Sejdi M.Gashi, H.Shehu, L.Bica, R.Gjini, A.Keta, F.Xhani, S.Mëziu, H.Përnezha, M.Buci, J.Selmani, D.Tërshalla, se shkrimet e tyre janë në redaksi dhe do të shqyrtohen për botim në numrat e ardhshëm.
Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.

Shkrimet priten në redaksi deri më **datë 20** të muajit.

Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**

JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN "ë".

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:

Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra

Kontribuan për këtë numër:

Sashenka NDREKA
Xhafer MARTINI
Fejzulla GJABRI
Petrit FETAHU
Ahmet ÇAUSHI
Mevlud Buci
Besnik ALKU
Mentor HOXHA
Hysen REPA
Ilmi DERVISHI
Beqir SINA
Destan RAMA
Shpëtim CAMI
Ali HOXHA

Arkivi i gazetës është pa pagesë në faqen e internetit **www.rrugaearberit.com.**

Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.

Pajtimet në gazetë mund t'i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.

Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t'i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:
Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit
Nr. llog. në lekë: 4700036640
IBAN: AL90202112190000004700036640

Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

Nga **BUJAR KAROSHI**

Në prag të votimit në parlament dhe pas tij, vazhdojnë pakënaqësitë ndaj ndarje së re territoriale: Nuk janë marrë parasysh sugjerimet gjatë konsultimeve publike! Në momentin e fundit Klosi miratohet si bashki më vete. Cilat janë avantazhet e ndarjes së re dhe çfarë mendojnë kundërshtarët? Kryeministri Rama: Një hap i madh drejt një atdheu modern!

Ndërsa ndarja e re territoriale u miratua me 88 vota në parlament më 31 korrik, debati për të nuk është mbyllur. Ndërkohë, komuna të ndryshme në vend janë ngritur në protesta, madje kanë kërkuar edhe referendume lokale. Dhe përgjigjet për shumë pyetje të ngritura gjatë kohës kur ligji ishte në debat publik, apo ditë para se të miratohej, nuk kanë marrë akoma përgjigje. A është një reformë që do t'i shërbejë vendit? A u krye ajo vetëm për qëllime politike? Cilat ishin kriteret e ndarjes territoriale? A u zbatuan kriteret e bëra publike? Si u krye diskutimi publik për reformën dhe a do të jetë funksionale? Dhe shumë pyetje të tjera që qytetarë dhe shoqëria civile i bënin gjatë procesit të konsultimeve për ligjin.

KONSULTIMET PUBLIKE - REALE APO FARSË?

Gjatë procesit të mbledhjes së informacionit për ndarjen territoriale, kërkova informacion përmes emailit nga Denis Lushi, koordinator rajonal pranë projektit STAR dhe UNDP Albania, projekt i asistencës teknike, i cili është marrë me të gjitha etapat e reformës së re administrativo-territoriale. Përgjigja e tij ishte se "çdo gjë që flet mbi reformën territoriale gjenden në faqen ëëë.reforma-territoriale.al si dhe faqet e facebook.... Aty gjeni tërë informacionet e nevojshme. Sa për Dibrën, siç është bërë edhe publike në shtyp, është miratuar tashmë nga Komisioni i Posaçëm Parlamentar për RAT dhe nga Këshilli i Ministrave versioni i ndarjes me 61 njësi vendore".

Ndërsa pyetjes se "çfarë avantazhesh do të ketë kjo ndarje për qarkun e Dibrës", nuk iu dha përgjigje.

Për qarkun e Dibrës është e vështirë të gjesh informacione, edhe në faqen ueb të hapur posaçërisht. Përveçse një lajmi për takimin e Burrelit të ministrit Bledi Çuçi më 27 qershor, për konsultimet në Peshkopi është një video, e cila mezi dëgjohet dhe është e regjistruar krejt në mënyrë amatore. Në takimin e Burrelit theksohet se ndarja e re administrative, parashikohet të sjellë një rritje të investimeve në 60% për qarkun e Dibrës.

Në debatin publik të bërë me shoqërinë civile në Peshkopi nuk merr pjesë asnjë nga kryetarët aktualë të pushtetit vendor. Disa këshilltarë lokalë dhe disa anëtarë të shoqërisë civile përpiqen të bëjnë pyetje dhe të kuptojnë më shumë për reformën, por përgjigja që vjen nga dy zonjat e Ministrisë së Shtetit për Çështjet Vendore janë "që këto do shihen në një fazë të mëvonshme".

Hysen Uka, një aktivist i shoqërisë civile, shtron pyetjen në këtë takim nëse për ndarjen e re territoriale, a janë marrë parasysh resurset natyrore të qarkut, planet e investimeve dhe zhvillimin e rajonit? P.sh. a do të ishte funksionale kjo ndarje, në rastin e ndërtimit të rrugës së Arbërit? Po në rast të ndërtimit të hidrocentralit të Skavicës?

Ndërsa Moisi Murra, kryetar i Shoqatës së Historianë Dibranë kërkon të dijë nëse, duke u bazuar në kriteret kulturore e historike, a duhet të jetë komuna e Steblevës në qarkun e Dibrës?

"Komuna e Steblevës, - thotë Moisi Murra, për çështje tërësisht elektorale i ka kaluar rrethit të Librazhdit. Kjo komunë aktualisht përfshin fshatrat Llange, Fushë Studen, Zabzun, Borovë, Sebisht, Steblevë dhe Prodan. Qendra e Komunës, edhe pse quhet komuna e Steblevës, është në Fushë Studen. Me reformën aktuale komuna i mbetet Librazhdit, por nga ana historike, kulturore, etj., ata nuk kanë asnjë lidhje me Librazhdin. Tani që është bërë dhe rruga Librazhd - Ura e Cerenecit, për çdo shërbim më shpejt vijnë në Bulqizë sesa shkojnë në Librazhd."

Megjithëse konsultimet publike janë kryer, propozimet e marra në këto konsultime nuk janë marrë parasysh. Dhe kjo ngaqë ishte krijuar përshtypja se, pavarësisht se çfarë propozimesh ishin marrë, ndarja e re territoriale do të ishte me 30, 39 ose 47 zona funksionale. Në rastin e parë Qarku i Dibrës përbëhej me 2 bashki: Mat dhe Dibër, ndërsa në rastin me ndarjen në 39 dhe 47 zona funksionale, qarku përbëhej me 3 bashki: Dibër, Mat dhe Bulqizë.

Flamur Bala dhe Kasem Muça, dy ish drejtues lokalë në Klos dhe Xibërr, më 31 maj i kanë shkruar Ministrisë së Çështjeve Vendore dhe kanë kërkuar që Klosi me fshatrat përreth të jenë bashki më vete. Dhe për këtë, ata kanë përmendur vetëm kritere historike dhe kulturore. Nuk jemi në gjendje të themi nëse dy zotërinjtë e mësipërm kanë marrë pjesë në konsultimet publike, por fakti që Parlamenti vendosi që Klosi të jetë njëra nga 61 bashkitë e Republikës së Shqipërisë, duket sadopak të ketë pasur ndikim edhe propozimi i tyre. Kjo vërteton edhe thënien se "e shkruara mbetet", ndërsa xhirimet amatore të debateve treguan vetëm dukjen.

Debati i vërtetë për reformën administrativo-territoriale duket se u zhvillua vetëm pak ditë para miratimit në Parlament, ku komisioni parlamentar, për hir të disa marrëveshjeve politike me grupimet brenda partisë apo me parti në opozitë, e dyfishoi numrin e njësive vendore nga 30 në 61 bashki. Qarkut të Dibrës iu shtua bashkia e Klosit, por për kriteret që përdori komisioni, duke u krahasuar me qarqe të tjera, p.sh. Gjirokastrën, duhej që Dibra të ishte së paku 6-7 njësi vendore.

Disa ekspertë thonë se pavarësish emërtimit si "zona funksionale", me ndarjen e re administrative bashkitë e reja vetëm funksionale nuk janë.

PSE DUHET REFORMA? PËRFITIMET

Qeveria shqiptare që në fillim theksoi nevojën e një reforme territoriale, me synimin për të vendosur kontrollin mbi territorin. Numri i madh i njësive vendore dhe mungesa e zbatimit të ligjit në funksionimin e tyre, lind nevojën për një shkurtim të numrit të komunave dhe bashkive.

Me anë të kësaj reforme, qeveria shqiptare synon të fuqizojë njësitë e qeverisjes vendore, duke rritur kapacitetin e tyre për të ofruar shërbime të një cilësie të lartë për qytetarët dhe duke rritur efiçencën e menaxhimit të burimeve të kësaj qeverisjeje.

Ajo përcaktoi tre objektiva të kësaj reforme që janë:

Së pari, përmirësimi i shërbimeve për qytetarët në nivel vendor. Reforma Administrativo-Territoriale do të çojë në rritjen e efiçencës administrative, profesionale dhe teknike të qeverisjes vendore për të ofruar shërbime më të mira për qytetarët dhe në përmirësimin e aftësisë së tyre për të vënë punonjës të aftë në shërbim të publikut.

Së dyti, rritja e efiçencës dhe mirëqeverisjes në nivel vendor. Reforma do të çojë në përmirësimin e mirëqeverisjes dhe ofrimit të shërbimeve publike më efiçente nga qeveritë vendore; mbledhjen më efektive të taksave dhe tatimeve nga to; mundësi më të mira për të promovuar zhvillimin ekonomik lokal dhe shmangien e politikave që pengojnë zhvillimin e komuniteteve fqinje.

Së treti, fuqizimi i qeverisjes vendore, qytetarëve dhe komuniteteve. Reforma synon të fuqizojë qeverisjen vendore përmes decentralizimit të më shumë funksioneve dhe kompetencave dhe alokimit të më shumë fondeve publike. E organizuar në njësi më të mëdha, qeverisja vendore do të ketë më shumë mundësi për të marrë pjesë në projekte të bashkëpunimit ndërkombëtar, për të tërhequr më shumë fonde nga BE dhe donatorë të tjerë, për të negociuar me qeverinë qendrore dhe për bashkëpunim më të gjerë mes bashkive e komunave.

KRITERET E BËRA PUBLIKE DHE RESPEKTIMI I TYRE

"Procesi i ndarjes administrativo-territoriale do të fillojë nga "rrethet", si njësi bazë e qeverisjes vendore", thuhet në ueb-in e hapur për reformën. "Njësi të reja bazë të qeverisjes vendore mund të krijohen brenda kufijve të rrethit, ose nga territore të dy ose më shumë rretheve, nëse plotësohen kriteret si "zona funksionale". Kritere të tjera janë distanca e territorit me qendrën, vazhdimësia territoriale, numër të konsiderueshëm banorësh, traditat historike dhe lidhjet tradicionale mes banorëve, kufijtë e komunave që bashkohen me njësitë e reja nuk mund të ndahen, etj. Kriteret parashikonin edhe përjashtime për raste të veçanta, kur ishte e nevojshme marrja në konsideratë e praktikave më të mira ndërkombëtare për mbrojtjen e minoriteteve etnike.

RASTI I QARKUT TË DIBRËS. KRITIKAT

Pikërisht këto kritere duket se nuk janë marrë parasysh për rastin e Qarkut të Dibrës. P.sh., komuna e Maqellarës, në përbërje të së cilës aktualisht ka 22 fshatra, është një nga komunat më të mëdha dhe aktualisht ka të regjistruar sipas censusit të vitit 2011 rreth 11 mijë banorë, ndërsa sipas të dhënave të regjistrit të gjendjes civile ka rreth 1400 banorë. 1500 prej tyre jetojnë dhe punojnë në perëndim, kryesisht në Itali. Të ardhurat e sjella prej tyre e kanë ndryshuar shumë infrastrukturën e fshatit, me ndërtime të reja, bashkëkohore dhe shumëfunksionale. Me ndarjen e re, mesatarisht, një komunë e Gjirokastrës do të ketë 10 mijë banorë, dhe sipas këtij raporti, Maqellara duhet të jetë komunë më vete.

"Komuna humbet identitetin e saj dhe të banorëve. Ne, historikisht, asnjëherë nuk kemi qenë në një njësi vendore apo pushteti me Peshkopinë apo komuna të tjera të rrethit Dibër", - thotë Bardhyl Agolli, kryetari aktual i komunës së Maqellarës, dhe i fundit në

reforma

MIRATOHET NDARJA E RE ADMINISTRATIVE-TERRITORIALE

Qarku i Dibrës me 4 bashki: **Dibër**, **Bulqizë**, **Mat** dhe **Klos**



Debati i vërtetë për reformën administrativo-territoriale duket se u zhvillua vetëm pak ditë para miratimit në Parlament, ku komisioni parlamentar, për hir të disa marrëveshjeve politike me grupimet brenda partisë apo me parti në opozitë, e dyfishoi numrin e njësive vendore nga 30 në 61 bashki. Qarkut të Dibrës iu shtua bashkia e Klosit, por për kriteret që përdori komisioni, duke u krahasuar me qarqe të tjera, p.sh. Gjirokastrën, duhej që Dibra të ishte së paku 6-7 njësi vendore.

historikun e saj të ekzistencës. "Komuniteti humbet shërbimin e afërt dhe të shpejtë, humbet shumë kohë dhe shpenzime për shërbime në Peshkopi, humbet vëmendjen totale të qendrës që do të jetë larg Maqellarës, humbet investimet e mëdha apo të vogla qofshin, humbet vende pune, humbet perspektiven që Maqellara të shndërrohet në një qendër urbane, siç ka nisur të bëhet, humbet perspektivën e biznesit dhe interesin e tij për investime në këtë komunë, humbet popullsinë, e cila do të fillojë të zhvendoset drejt qendrës urbane të re, e shumë të tjera", - thekson Agolli.

Agron Haxhimali, drejtor ekzekutiv i Shoqatës së Komunave dhe që e njeh mirë rajonin e Dibrës, thotë për gazetën Rruga e Arbërit se "Shoqata e Komunave ka bërë studime mbi ndarjen territoriale dhe mbi përmbushjen e funksioneve nga njësitë vendore, duke angazhuar ekspertët më të mirë vendas dhe të huaj, bazuar në analizat dhe në njohuritë tona, në informacionet dhe konsultimet me të zgjedhurit vendorë, duke e ndjekur këtë proces hap pas hapi dhe bazuar në propozimet e ardhura nga komuna, komunitete dhe grupe interesi në qarqe të ndryshme, propozuam që ndarja e re territoriale të jetë me 89 njësi vendore. Për qarkun e Dibrës, - thotë ai, - ne kemi propozuar të shtohen tre njësi të reja vendore që janë Bashkia Maqellarë me komunat Maqellarë dhe Melan, Bashkia Kastriot me komunat Kastriot, Fushë-Çidhën, Sllovë dhe Kalaja e Dodës dhe Bashkia Arras me komunat Arras, Selishtë, Muhurr, Lurë, Zall Dardhë dhe Reç".

Të një mendimi me këtë ndarje janë edhe shoqata të tjera dibrane të shoqërisë civile, por që propozimet e tyre nuk mundën të gjejnë hapësirë në komisionin e posaçëm parlamentar dhe diskutimet në seancat plenare. Shoqata "Çidhna dhe Kastriotët" u përpoq të bashkonte shoqatat që operojnë në Dibër dhe të dërgonte në Parlament një mendim mbi ndarjen territoriale, por ata u kujtuan vetëm pak ditë para se ligji të shkonte për miratim. Tre deputetët e opozitës së Dibrës munguan në debatin për këtë çështje, ndërsa deputetët e PS dhe të LSI duket se ishin dakord me ndarjen e propozuar. Deputeti i Dibrës, Sherefedin Shehu, në një intervistë për gazetën "Rruga e Arbërit" theksoi se "ndarja e re territoriale është një "rezultat në tavolinë" dhe nuk plotëson asnjë kriter të reformës".

"Qarku i Dibrës është ndër më të dëmtuarit nga kjo reformë, po të kemi parasysh dy faktorët kryesorë që përcaktojnë ndarjen territoriale: popullsinë dhe terrenin, - thekson deputeti Shehu. Po të analizojmë terrenin nga pikëpamja e shtrirjes gjeografike dhe e relievit, qarku i Dibrës jo vetëm që është diskriminuar, por do të ketë edhe më pak mundësi për zhvillim".

Kritikët e reformës thonë se bashkitë e reja do të jenë shumë të mëdha dhe nuk do të munden të jenë funksionale. Periferitë do të jenë të izoluara dhe do të vuajnë mungesën e investimeve, ndërkohë që aktualisht nuk është e qartë se si do të përfaqësohen ato në këshillat bashkiakë."

Gjithashtu, kritikët thonë se nuk është e qartë nëse do të ketë ndryshime të tjera dhe a parashikohen ndryshime kushtetuese për mënyrën se si do të funksionojnë qarqet?

Në planin politik, një kryetar bashkie tani merr më shumë peshë se një deputet, kështu që në qoftë se deri më sot deputeti ndikonte, qoftë edhe formalisht, në përzgjedhjen e kandidaturave për kryetarë të njësive vendore dhe përbërjen e këshillave bashkiakë, a mund të ndodhë e kundërta: që kryetarët e bashkive të kenë ndikimin e tyre në përzgjedhjeve e kandidatëve për në Parlament? Në rastin e parë gjithçka ishte e gabuar dhe antiligjore, por edhe në rastin e dytë hipotetik, kjo sërish është e gabuar dhe do ta minojë funksionimin e pushtetit lokal. Nga një kryebashkiak të pafuqishëm e të pazotin, kthehet në një bashkiak të fuqishëm dhe të frikshëm me pushtetin që mund të marrë, duke vënë në rrezik demokracinë lokale.

MIRATIMI NË PARLAMENT. RAMA: NJË HAP I MADH DREJT NJË ATDHEU MODERN

"Sapo është votuar me shumicë dërrmuese reforma historike e riorganizimit administrativ të Shqipërisë! Një hap i madh drejt një atdheu modern", - shkroi Kryeministri Edi Rama në Tëiter, menjëherë pas miratimit të ligjit në Parlament me një shumicë dërrmuese prej 88 votash.

"Kjo reformë e demokratizon më tej qeverisjen vendore; çliron energji të reja dhe të mëdha transformuese për ekonominë vendore; krijon kushtin e munguar për dy dekada të zhvillimit të integruar urban dhe social; godet në mënyrë kapilare korrupsionin elektoral, tribalizmin e politikës vendore, papërgjegjshmërinë sistematike në administrimin e burimeve natyrore dhe financiare anembanë territorit të Shqipërisë. Kjo reformë çliron qytetarin si përgjegjësi e vullnet individual; krijon hapësira, deri dje të pamundura, në frymën dhe në veprimin e bashkëjetesës së bashkësisë qytetare; goditet pabarazia organike mes qytetarësh të nivelit të parë dhe të dytë, që ka krijuar sistemi i falimentuar i organizimit të derisotëm territorial dhe kuron rrënjësisht diskriminim, tërësor, të shumë komuniteteve të vogla apo të largëta. Kjo reformë garanton kalimin nga një Shqipëri arkaike, shërbimesh të falimentuara për qytetarin dhe komunitetet, në një Shqipëri që sot fillon të organizohet për t'u bërë më tej, hap pas hapi, atdheu modern i shqiptarëve", - tha Kryeministri Edi Rama gjatë fjalës së tij në Parlament.

Kundërshtimet ndaj reformës ai i quajti "refuzim spontan, për shkaqe që nuk kanë lidhje fare as me projektin, as me progresin". "Kjo reformë rrit cilësinë e shërbimeve për qytetarin, theksoi ai. Shkurtojmë 6 herë numrin e njësive vendore, por asnjë zyrë komunale që sot jep shërbimet e përditshme për komunitetin nuk do të mbyllet. Përkundrazi, modernizimi i shërbimeve pranë çdo komuniteti, përmes zyrave aktuale të komunave të sotme, është pjesë e fazës së dytë të kësaj reforme".

Kryeministri theksoi se me reformën do të ketë mundësi më të mira shërbimesh në arsim, në infrastrukturën shkollore, në shëndetësi, në mbështetjen sociale, në kulturë, në sigurinë publike, etj. "Riorganizimi, na jep mundësinë të racionalizojmë në mënyrë krejt tjetër burimet tona njerëzore dhe të gjithë sistemin e shërbimeve në këtë vend", - theksoi ai.

"Ne hapim një kapitull të ri për ta ndërtuar Shqipërinë tjetër në realitet, duke u dhënë njerëzve mundësinë që të jenë të lirë, që të shpëtojnë nga dhuna e bajraktarëve të vegjël të njësive të vogla dhe nga presionet e tmerrshme për t'iu imponuar në mënyrën sesi të votojnë dhe që të kenë një pikë referimi qytetin... Ne po i japim mundësinë komuniteteve të organizohen dhe qeverisjes vendore të planifikojë një zhvillim ndryshe, një zhvillim të integruar".

Me anë të një pyetje retorike, kryeministri Rama jep përgjigjen se suksesi i kësaj reforme "do të varet nga zinxhiri i reformave të tjera. Do të varet nga vendosmëria me të cilën ne do të rindërtojmë gjithë sistemin e institucioneve".

Dhe sigurisht që për suksesin e reformës duhet pritur: së pari të kthehen në shtëpi ata që protestojnë dhe së dyti zgjedhjet e ardhshme lokale, për të parë se si do të funksionojë në terren ndarja e re administrative.

Rruga e Arbërit nr. 99
forum

"Të zgjedhurve në mënyrë të drejtpërdrejtë e me votë të lirë për të mbrojtur interesat e qytetarëve, shumë herë ju kundërvihen njerëz me vizion të ulët e qëllime jo të mira, duke i quajtur të zgjedhurit vendorë me epitete si bajraktarë, agallarë, bejlerë, njerëz që i kundërvihen kësaj reforme, sepse sipas tyre, atyre ju preken interesat e tyre dhe pushteti që kanë aktualisht. Kjo nuk është aspak e vërtetë, pasi të zgjedhurit vendorë janë aty për të mbrojtur në radhë të parë interesat e qytetarëve që i kanë votuar për sot, por edhe për të ardhmen, kur dihet se këta kryetarë nuk do të jenë më në funksionet e tyre".

FLET AGRON HAXHIMALI, DREJTOR EKZEKUTIV I SHOQATËS SË KOMUNAVE TË SHQIPËRISË

"Qeveria nuk i mori parasysh propozimet tona"

- Shoqata e Komunave është marrë prej kohësh me studimin për reformën territoriale, dhe për këtë ju keni pasur edhe mbështetjen e qeverisë suedeze. Çmund të na thoni për kërkimin tuaj?

A.Haxhimali: Studimi ynë nuk ka pasur synim të drejtëpërdrejtë ndarjen territoriale. Kriteret që ne kemi përdorur bazoheshin në kartën evropiane të vetëqeverisjes vendore dhe Kushtetutën e Shqipërisë. Komunitetet dhe banorët e njësive vendore ftoheshin të konsultoheshin në një proces të gjerë e gjithëpërfshirës dhe të vendosin vetë për mënyrën si duhet të krijojnë zona funksionaliteti, për mënyrën si duhet të krijojnë njësi organike, pa prishur identitetin dhe natyralitetin e tyre.

Në projektin me suedezët, në analizat që ne kemi bërë, na rezulton se është e nevojshme dhe e domosdoshme që njësi vendore me një popullsi të vogël, njësi vendore në thellësi dhe në zona të largëta të mund t'u bashkohen njësive të tjera me të cilat munden të krijojnë një ekonomi shkalle, për të rritur të ardhurat dhe mirëqenien e atyre zonave.

Parimi kryesor në studimin tonë ishte parimi i vullnetarizimit, pra qeveria të gjente gjuhën e përbashkët dhe të inicionte projekte për t'i ftuar këto njësi vendore, këto komunitete që të bashkohen, gjithmonë mbi baza vullnetare.

Hapi i dytë ishte një opsion tjetër, që të përcaktonim një numër, një kriter bazë për popullsi dhe, le të themi, për komunat nën 3 mijë banorë të shkriheshin me komunat që kanë popullsi më të madhe. Kështu do të reduktoheshin numri i njësive vendore.

Një opsion tjetër ishte të rishikonim funksionet e njësive vendore, pra t'i linim njësitë ashtu siç ishin dhe të rishikonim funksionet e tyre, ose ti dekoncentronim apo ti ekocentronim. Një pjesë e funksioneve që ato nuk i kryejnë le t'ia delegonin një niveli tjetër të qeverisjes vendore ose pushtetit vendor. Ato njësi vendore mund të ekzistonin me funksione të reduktuara por dhe me buxhete të reduktuara, por me aq sa do ekzistonin do të kryenin shërbimet minimale për komunitetin.



Ky studim, në të gjitha rastet që ne themi, duke reduktuar ose duke bërë bashkimin e komunave të vogla me komunat e mëdha apo rreth bashkive në qendër, do të çonte në një përgjysmim të numrit të njësive vendore në të gjithë Shqipërinë. Por me mesatare ne na rezultonte që në çdo qark është e nevojshme të ketë njësi shërbimi, siç është bashkia ose komunat, dhe kjo duhet të varionte në 7 - 8 njësi për çdo qark. Këtu synonim që këto njësi të ishin konkurruese me njëra-tjetrën brenda dhe jashtë qarkut. Nga studimi kishim përcaktuar studimet që popullsia e një njësie vendore të ishte nga 25 mijë deri në 35 mijë banorë.

Varianti i sotëm ka krijuar një disekuilibër të madh, duke krijuar shumë bashki të reja të vogla dhe shumë bashki të reja shumë të mëdha, pra e ka polarizuar nga njëri ekstrem në ekstremin tjetër.

- Megjithatë, ligji kaloi në parlament dhe qarku i Dibrës ka 4 njësi vendore. Cili ishte propozimi juaj?

- Unë e njoh mirë qarkun e Dibrës dhe komunat e Dibrës, pasi prej vitesh i kam vizituar disa herë dhe kam marrëdhënie shumë të mira me të zgjedhurit vendorë në atë qark.

Mendoj që qarku i Dibrës, përveç pozitës natyrore, përveç burimeve që ka, të ardhurave që siguron, për vet natyralitetin, kulturën, etj. duhet të kishte një rigrupim tjetër.

Në mënyrë që të kemi një qendër urbane siç është Peshkopia, një nga bashkitë e mëdha të qarkut, e cila duhej të zgjerohej me komunën qendër Tomin dhe Luzni, dhe kjo njësi bëhej me një popullsi 30-35 mijë banorë. Pastaj Bulqiza që zgjerohet me satelitët e saj komunë dhe kjo bënte rreth 35 mijë banorë. Klosi bashkë me komunat bashkangjitur është një njësi shumë e mirë me 25-26 mijë banorë. Po kështu edhe Burreli me komunat bashkangjitur që kap një popullsi 30-32 mijë banorë.

Një identitet i fuqishëm, një njësi shumë e mirë vendore do ishte komuna Maqellarë, e cila duhej të bashkohej me komunën Melan dhe këto bëjnë një popullsi 20-22 mijë banorë. Një njësi tjetër që ishte krejt organike, krejt natyrale dhe krejt në një kontekst historik, do të ishte komuna apo bashkia Kastriot, me qendër në Kastriot, e cila do të përfshinte komunat Kastriot, Fushë-Çidhën Sllovë dhe Kala e Dodës. Por pjesa tjetër e njësive vendore, siç është Selishta, Muhurri, Arrasi, Lura, Zall-Dardha dhe Reçi, duhet të grupoheshin dhe të krijonin një njësi vendore me qendër në Arras. Popullsia e komunës do të ishte 20-23 mijë banorë, çka do të thotë është dyfish i bashkive që janë krijuar në rrethin e Gjirokastrës.

Pra, nga analizat që kam bërë kohët e fundit, duke analizuar të gjithë variantet e hedhura nga qeveria nga 33-61 njësi, referuar kërkesave, bisedave, mesazheve, telefonatave apo e-maileve që na vinin nga komuniteti i Dibrës, përfshirë të zgjedhurit vendorë, kryetarë apo këshilltarë, ne na rezultonte që organikisht, natyralisht apo nga ana e funkionalitetit, prakticitetit, ekonomisë, tregut, konkurrencës ndërmjet njësive vendore, zhvillimit të bizneseve etj., qarku i Dibrës, me një popullsi rreth 150 mijë banorë, duhej të kishte 7 bashki të reja.

Ka pasur një kërkesë që Komuna e Steblevës t'i rikthehet qarkut të Dibrës, për shkak të kritereve historike, kulturore etj. A e keni pasur ju në studimin tuaj këtë informacion?

Në sudimin tonë nuk jemi marrë me ndarjen territoriale të qarqeve, por me kriteret që duhet të përdoren. Në rastin konkret, ne kemi parashikuar që fshatra të veçantë, për shkak të kushteve natyrore, largësia nga qendra, infrastruktura rrugore, specifikat që mund të ketë, ky komunitet apo ky fshat duhet të përfshihet në hartën territoriale të njësisë ku ai merr shërbimet më kollaj.

FLET KRYETARI I FUNDIT I KOMUNËS MAQELLARË, BARDHYL AGOLLI

Maqellara duhet të ishte bashki më vete

Pyetje: Maqellara nuk do të jetë më komunë dhe kështu është në të gjitha variantet e propozuara zyrtarisht deri më tani. A mendoni se kjo është e mirë për komunitetin?

Bardhyl Agolli: E vërtetetë. Maqellara sipas të pesë varianteve të propozuara që në fillim të Ministrise së Çështjeve Vendore dhe Komisionit Parlamentar për Reformën Administrativo-Territoriale, nuk është më Komunë më vete dhe as nuk do të jetë komunë e bashkuar me njësi të tjera vendore me qendër në Maqellarë.

Edhe në variantin përfundimtar të ndarjes me 61 Bashki të miratuar në Komisionin Parlamentar për Reformën Administrativo-Territoriale, Maqellara nuk mbetet njësi më vete.

Ka qënë një propozim sipas Shtetiëb të Ylli Bufit, i cili propozonte që të formohet Bashkia Maqellarë me qendër në Maqellarë dhe që do të përfshinte përveç Maqellarës edhe Komunat aktuale të Shupenzës,Gjoricës,Ostrenit dhe Trebishtit, pra një njësi vendore që do të shtrihej në dy rrethe, në Dibër dhe Bulqizë, propozim që nuk është marrë në konsideratë nga shumica parlamentare.

Dua të theksoj se Komuna Maqellarë për nga numri i popullsise, aktualisht 14.000 banorë, vjen njësia vendore e trete në Qarkun Dibër, pas Bashkisë Peshkopi dhe Bashkisë Burrel, dhe kemi popullsi me të madhe se Bashkia Bulqizë dhe Bashkia Klos. Të ardhurat dhe grantet e Qeverisë i kemi shume herë më të vogla se njësitë e sipërcituara për faktin se ata kanë statusin e Bashkisë dhe ne të Komunës. Kujtoj se investimet dhe fondet qeveritare po bëhen gati dy vjet që nuk kemi marrë.

Pyetje: Çfarë përfitimesh do të kenë banorët e komunës suaj me ndarjen e re territoriale?

B.A.: Nuk besoj se do të ketë ndonjë përfitim.

Pyetje: Çfarë humbet komuna juaj me ndarjen e re?

B.A.:Komuna jonë në rradhë të parë humbet identitetin e saj dhe të banorëve të saj. Ne, historikisht, asnjëherë nuk kemi qenë në një njesi vendore apo pushteti me Peshkopinë apo komuna të tjera të rrethit Dibër. Shumë herët, në kohën e para Mbretërisë, kemi qenë nën juridiksionin e Dibrës së Madhe, dhe në kohën e Mbreterisë, komunizmit dhe demokracisë kemi qenë përherë komune apo njësi më vete.

Komuniteti humbet shërbimin e afërt dhe të shpejtë, humbet shume kohë dhe shpenzime për shërbime në Peshkopi, humbet vëmendjen totale të qendrës që do të jetë larg Maqellarës, humbet investimet e mëdha apo të vogla qofshin, humbet vende pune, humbet perspektiven që Maqellara të shndërrohet në një qendër urbane, siç ka nisur të bëhet, humbet prespektivën e biznesit dhe interesin e tij për investime në këtë Komunë, humbet popullsinë, e cila do të fillojë të zhvendoset drejt qendrës urbane të re, e shumë të tjera.

Pyetje: Sipas jush, cila do të ishte ndarja më e mirë territoriale për Dibrën?

B.A.:Sipas mendimit tim, dhe sipas përvojës si kryetar i Komunës së Maqellarës, ndarje më e mire për Dibrën do të ishte ndajra me katër Bashki: Bashkia Maqellarë me Maqellarën plus fshatrat e komunës Melan deri ne Llasen (Peshkopi); Bashkia Peshkopi ku përfshihen bashkia Peshkopi, komuna Luzni, fshatrat e Komunes Melan mbi Peshkopi si Bellova, Rabdishti etj., dhe komuna Qender; Bashkia Muhur me Komunat Muhur, Selishte, Zall Dardhë, Reç, Lure dhe Arras si dhe Bashkia Kastriot me komunat Kastriot, Fushë-Çidhën, Sllovë, Kala e Dodës.

Pyetje: Sa është buxheti vjetor i komunës suaj?

B.A.:Buxheti vjetor i Komunës është rreth 42 milionë lekë në total.

Pyetje: Sa janë të ardhurar nga taksat dhe tarifat vendore?

B.A.:Të ardhurat vjetore nga taksat dhe tarifat vendore shkojne 7,5 deri në 9 milionë lekë.

Pyetje: Në një rast hipotetik, n.q.s. komuna juaj nuk shkrihet, por ju kërkohet të shkurtoni buxhetin e shpenzimeve, çfarë reforme duhet të kryeni

B.A.:Tani për tani jemi komuna që kemi administratën më të vogël krahasuar me njësitë e tjera vendore të rrethit Dibër, ndërkohë që popullsinë e kemi shumë më të madhe se ato. Për shkurtimin e shpenzimeve mbetet të shihet se çfarë kompetencash do t'i kalojnë pushtetit vendor, dhe atëherë duhet parë edhe shkurtimi i mëtejshëm i strukturës.

Pyetje: Reforma u miratua të enjten në parlament. Cilat janë pikëpyetjet që ju nuk keni marrë akoma lidhur me ndarjen e re administrative?

B.A.: Pyetja e madhe qëndron në faktin se ç'do të bëhet me punonjësit e komunave që shkrihen, ku do të shkojnë ata, ç'do të bëhet dhe a do t'ju sigurohet vendi i punës atyre?

Po me kryetarët aktualë të komunave ç'do të bëhet? A do të kenë ata ndonjë status të veçantë, pasi mundësia për të qenë kandidatë apo kryetar është pothuajse e shuar. Të paktën, a do t'ju jepet vendi i punës që kanë patur para se të zgjidhen në postet e tyre?

Gjithashtu, ka paqartësi se si do të jetë përfaqësimi në këshillat vendore të ardhshëm. Si do të përfaqësohen komunat aktuale aty?

Ç'do të bëhet me kryetarët e fshatrave, a do të jenë përsëri apo do të hiqen edhe ata?

Po me Këshillin e Qarkut ç'do të bëhet? Do të mbetet ai apo jo, çfarë kompetencash do të ketë nëse mbetet, si do të përfaqësohen komunat aktuale në të?

Në kompetencë të kujt do të jenë arsimi, shëndetësia, tatimet, mjedisi, bujqësia, ndihma ekonomike, shërbimet, pyjet, veterinaria, rrugët etj.

- Deri ditën e sotme, kur reforma territoriale mori formë ligjore me vendimin në parlament, çfarë ju ka lënë, të themi, "një shije të keqe'?

B.A.: Së pari, dua të theksoj se unë në këtë intervistë, nuk flas në emrin tim personal, por flas në emër të komunitetit të Maqellarës, i cili ka qenë dhe është, edhe pse ka marrë miratimin e parlamentit, kundër shkrirjes së Komunës Maqellarë.

Dibra është rrethi më i goditur apo diskriminuar përsa i përket ndarjes së re territoriale, pasi një rreth kaq i madh si Dibra mbetet me një Bashki dhe rrethe apo njësi shumë më të vogla se Dibra janë ndarë apo janë krijuar bashki më vete me popullsi dhe sipërfaqe shumë më të vogël se Dibra.

Gjithashtu, kam parë me keqardhje një reagim kundër të zgjedhurve vendore, në lidhje me reformën territoriale. Të zgjedhurve në mënyrë të drejtpërdrejtë e me votë të lirë për të mbrojtur interesat e qytetarëve, shumë herë ju kundërvihen njerëz me vizion të ulët e qëllime jo të mira, duke i quajtur të zgjedhurit vendorë me epitete si bajraktarë, agallarë, bejlerë, njerëz që i kundërvihen kësaj reforme, sepse sipas tyre, atyre ju preken interesat e tyre dhe pushteti që kanë aktualisht. Kjo nuk është aspak e vërtetë, pasi të zgjedhurit vendorë janë aty për të mbrojtur në radhë të parë interesat e qytetarëve që i kanë votuar për sot, por edhe për të ardhmen, kur dihet se këta kryetarë nuk do të jenë më në funksionet e tyre.

Falëminderit!

reforma

FLET DEPUTETI I DIBRËS, SHEREFEDIN SHEHU:

Reforma territoriale, rezultat në tavolinë



Në foto: Sherefedin Shehu (PD), deputet i Dibrës.

Pyetje: Çfarë avantazhesh apo disavantazhesh do të sjellë reforma territoriale për Qarkun e Dibrës?

Sherefedin Shehu: Reforma territoriale që po bën Qeveria nuk mund të quhet e tillë, mbasi nuk plotëson asnjë standard të reformës. Ajo është një "rezultat në tavolinë" dhe që ka si produkt vizatimin e një harte të paracaktuar, duke u bazuar vetëm në llogaritjet elektorale të dy partive në pushtet dhe të PDIU, që po i vjen rrotull pushtetit.

Reformat e vërteta bazohen në përfundime të dala nga analiza dhe studime dhe fillojnë me strategji dhe plane veprimi, materializimi i të cilave adreson problemet e konstatuara. Në rastin e reformës territoriale shqiptare ka patur të paktën 4 studime serioze të kryera nga institute profesionale, të majta dhe të djathta, të mbështetura nga donatorë të rëndësishëm ndërkombëtarë, të cilat rekomandojnë përgatitjen e dokumentave strategjike për thellimin e procesit të decentralizimit dhe rritjen e eficencës së qeverisjes vendore, duke e reduktuar numrin e tyre në 80-100 njësi. Ndërsa qeveria bëri llogaritjet dhe kompromiset elektorale dhe e katandisi reformën në një hartë në të cilën numri i paracaktur 47 për njesitë e qeverisjes vendore u bë 61 në kompromis për të garantuar numrin e votave në Parlament sot dhe për të patur një aleat rezervë nesër.

Qarku i Dibrës është ndër më të dëmtuarit nga kjo reformë, po të kemi parasysh dy faktorët kryesorë që përcaktojnë ndarjen territoriale: popullsinë dhe terrenin. Po të analizojmë terrenin nga pikpamja e shtrirjes gjeografike dhe e relievit, qarku i Dibrës jo vetëm që është diskriminuar, por do të ketë edhe më pak mundësi për zhvillim. Mundesitë e zhvillimit do të kufizohen, mbasi kriteri i popullsisë i zbatuar për ndarjen e kufijve territorialë do të përdoret edhe për ndarjen e burimeve financiare. Kështu, zonat me territor të madh dhe përqendrim të vogël të popullsisë për njësi të sipërfaqes do të marrin me pak fonde nga shërndarja e buxhetit të shtetit, ndërkohë që territoret e mëdha dhe relievet e vështira kanë nevojë jo vetëm për më shumë fonde, por edhe për mbështetje specifike. Me ndarjen e re këto mundësi nuk ekzistojë, mbasi janë fshirë nga harta njësitë e qeverisjes vedore, të cilat për shkak të mungesës së burimeve dhe nevojave specifike përfitonin drejtpërsëdrejti financime të posaçme nga fondi i zhvillimit të rajoneve.

Një dizavantazh i theksuar, sidomos për qarkun e Dibrës dhe për disa të tjerë si ai, është mungesa e bashkive rurale. Kjo do të bëjë që zonat e pazhvilluara dhe ato malore të humbasin mundësitë për investime në infrastrukturë dhe projekte të tjera që nxisin zhvillimin e tyre. Ky fenomen do të vihet re menjëherë pas fillimit të veprimarisë së njësive gjigande, të cilat nuk kanë interes për periferinë e tyre. Ai është i paevitueshëm, mbasi përqëndrimi i popullsisë në zonat urbane do të prishë raportet e vendimmarrjes në këshillat e reja bashkiake të dominuara nga këshilltarët e zonave urbane. Kështu, fondet do të shkojnë atje ku ka më shumë vota dhe askush nuk do të jetë i interesuar për zhvillimin e zonave të thella dhe malore.

> Qarku i Dibrës është ndër më të dëmtuarit nga kjo reformë, po të kemi parasysh dy faktorët kryesorë që përcaktojnë ndarjen territoriale: popullsinë dhe terrenin. Mundësitë e zhvillimit do të kufizohen, mbasi kriteri i popullsisë i zbatuar për ndarjen e kufijve territorialë do të përdoret edhe për ndarjen e burimeve financiare. Kështu, zonat me territor të madh dhe përqendrim të vogël të popullsisë për njësi të sipërfaqes do të marrin me pak fonde nga shërndarja e buxhetit të shtetit, ndërkohë që territoret e mëdha dhe relievet e vështira kanë nevojë jo vetëm për më shumë fonde, por edhe për mbështetje specifike. Me ndarjen e re këto mundësi nuk ekzistojë, mbasi janë fshirë nga harta njësitë e qeverisjes vedore, të cilat për shkak të mungesës së burimeve dhe nevojave specifike përfitonin drejtpërsëdrejti financime të posaçme nga fondi i zhvillimit të rajoneve.

- Sipas projektit të miratuar në komisionin parlamentar, thuhet se Dibra mbetet një bashki, ndërkohe që mund të ishte e ndarë në 2 ose 3, duke marrë parasysh kriteret e popullsisë. Çfarë mendimi ke për këtë?

- Kombinimi i faktorëve unikë të përmendur më lart, sipërfaqja dhe popullsia, me konkluzione të e analizës së institututeve profesionale për përmirësimin e shërbimeve publike dhe rritjen e burimeve financiare lokale, rekomandojnë që rrethi i Dibrës duhet të ketë të paktën 3 njësi të qeverisjes vendore. Po të shtojmë këtu disa faktore specifikë si kultura, traditat, bashkëpunimi ekonomik, lidhjet sociale, etj., Dibra mund të këtë 4 njësi.

Në Dibër historikisht ka ekzituar një ndarje zonash, e cila është krijuar në shekuj. Kështu njihen ndarjet malësi dhe topallti, apo fushë, mal dhe zona ndërmjetëse. Po kështu, vetë zonat malore, për shkak të tregjeve, terrenit dhe të infrastrukturës, kanë krijuar lidhje ekonomike dhe sociale më të lokalizuara dhe që nuk kufizohen vetëm në zonë apo brenda rrethit të Dibrës. Të gjitha këto të kombinuara edhe me fakorët e numrit të popullsisë dhe të sipërfaqes do të ishin një bazë e mirë për të krijuar një numër të arsyeshëm dhe të qëndrueshëm të njësive të qeverisjes vendore në Dibër.

Krijimi i tre dhe me shumë njësive të qeverisjes vendore në Dibër do të ishte një mundësi më e madhe zhvillimi për këto zona dhe për Dibrën në përgjithësi. Këshillat e këtyre njësive do të ishin më të unifikuara në vendimmarrje dhe zonat e thella dhe të vështira do të kishin zërin e tyre për të kërkuar mbështetje direkte nga buxheti i shtetit. Ndërkohë, bashkitë rurale në shkallë vendi do të krijonin unionin e tyre dhe të lobonin së bashku për më shumë mbështetje dhe për projekte specifike zhvillimi. Nga ana tjetër, ndarja që po bën qeveria për Dibrën do të nxisë konflikete midis zonave ekzituese gjeo-kulturore dhe do të thellojë prapambetjen dhe izolimin e zonave të largëta dhe malore.

- Ka zëra që kërkojnë që Stebleva t'i rikthehet qarkut të Dibrës, ndoshta i bashkohet Bashkisë së Bulqizës, për shkak të kritereve kulturore e historike? Si mendoni ju për këtë?

- Kthimi i Steblevës në qarkun e Dibrës minimumi do të ishte një korrigjim gabimi, pasi zona e Gollobordës duhet konsideruar ashtu siç është në të vërtetë. Qeveria për interesat e saj e ka përdorur kriterin e klasifikimit të minoriteteve edhe në krijimin e njësive homogjene minoritare. Por në fakt, ndarja territoriale duhet të jetë një kombinim i faktorëve të zhvillimit, eficencës dhe lidhjeve etniko-kulturore. Në këtë këndvështrim, jo vetëm që Stebleva duhet t'i kthehet Dibrës, por do të ishte shumë e arsyeshme që e gjithë Golloborda të ishte një bashki më vete brenda qarkut të Dibrës.

opinion

Ja pse Klosi duhet të jetë bashki më vete

Nga **FLAMUR BALA, KASEM MUÇA**

Kjo hartë është një mundësi për ndarjen e re administrative. Kjo është ide e shfaqur nga unë, Flamur Bala, ish kryetar i bashkisë Klos dhe Kasem Muça, ish kryetar i komunës Xibërr. Shpresojmë të gjejë një mbështetje më të gjerë.

Në periudhat historike të hershme dhe më të vona është quajtur Kryemate (Krejmatja) por administrativisht nuk është emërtuar kështu, por në vitin 1923 u emërtua nënprefektura e Stragjut. Në periudhat e hershme historike është njohur si qendër e Arbërisë. Albano-Polisi, qyteti i hershem i Albanëve mund të identifikohet me kalanë ku lindi Skënderbeu, Petralbën. Malet me Gropa, Martaneshi, Xibrri, gjithë prapa Dajtit, Klosi i sotëm, Kurdaria dhe Gurra përbëjnë shtrirjen gjeografike përreth qytetit Ilir të Albanëve, që gjeografi grek Ptolemeu shënjoi në shekullin e dytë të erës tonë.



Klosi i sotëm së bashku me Martaneshin, me Xibrrat, me Gurrat kanë qenë njësi administrative më vete me qendër Klosin. Jemi emërtuar lokalitet dhe rreth më vete.

Nga viti 1945-1962, dy herë jemi emërtuar lokalitet (komuna Gurrë, komuna Kurdari, komuna Xibërr, komuna Martanesh dhe komuna Klos) të 5 komunat kanë përbërë lokalitetin e Klosit (Stragjut). Në vitin 1962 u bëmë përsëri nënprefekturë. U shpallëm rreth më vete. Në Klos ka patur komunitet ekzekutiv në vitet 1962 -1969.

Bashki me vete na faktorizojnë: tregu i përbashkët, rrjedha e lumit të Matit, etnografia, historiku arbënor, rruga e Arbrit, miqësitë familjare, marrëdhëniet e punës, llagapet etj.

Bashkia e re që formohet përbëhet nga dy qytete dhe 43 fshatra. Popullsia mbi 25000 banorë. Industria e kromit zë vendin kryesor në punësim. Në miniera punojnë më shumë se 1500 punëmarrës.

Klosi shquhet për prodhimin e barotit, veçanërisht nga shek XV-XVIII. Në Klos punonin 8 dinga baroti. Furnizohej me barot lufta për lirinë e Shqipërisë. 16 ura guri lidhnin Klosin në dy anët e lumit Mat. Ato sot janë vepra që na lidhin me historinë e shquar të Klosit.

Në vitin 1916 u hap shkolla e parë shqipe për gjithë rrethin e Matit në fshatin Bejn të bashkisë Klos. Çeta e parë partizane e Matit u ngrit në korrik të vitit 1942 në fshatin Klos-Katund të bashkisë Klos. Shkolla e parë 7-vjeçare e Matit u hap në qytetin Klos të bashkisë Klos. Në vitin 1973 Klosi u shpall qytet nga komiteti popullor. Në vitin 1983 u ndërtua kanali vaditës i Klosit, 32 km i gjatë dhe vadit 1200 ha. Në vitin 1923 Klosi ishte nënprefekturë. Krahina e Klosit (Stragjit) ishte më e madhja në 31 fshatra me 20351 banorë. Po në vitin 1923 bashkia Klos me kufijtë e sotëm kishte 3 komuna që drejtoheshin nga fiset më të fuqishme të Matit që banonin në Klos (komuna e Klosit, komuna e Darsit, komuna e Patinit).

Tregu i lashtë i Klosit (Stragjit) u vizitua në vitin 1850 nga albanologu Han. Ai thotë që ishte një treg shumë i populluar. Emërtimi Klos ka ardhur prej kalasë mesjetare me emër "Kilas" që përfaqëson një qytet kala në fshatin Klos-Katund të Klosit, afër Qafës së Buallit. Stragju në kuptimin e vjetër historik do të thotë "treg i stërlashtë". Karvanet e Dibrës dhe të lindjes kanë kaluar nëpër Klos për të mbërritur në Tiranë, Durrës apo perëndim.

(Ky opinion është marrë nga shtetiëb.com. Ajo është hedhur në forumin "CuriaËb" më 31 maj 2014 nga Flamur Bala. Titulli është zgjedhur nga redaksia).

Përgatiti faqet: **BUJAR KAROSHI**

reportazh



Me **ëndrrën amerikane** për fëmijët e Radomirës

Nga **BUJAR KAROSHI**

Në fillim të korrikut, për vite me radhë, djemtë e Radomirës, nga Tirana e Durrësi, por edhe në emigracion, nisen karvan, me këngë e valle, drejt Kalasë së Dodës në Festën e Korabit. Këtë vit, festa u "anulua" për shkak të Muajit të Ramazanit, por pa shumë zhurmë dhe bujë, shkuan në Radomirë, babë e bir, Lefter e Genti Daku, për t'u mësuar fëmijëve te fshatit gjuhën angleze. Në fakt, ideja ishte e Gentit, djalit 15 vjeçar, i lindur në Virginia të SHBA-së, por që e lidh me Radomirën origjina e babait. "Vitin e kaluar, - tregon Genti, themelova Klubin Multikulturor në shkollën time, përmes të cilit synoja që studentët të fitojnë më shumë njohuri rreth kulturave të ndryshme dhe çështjeve globale. Pas një suksesi të këtij klubi, mendova ta zgjeroj angazhimin tim, duke u lidhur me studentet në vendet e tjera".

Kështu, ai hodhi idenë e një kampi veror në Radomirë, me nxënës të shkollës 9-vjeçare."Si një amerikan i lindur nga prindër shqiptarë, jam në dijeni të vështirësive që bashkëmoshatarët e mi në Shqipëri hasin në jetën e tyre të përditshme. Për këtë arsye kam vendosur që të kontribuoj si vullnetar në organizimin e këtij kampi veror. Unë besoj se të mësuarit e një gjuhe globale, siç është anglishtja, krijon mundësi të mëdha për të ardhmen e të rinjve", - shkruan ai në faqen e hapur në ëeb, posaçërisht për këtë projekt.

Për projektin e tij, ai filloi të mblidhte edhe donacione, të cilat nuk munguan. Si fillim, 500 dollarët e parë ishin kontribut personal, të cilat Genti i kishte fituar në një konkurs për esenë më të mirë, në shtetin e Virxhinias, si fitues i vendit të parë. Pastaj vijnë donacione nga miq dhe shokë të shkollës, por edhe mesazhe inkurajuese. "Ju jeni duke bërë diçka të madhe dhe të rëndësishme, - shkruan Shefqet Meko, një gazetar i njohur shqiptar që tani jeton në Minesota. Ashtu si babai yt, unë jam lindur dhe rritur në Shqipëri. Ne kemi pasur ëndrra të mëdha, por mundësitë shumë të kufizuara. Amerika është një vend i madh, ku të gjithë mund të arrijnë ëndrrën e tyre amerikane".

Më ëndrrën amerikane Genti zbret në Shqipëri në mes të qershorit, bashkë me babain e tij, Lefterin, një djalë Radomire. Me vete kanë sjellë pothuajse të gjitha materialet e nevojshme për kampin e gjuhës angleze: metodat e anglishtes "Side by Side", fjalorë, libra të gramatikës angleze, fletore shënimesh, flamuj amerikanë dhe shqiptarë, shkumësa, stilolapsa, lapsa, bluza me logon e kampit, të dizenjuara prej vetë Gentit, por edhe topa futbolli "Addidas" me dizenjon e Botërorit të Brazilit.

KAMPI VEROR

Kampi filloi më 23 qershor në mjediset e shkollës fillore në Tejsë. Edhe pse godina e shkollës është ndërtuar para 10 vitesh, muret ishin të plasaritura dhe ishte rrezik shembje, kështu që i kërkon të atit me këmbëngulje të ndërhynte të ndryshojnë mjediset, pasi në atë gjendje shkolla përbënte rrezik për fëmijët. Kështu që javën e dytë të mësimit e zhvilluan në shkollën "Ibrahim Gjorgji", në Radomirë, buzë rrugës nacionale Kukës-Peshkopi. Kampi fillon në orën 9:00 të mëngjesit dhe mbaron rreth orës 1:00 pasdreke. Gjatë kësaj kohe zhvillohet seanca mësimore e gjuhës angleze të kombinuara me veprimtari të ndryshme sportive, kulturore, informative dhe edukative. Genti, përveç se dëshiron t'u mësojë bashkëmoshatarëve të tij gjuhën angleze, duket se është edhe në kërkim të rrënjëve të familjes."Qëllimi im është që nxënësit pjesëmarrës të kenë një eksperiencë cilësore, ku përveç të mësuarit anglisht të njihen edhe me kulturën amerikane. Pjesë e aktiviteteve të kampit do të jenë edhe projektet individuale dhe në grupe, ku fituesit do të shpërblehen me çmime në para të disa niveleve". Gjithashtu, fëmijëve u ofrohet drekë falas, e përgatitur për ta nga një restorant në Radomirë.

Fëmijët janë të ndarë në dy klasa, të rriturit mësojnë me Gentin, ndërsa të vegjlit mësojnë me Lefterin.

Genti është sot vetëm 15 vjeç dhe e ka thyer rekordin si mësuesi më i ri në Radomirë. Ai ua korrigjon detyrat secilit në moment. Ata i thërrasin "msues", ndërsa ai u përgjigjet vetëm në anglisht. Nxënësit në klasën e Gentit, 9 prej të cilave janë vajza, bëjnë ndonjëherë biseda me njëri-tjetrin, por ai, si mësues profesionist, nuk u bërtet, siç bëjnë mësuesit e tyre të zakonshëm, por ndërhyn me shumë takt dhe, pasi u kontrollon detyrat në moment, u jep të tjera shtesë.

Shtatë fëmijë janë të vegjël, nga 27 që janë regjistruar në shkollën verore, sipas një përzgjedhje që është bërë në bashkëpunim me drejtorin e shkollës, Lirim Deda. Ata po mësojnë anglisht me Lefterin, i cili kujton kohën kur 31 vjet më parë, për një vit ushtroi profesionin e mësuesit në Tejsë. "Atëherë isha 18 vjeç, kujton ai, por tani pashë me dhimbje se shumë gjëra nuk kanë ndryshuar. Tani Shqipëria është hapur, shumë prej familjeve kanë migruar drejt kryeqytetit dhe madje edhe drejt Europës, dhe megjithëse janë në kontakt me një kulturë tjetër dhe zhvillim tjetër, sërish fshati ka mbetur prapa. Dhe që të ecë përpara, është e nevojshme që këta fëmijë të shkollohen".

Ata po mësojnë tani ndryshimin mes he dhe she. Dhe kur shkruajnë, e afrojnë kokën shumë afër fletores, sikur duan që të mos harrojnë asnjë shkronjë. Mbi 95 për qind e nxënësve në shkollat e Kalasë së Dodës i kanë prindërit e tyre pa arsim të lartë dhe kjo, thekson Lefteri, është një minus i madh për fëmijët e këtij rajoni. Është kënaqësi e madhe, shton ai, kur shumë prindër vijnë te kampi për të na falënderuar dhe, kur ndahen, më thonë "dua që edhe fëmija im të bëhet si ty".



Lefter Daku gjatë një ore mësimi me më të vegjlit e shkollës verore në Radomirë

Dhe vërtet, Lefteri mbetet një model për këta nxënës dhe për breza të tërë që kanë mbaruar në këtë shkollë. Ai ka mbaruar Universitetin Bujqësor për ekonomi në vitin 1987 me rezultate të shkëlqyera, dha ka punuar si pedagog i statistikës po aty deri në vitin 1995. Më tej vazhdoi studimet pasuniversitare në Amerikë për shtatë vjet pranë universitetit Virginia Tech, një universitet me famë botërore. Në përfundim të studimeve ai mori gradën shkencore të doktoraturës në fushën e ekonomisë. Aktualisht, Lefteri është drejtor i kërkimit dhe planifikimit strategjik në universitetin Virginia Tech. Ka botuar disa libra në anglisht dhe shërben si ekspert i politikave të arsimit të lartë në Departamentin Amerikan të Arsimit.

Nëna e Gentit, Feride Daku është me origjinë nga Vlora dhe punon si drejtore e financës po në këtë universitet. Ka dy diploma universitare me rezultate të shkëlqyera nga Shqipëria, një master MBA në biznes nga Virginia Tech, dhe është në prag të marrjes së doktoraturës në fushën e politikave të arsimit të lartë.

Dhe Genti ka detyrë të vështirë përpara, sipas parimit që "bëm baba të të ngjaj", apo "nxënësi bëhet më i mirë se mësuesi"...

edukim



Gjatë procesit të mësimit

ARSIMI NË KALA TË DODËS

Kalaja e Dodës është një komunë e vogël, por e njohur nga agjencitë turistike, për shkak se është rruga që të çon në masivin malor të Korabit. Komuna ka 8 fshatra dhe sot ka 3300 banorë, por sipas kryetarit të saj, Bajram Hima, 5500 të tjerë banojnë në Tiranë dhe Durrës, si dhe jashtë shtetit, kryesisht në Angli. Për turizëm dhe për të siguruar të ardhura, sado të pakta për jetesë, disa familje hapin shtëpitë, kështu që gjuha angleze është një nevojë për fëmijët e kësaj krahine.

Komuna ka katër shkolla fillore dhe dy 9-vjeçare, ndërsa gjimnaz nuk ka. Gjithsej rreth 400 nxënës studiojnë në arsimin 9-vjeçar. Fëmijët thonë se shkollën e mesme do ta kryejnë në Peshkopi, mbi 30 km larg, por disa prej tyre ëndërrojnë ta zhvillojnë edhe në Tiranë, për të ndjekur pasionet e tyre në këngë a mjekësi, të paktën sipas eseve ëndërruese që kanë shkruar. Mësuesit në shkollat e Kalasë së Dodës, si edhe në shumicën e fshatrave periferikë të Shqipërisë, bëjnë edhe lëndë jashtë profilit të tyre, për të mbushur ngarkesën mësimore. Mësuesi i gjuhës shqipe këtu jep edhe aftësim teknologjik dhe fizkulturë, ndërsa mësuesi i matematikës jep edhe informatikë.

Shkolla nuk ka kompjutera e rrjedhimisht as internet, dyert nuk hapen dhe mbyllen, por shtyhen dhe tërhiqen zvarrë, ndërsa një sobë mes tavolinës së mësuesit dhe dërrasës së zezë, të kujton se në këto anë, dimri është pas malesh dhe vjen shpejt...

ËNDRRAT E FËMIJËVE

Fëmijët kanë ëndrra. Zakonisht ëndrrat e tyre janë me gjërat që ju mungojnë në komunitet: dikush do të bëhet mjek, një tjetër polic, mësues, këngëtar. Dhe ëndrrat e tyre ata i kanë shkruar në esetë që Genti do t'i marrë me vete në Amerikë...

Higerta, nxënësja më e vogël e kursit, do që të bëhet "mësuese matematike, që t'i ngjajë gjyshit, i cili e ka mësuar si të mbajë lapsin dhe si të shkruajë në fletore shkronjat e para". Gjyshi i saj, Rasim Deda, i cili për dekada të tëra shërbeu si mësues në shkollën 9-vjeçare Radomirë, ndihet krenar për Higerten. Irena do që kur të rritet të bëhet doktoreshë, që të shërojë njerëzit dhe t'i ndihmojë ata të mos vdesin. Alltani do të shkojë pas shkollës në Tiranë me familjen dhe kështu do të realizojë ëndrrën për t'u bërë doktor. Po ashtu, edhe Ervini, djali i këngëtarit Myfterim Kupa, do që të bëhet doktor, ëndërr të cilën do ta realizojë me punë. Edhe Delvina do që të bëhet mjeke, "që është profesion i vështirë, por edhe human dhe i bukur, pasi shpëton jetë njerëzish". Mjekësi do të studiojë edhe Muhameti , pasi është profesioni më human në botë. Mjekësia i pëlqen edhe Altinit, ndërsa Erjona do të largohet për në Londër, dhe atje do të bëhet një infermiere. Ndërsa stomatologu i ardhshëm do të jetë Marseli, i cili do "t'ua rregullojë dhëmbët njerëzve me çmime të ulëta". Besarta do të bëhet "një këngëtare, do të fitojë shumë çmime dhe do të ketë shumë adhurues". Ndërsa Zelhixheja do të bëhet e gjithanshme, "këngëtare, parukiere, por edhe mjeke". Mirjona do që të bëhet një "shoë-girl: këngëtare, stiliste". Pse jo, emri i saj tingëllon si artiste. Florina dëshiron të bëhet parukiere, por edhe "do të hapë një bar kafe të mirë, që t'u shërbejë banorëve dhe turistëve".

Këta fëmijë nuk kanë vetëm ëndrra të bukura, por edhe të vështira. Dituria do të bëhet avokate, "që të ndihmojë fëmijët, pse jo edhe njerëzit në nevojë, që të jenë para ligjit të gjithë njëlloj". Jetmiri do që të bëhet "polic i krimeve të rënda, që të arrestojë kriminelët që po shkatërrojnë Shqipërinë" dhe më pas ka dëshirë të bëhet kryeministër e pse jo edhe president. Ndërsa Hamdiu do që "të ndryshojë gjithë shoqërinë, por këtë do t'ia arrijë duke filluar nga leximi". Fatbardha do të bëhet një eksploruese e natyrës dhe faunës, dhe me siguri natyra dhe fauna e Korabit do të bëhen të njohura në revistat shkencore të së ardhmes.

Por grupi i nxënësve të shkollës verore të Radomirës do të nxjerrë edhe një futbollist, Shefiun, (Hafuzi), i cili do të bëhet një sportist i mirë, dhe kështu "nuk do të zhgënjejë as trajnerin, dhe as prindërit e tij të dashur". Kështu që kur të dëgjoni për sukseset e futbollistit Hafuzi, kujtohuni që ai ka qenë nxënësi i "msues Gentit", siç i thërrasin fëmijët.

Për esetë më të mira ishte planifikuar të jepeshin edhe tre çmime, por Genti ndryshon planet dhe vendos të japë tre çmime të para për Alltanin, Fatbardhën dhe Elmedinin, dhe tre çmime të dyta për Diturien, Altinin dhe Florinën. Dhe sigurisht, shpërblimi nuk mungon.

DHE ËNDRRAT VAZHDOJNË...

Shkolla verore i mbylli dyert me 4 korrik, ditën e Pavarësisë së SHBA-së, dhe Genti mori rrugën e kthimit për në Virxhinia, me një përvojë të mrekullueshme me fëmijët e fshatit të Radomirës dhe me besimin se i ka ndihmuar sadopak t'u hapë një dritë shprese për të ardhmen. Ai ka marrë me vetë ëndrrat e tyre për të ardhmen dhe do t'u tregojë shokëve për përvojën e tyre të paharrueshme në Shqipëri.

"Brenda periudhës dy-javore të kampit, - shkruan Genti në refleksionet e tij mbi këtë aktivitet vullnetar - secili nxënës pati një përmirësim të dukshëm në të folurën dhe të kuptuarit e gjuhës angleze. Ata jo vetëm zhvilluan aftësitë në anglisht, por edhe treguan bindshëm se sa shumë mund të mësohet kur je plotësisht i dedikuar për të nxënë dije të reja. Sikur e gjithë kjo eksperience nuk kishte qenë e mjaftueshme, kur shikoja secilin prej nxënësve duke mbajtur çertifikatën në duar dhe fytyrat e tyre të lumtura, me kapi nostalgjia. Kisha ndarë me ta vetëm dy javë dhe ndieja sikur i kisha njohur prej kohësh. Vërtetë, isha krenar për secilin prej tyre. Imagjino, në një nga zonat më periferike të Shqipërisë, ky grup fëmijësh nuk mund të ketë të njëjtat mundësi në jetë, siç unë i kam në Amerikë. Sidoqoftë, ata janë dëshmi e gjallë se rrethanat e tyre nuk kanë asnjë peshë karshi lumturisë dhe të ardhmes së tyre. E qeshura e tyre ka të njëjtën çiltërsi si të çdo fëmije tjetër në botë. Që nga dita që jam larguar nga kampi veror në Radomirë, nuk mund ta harrojë këmbënguljen e tyre të admirueshme për të mësuar, ashtu sikurse nuk më hiqet nga mendja pyetja që më bënë kur u ndamë: "A do të vini përsëri vitin tjetër?""

Shumë emigrantë kthehen rrallë në shtëpitë e tyre, dhe kur vijnë, sidomos gjatë verës për pushime e dasma, kujtohen të gjejnë dhurata nga më të çuditshmet për fisin e të afërmit. Por pak prej tyre kujtohen të sjellin libra, kulturë dhe dije. Dhe njëri prej tyre, që nuk do të harrohet për një kohë të gjatë në Radomirë është Genti Daku, mësuesi më i ri që ka parë krahina e Kalasë së Dodës.

Me siguri, 27 fëmijët më me fat të Radomirës do ta kujtojnë atë, kur të flasin në anglisht me të huajt që do ta vizitojnë Korabin, por pse jo, edhe kur të mësojnë më shumë bjeshkëve me librat e sjellë prej larg.





KUSH ËSHTË GENTI DAKU?

Është 15 vjeç. Ka lindur në Blacksburg, Virginia, USA me prindër shqiptar. Gjuhën angleze e ka gjuhë të lindjes. Flet rrjedhshëm frëngjisht dhe spanjisht. Shqip flet pak, por kupton më shumë dhe ka mësuar më shumë gjatë një muaji të qëndrimit në Shqipëri. Është në vit të dytë në Blacksburg High School (gjimnaz). Është student i shkëlqyer, me kërkesa ndaj vetes dhe me interesa të gjera për të mësuar dhe kontribuar në komunitet.

Genti ka qenë përfshirë në një program shkollor të avancuar për studentat e talentuar që nga klasa e katërt. Ndërsa po vazhdonte shkollën 8-vjeçare, ai përfundoi me sukses pesë lëndë të gjimnazit. Genti filloi të marrë lëndë universiteti qysh në vit të parë gjimnaz. Deri tani ka marrë dy klasa inxhinierie nga Rochester Institute of Technology, tre klasa AP/dual enrollment, dhe sapo mbaroi dy klasa biznesi online nga një universitet tjetër. Gjatë ditëve të qëndrimit në Shëqipëri ai ndoqi një lëndë on-linë për financat familjare. Vitin që vjen, Genti do të jetë ne vit të tretë gjimnaz, por është regjistruar të marrë të gjitha klasat e nivelit universitar.

Genti është themelues dhe Presidenti i një klubi studentor të quajtur "Multicultural Club" në Blacskburg High School. Përmes këtij klubi, Genti mbështet studentët në nevojë, ata që vijnë nga familjet e paprivilegjuara, si dhe studentë ku asnjëri nga prindërit s'ka arsim të lartë. Është zgjedhur në organet drejtuese të disa klubeve të tjera në Blackburg High School. Është President i American French Honor Society dhe anëtar i American National Honor Society. Ka fituar disa çmime dhe medalje në nivel county, distrikti, shteti i Virginia-s dhe në të gjithë Amerikën në kompeticione për gjuhën franceze, në fushën e biznesit dhe në publicistikë (eassy). Genti merret me sporte. Deri vitin e kaluar ka luajtur futboll në një skuadër kompetitive të qytetit ku banon. Në janar të 2014-ës është certifikuar si arbitër futbolli (Kategori 8) nga Federata e Futbollit e SHBA-së. Gentit i pëlqen të udhëtojë brenda Amerikës dhe jashtë. Deri tani ka vizituar këto vende: Shqipëri, Kosovë, Greqi, Francë, Angli dhe Kanada. Thënia e tij e preferuar është: "Suksesi matet jo sa shumë ke arritur në jetë, por nga pengesat që ke kapërcyer" me autor Booker T. Ëashington.

Për më shumë mbi Kampin Veror në Radomirë mund të shihni linkun e mëposhtëm:
http://ëëë.youcaring.com/nonprofits/english-summer-camp-for-albanian-children/176867

Rruga e Arbërit nr. 99

intervistë

Intervista me gazetarin sportiv, dibranin Defrim Methasani, është realizuar në kuadër të bashkëpunimit të gazetës "Rruga e Arbërit" me faqen sociale në FB "Peshkopi,Dibër,Albania". Ajo do botohet edhe në faqen në internet http: peshkopidiberalbania.wix.com. Bashkëpunimi synon të bëjë publike me anë të intervistave sukseset e dibranëve në fusha të ndryshme të jetës.

Profesioni *i gazetarit – një*

Bisedoi: **SASHENKA NDREKA**



Në studio

Ju jeni një gazetar sportiv i njohur dhe me përvojë. A e mbani mend lajmin e parë sportiv të përcjellë për publikun?

Natyrisht që e mbaj mend, sepse ka një ditëlindje të një profesioni dhe pasioni të jetës sime.

Në gazetën "Ushtima e Maleve" që ishte asokohe, kam shkruar për një ndeshje futbolli për ekipin e Korabit, që fitonte me Labinotin e Elbasanit për Kupën e Shqipërisë, me shifrat 3 - 2. Kam qenë nxënës në shkollën e mesme dhe kam ndjerë një kënaqësi të jashtëzakonshme kur kam parë emrin tim në faqen e fundit të gazetës, aty ku jepeshin lajmet sportive. Toska shënoi tre gola dhe fituam me skuadrën kampione të fazës së parë në kategorinë e parë në atë vit, ndërsa "Korabi" ishte në kategorinë e dytë. Toska ka bërë disa gola spektakolarë, që i kam akoma në mendje, madje njërin me goditje dënimi jashtë zone dhe fusha ishte me dëborë. E mblodhi dëborën dhe e bëri pak si kodër, vuri topin e goditi dhe trekëndësh. Gogunja atë sezon ishte portieri më i mirë në Shqipëri, por u dorëzua dhe u detyrua t'i jepte dorën mjeshtrit dibran. Pastaj lajmin e parë televiziv e kam bërë në shtator të vitit 1983.

Ndërsa në televizion, pas një konkursi që u bë me disa prej bashkëpunëtorëve sportivë në shtator 1993, unë dola fitues me kronikën e ndeshjes, Labinoti – Partizani, me dy gola që i kam edhe sot në mendje: të Branicës dhe Agalliut dhe ky takim doli barazim 1-1. ...Kujtesa më ndihmon të sjell përgjigje të tilla edhe sot, kur kanë kaluar kaq shumë vite.

Pas përfundimit të Shkollës së Lartë të Fizkulturës, keni punuar si mësues në disa fshatra të Dibrës, si Lurë, Fushë-Çidhën e Kastriot, ku keni organizuar shpesh veprimtari sportive për të rinjtë.

Si i kujtoni ato vite dhe si ka ndikuar karriera juaj në arsim për atë që do të vinte më pas?

Më rizgjove kujtime të kahershme dhe mjaft mbresëlënëse. Kam punuar shtatë vjet mësues në disa prej shkollat më me emër në Dibër, si në Lurë, Lunare, Sllovë, Sohodoll, Fushë – Çidhën dhe Blliçe.

Pasioni im ishte i madh në ato vite dhe nuk ngopesha së punuari dhe organizuari në orën e edukimit fizik, por më së shumti jashtë saj, pasditeve apo në orët e lira.

Në Lurë ishte fillimi dhe aty vendosa bazat profesionale edhe pse isha një djalë shumë i ri. Por nuk e harroj kurrë bashkëpunimin dhe afinitetin që kolegët atje më ofruan, por edhe miqësia dhe raportet që vendosëm me nxënësit. Ky takt dhe kjo mënyrë pune u trashëgua edhe në shkollat e tjera ku punova, veçmas në Fushë-Çidhën, ku ndenja më gjatë.

Aty ndërtova edhe një terren të mirë sportiv dhe mbaj mend që u dekorova me titullin: "Mësues i dalluar". Fituam shumë spartakiada dhe turne sportivë, organizuam për herë të parë festivalin e lojërave popullore, si dhe mjaft veprimtari të bukura, duke shpallur shumë fitues e kampionë lokalë.

Respekt për të gjithë ata nxënës, mësues e drejtues që më ndihmuan për të arritur në ato nivele, sepse atëherë ishte sa e lehtë, aq edhe e vështirë.

Çfarë ju bëri që t'i jepnit duart punës së mësuesit dhe të merreshit me raportimin mbi lajmet sportive? Kur e keni kuptuar se gazetaria sportive ishte ajo çka duhet të bënit?

Pasioni im ishte që fëmijë për gazetarinë sportive. Unë vetë jam marrë me sport me ekipet e Korabit të Peshkopisë, si në futboll, basketboll, atletikë etj. Por kuptova që niveli im nuk e kalonte dot atë mesatar. Ndërkaq që angazhimi në vitet e shkollës së mesme ishte edhe me veprimtaritë kulturore.

Imitimi sportiv, ose më mirë të themi komenti sportiv, më pëlqente jashtë mase. Imitoja në shumë aktivitete të ndryshme, komentatorin e madh te Radio- Tiranës, Ismet Bellova edhe ky nga Dibra. Pashë që kisha sukses sa herë dilja para publikut. Atëherë vendosa të bëhesha edhe unë i tillë. Pas vitit '91 vij në Tiranë dhe fillimisht bashkëpunova me Radio-Tiranën, me gazetarin Ahmet Shqarri, që drejtonte rubrikën sportive në Radio.

Më pas, kalova në televizion, duke nisur kështu që nga viti 1993, bashkëpunimin me TVSH, në rubrikën sportive e më pas në shumë programe të tjera të këtij ekrani. Kjo ishte ura ndarëse mes mësuesit pasionant dhe gazetarit po të tillë...



Në foto: Me kryetarin e Bashkisë së Shëngjinit, z. Salvador Kaçaj. Këshilli komunal I këtij qyteti e ka nderuar me vlerësimin "Mirënjohje e qytetit", për kontributin e tij në propagandimin e sportit dhe sportistëve lezhjanë. "Një dekorim që më shton jo vetëm kënaqësinë, por edhe detyrimin dhe përgjegjësinë për të punuar edhe më me pasion dhe profesionalizëm për ekranin, njerëzit dhe sportin", shkruan Dëfrimi në faqen e tij në Facebook.

Përmes rastit të Ambrës, përmes dhimbjes, gjeta shumë humanistë, njerëz të panjohur që m'u bënë familjarë, gjeta një popull që na mbështeti dhe një komb si Gjermania që vuri dorën në zemër, mësova shumë për Dibrën, që ishte pararoja, Shkodrën, Dibrën e Madhe, Tiranën, Durrësin, gjithë Shqipërinë... Gjej rastin t'ju shpreh mirënjohjen time të madhe të gjithë atyre që na kanë ndihmuar dhe na kanë lehtësuar këtë dhimbje dhe uroj që Ambra të rikthehet sa më shpejt fituese...

Si mund ta përshkruani marrëdhënien që keni me sportin? Cili sport ju jep më shumë emocion?

Futbolli mbetet si zakonisht kryesor në punën tonë, pasi edhe raporti i këtij sporti me njerëzit është parësor në vendin tonë.

Çdo javë duhet të përcjellim kronikat dhe lajmet për ndeshjet që luhen në Shqipëri, plus kampionateve europiane apo botërore që zhvillohen dhe ne i transmetojmë ato. Por unë jam një gazetar sportiv, që kam punën më shumë në terren dhe më duhet të flas e shkruaj për shumë sporte, veçmas lojërat me dorë, peshëngritja, boksi, atletika e shumë e shumë sporte të tjera. Ndeshja me Greqinë në vitin 2004 mbetet emocioni më i madh në jetën time, por besoj dhe i shumë shqiptarëve që përcollën atë duel futbollistik, kur skuadra helene vinte si kampione Europe, apo përballjet me Rusinë në Shkodër kur fituam 3-1 e plot ndeshje dhe kujtime të pashlyeshme që prodhon sporti.

Por po kaq emocione më kanë dhuruar ndeshjet dhe tituj kampion të djalit nga Bulqiza, Ismail Keta, që doli tri herë Kampion Bote në Kik- Boks, apo vëllai i tij Gjetan Keta, që sapo u shpall Kampion Europe në boks. Po kaq emocione me kanë dhuruar djemtë tanë peshëngritës dhe vajza, që kanë dalë Kampion Europe apo Bote, si Ilirjan Suli, Erkand Qerimaj, Daniel Godelli, Briken Calja, Romela Begaj, etj. Janë shumë dhe po të merrem me të gjitha rastet, nuk mjaftojnë në këtë intervistë.

Ç'rol ka pasur vendlindja juaj, Dibra, në formimin dhe karrierën tuaj?

Jam ndjerë gjithnjë krenar me vendlindjen time. Kjo falë asaj që unë sapo them nga jam, ndiej vlerësimin e emrit Dibër nga personi me të cilin flas, apo grupi i njerëzve me të cilët jam. Natyrisht, ky respekt dhe vlerësim është një shtysë më tepër në pasionin dhe profesionin tim dhe secilit nga ne.

Kultura, tradita, vlerat dhe shumë elementë të rëndësishëm të zonës tonë, kanë qenë një motiv për të qenë gjithnjë kërkues ndaj vetes dhe vlerësues ndaj të tjerëve.

mundësi për të *njohur njerëzit*



Me Ronaldon.

Sporti në Shqipëri dhe kudo, ka lidhje me ekonominë dhe financat. Një sport i suksesshëm nuk mund të bëhet vetëm me dëshirë apo pasion, por do mbështetje financiare. Para disa vitesh mora nismën dhe mblodha 20 biznesmenë dibranë në Tiranë, vendosëm edhe piketat e bashkëpunimit, por kjo "flakë" u shua shpejt për fat të keq. Ndoshta është koha dhe vendi për t'u bërë tani, sepse po shuhet tradita e bukur sportive në Dibër...

Kultura, tradita, vlerat dhe shumë elementë të rëndësishëm të zonës tonë, kanë qenë një motiv për të qenë gjithnjë kërkues ndaj vetes dhe vlerësues ndaj të tjerëve.

Kush ju ka frymëzuar në rininë tuaj? Po sot?

Në jetë kam qenë gjithnjë optimist dhe e kam parë jetën si një mundësi dhe shans që të jepet për të treguar sa vlen dhe çfarë di të bësh. Frymëzimi im ka qenë fakti që kam punuar me brezat e rinj, por që në fakt ka nisur që kur isha nxënës, sepse isha shumë aktiv dhe merresha vetë me shumë sporte.

Ky pasion më shoqëron edhe sot, kur po afrohem tek të 50-at, por që ndjehem vërtet shumë i ri. Sporti ka qenë tregues për ecurinë time, pasi jam munduar të jem sinkron më të.

Ndërkaq që profesioni i gazetarit, më dha një mundësi ideale për të njohur shumë njerëz dhe për të bërë shumë miq. Kjo më bën të ndjehem shumë mirë...

Ju shohim shpesh të mbështesni sportistët, sidomos të rinjtë, por më shumë i pasionuar dukeni kur mbështesni sportistët dibranë? Kujtojmë në këtë rast vëllezërit kampionë Keta, por jo vetëm. Kjo mbështetje mediatike ndodh për shkak se jeni dibran apo ka arsye të tjera?

Unë nuk mbështes vetëm sportistët, por më shumë mbështes vlerat sportive dhe kombëtare. Ju përmendet rastin e vëllezërve Keta, por janë dhjetëra e qindra djem e vajza që jam munduar t'i promovoj.

Unë, njerëz të tillë, i kam parë jo thjesht si sportistë që arrijnë rezultate, apo fitojnë një trofe, por si ambasadorë të vlerave tona kombëtare. Atë që bën sportisti, nuk e bën as politika, askush tjetër.

Vëllezërit Keta, unë s'i kam parë si dibranë, por si shqiptarë dinjitozë, si djem të guximshëm, që në mes të Gjermanisë, ngrenë flamurin shqiptar dhe flasin shqip në mes të ringut, duke falënderuar vendin që i lindi dhe rriti.

Të tillë njerëz nuk duhen promovuar dhe mbështetur vetëm nga ne, gazetarët, por së pari nga shteti dhe gjithë opinioni sportiv dhe qytetar.

Klubi Sportiv "Korabi" (futboll meshkuj, volejboll femra) nuk e ka më shkëlqimin e dikurshëm. Pse ndodh kjo, në këndvështrimin e një gazetari sportiv?

Sporti në Shqipëri dhe kudo ka lidhje me ekonominë dhe financat. Një sport i suksesshëm nuk mund të bëhet vetëm me dëshirë apo pasion, por do mbështetje financiare. "Kukësi" deri dje nuk njihej fare në futboll, por u desh të mblidheshin bashkë të gjithë biznesmenët e këtij qyteti në Tiranë dhe rrethe dhe ja ku është "Kukësi" sot, ka kaluar ture europiane dhe vazhdon të mbetet në elitën e futbollit shqiptar në Kategorinë Superiore.

Në Dibër, për fat të keq, kjo nuk ndodh. Para disa vitesh mora nismën dhe mblodha 20 biznesmenë dibranë në Tiranë, vendosëm edhe piketat, por duhej edhe vullneti i Bashkisë dhe Klubit, sepse kjo "flakë" u shua shpejt për fat të keq. Ndoshta është koha dhe vendi për t'u bërë tani, sepse më vjen keq, por po shuhet tradita e bukur sportive në këto sporte ne Dibër. Vërtet më dhemb "Korabi" dhe sporti dibran. Para disa vitesh, me disa miq ndihmuam për 70 vjetorin e klubit "Korabi", ku edhe u dekoruan disa prej korifejve të sportit atje. Kjo duhet të vazhdojë...



Me familjen.

E kemi ndjekur me interes ecurinë e mbesës suaj, Ambra, forca e së cilës u kthye në frymëzim për gjithë shqiptarët si dhe për mjekët gjermanë, të cilët morën përsipër kurimin e saj pa pagesë. Duke i uruar shërim sa më të shpejtë Ambrës, duam t'ju pyesim juve, si qe e gjithë kjo eksperiencë për ju?

Po bëhet një vit që mbesa ime Ambra ndodhet në spital në Mynih të Gjermanisë, falë vëllezërve Keta, të cilët kanë bërë maksimumin për jetën e saj dhe dua t'i falënderoj nga zemra. Por unë u jam mirënjohës edhe mjaft njerëzve të tjerë, miq, të njohur, por edhe jo të tillë, të cilët u solidarizuan me dhimbjen tonë dhe familjes, për të mbështetur edhe financiarisht mbesën time 17- vjeçare që vuan nga tumori i fshehtë. Ka qenë një rast ku unë, përmes dhimbjes, gjeta edhe lumturinë, gjeta shumë humanistë, njerëz të panjohur që m'u bënë familjarë, gjeta një popull që na mbështeti dhe një komb si Gjermania që vuri dorën në zemër. Përmes rastit të Ambrës ne bëmë miq kudo, brenda dhe jashtë vendit. Unë përmes këtij rasti, mësova shumë për Dibrën që ishte pararoja, Shkodrën, Dibrën e Madhe, Tiranën, Durrësin, por edhe mjaft qytete të tjera. Dhimbja, nuk thonë kot, që ndahet me të tjerët, ndërsa gëzimi edhe me veten. Dua që përmes kësaj interviste t'ju shpreh mirënjohjen time të madhe të gjithë atyre që na kanë ndihmuar dhe na kanë lehtësuar këtë dhimbje, që uroj të mbyllet sa më parë dhe Ambra të rikthehet tek ne fituese...

A e keni trashëguar tek ndonjëra nga vajzat pasionin për sportin apo i keni lënë të lira në zgjedhjet e tyre?

Vajzat janë të lira të zgjedhin dhe kurrë s'kam dashur t'ju imponoj atyre profesionin që do të zgjedhin në jetë. E madhja, Lunada, është studente për Ekonomik në vitin e fundit, por drejton dhe moderon spektakle. E dyta, Blerta, ka shumë pasion fotografinë dhe është në vitin e fundit të gjimnazit "Qemal Stafa", ndërsa e vogla Rina, ka pasion sportin, volejbollin dhe modën dhe është nxënëse në klasën e 9-të të shkollës "Kongresi I Manastirit" në Tiranë.

Vitin e kaluar ju keni themeluar edhe Shoqatën "Media & Sport". Çfarë përfaqëson dhe synon kjo shoqatë?

Qëllimi im ka qenë që përmes kësaj shoqate të kem një mundësi më shumë për të promovuar vlera dhe njerëz që meritojnë të nderohen. Duke pasur një shoqatë, ke një mundësi institucionale të bësh nderimin dhe promovimin e sportit dhe njerëzve që vlejnë, të dekorosh ose çmosh dikë. Pra, është një mundësi më shumë për të bashkëpunuar, për të vlerësuar dhe shuar harresën për emra legjendë të sportit, por edhe ata që janë në aktivitet sot. Organizime të tilla janë një mundësi ideale, kur kujtoj rastin e kupës së mbretit të futbollit shqiptar, "Panajot Pano". Që nga viti që shkoi, ky organizim ka logon e "Media & Sport".

Çfarë do t'u thoshit të rinjve që aspirojnë të ndjekin hapat tuaj?

Ju them që kurrë të mos dorëzohen përpara vështirësive të jetës, të jenë optimistë dhe të kërkojnë më shumë tek vetja dhe të tjerët. Unë në këtë mision dhe profesion të pasionit të gazetarisë kam mësuar aq shumë, saqë 10 universitete s'do ta bënin bashkë. Puna me njerëzit, bashkëpunimi dhe raportet që vendos, kanë shumë rëndësi në jetë.

Qëllimet që vihen, kërkojnë impenjim, kërkojnë përgjegjësi dhe vetëmohim të kohës, por edhe energji që duhet ta shoqërojnë secilin nga ne në jetë.

bloger

Ç'kemi asaj Dibre!

Nga **BUJAR KAROSHI**

Ky muaj pati lajme dhe s'di nga t'ia nis.

T'ia nis që mbaroi 300 ditëshi i sukseseve të qeverisë apo ngaqë s'pati asnjë lajm për rrugën e Arbërit! Apo doni që t'ia nis nga karkalecat që kanë dëmtuar të mbjellat dhe kullotat e Dibrës? Mos doni të parin vjedhjen e argjendarisë në Dibër apo mos doni kafshimin e miut, që jo vetëm të kafshoka si gjarpër, por qenka dhe i kuq!

Matura shtetërore shkëlqeu këtë vit. Letërsia u zhvillua nën masa të ashpra sigurie, ndërsa të tjerat u zhvilluan nën kushte të larta kopjimi. Shyqyr që u lirua një çikë, se do të kishin mbetur të gjithë në matematikë.

Në Dibër do ta mbyllin Universitetin, ndërsa në Peshkopi shpëtoi edhe sivjet. Pati zëra që donin që edhe në Peshkopi të mbyllej, sepse shumë larg është Dibra me metropolin. Më mirë të paguajmë për fëmijët tanë me studime, sesa të vuajnë pedagogët nga rruga e gjatë. Gjimnazistët u mërzitën shumë, sepse ishin mprehur që të ktheheshin te shkolla e vjetër, se të paktën rreshtohen në mëngjes!

Këtë muaj u zhvilluan zgjedhjet për kryetarin e ri të PD-së. E megjithatë, lajmet e harruan ta japin fare! Ndërsa një mik më solli disa foto dhe më kujtoi se në Kuvend kishte vetëm burra. Si mund të ndodhë ndryshe: burrat janë pa punë, burrat janë në kafe, burrat mbushin bulevardin, kështu që edhe në kuvend vetëm burra do të ketë!

Në Peshkopi ka dalë një trend i ri: drejtorët parkojnë makinat në anën e kundërt, që t'i dallojnë njerëzia qeveritarët e rinj...

A të kujtohet lajmi për shpalljen në kërkim të 4 policëve nga një postë kufitare në Kukës? Ata nuk janë kapur akoma, por shefi i tyre është ngritur në detyrë, duke u transferuar në Komisariatin e Peshkopisë.

Reforma elektorale u miratua. Të gjithë e kërkonin, por kur erdhi puna për detajet, kundërshtarët u shtuan. Sidoqoftë, tani për herë të parë Dibrën do ta kemi njësi më vete. Dikur ishte qendra e Shqipërisë, tani është katandisur në një bashki, si Klosi.

Iku dhe korriku bashkë me 300 ditëshin e qeverisë. Bashkë me to edhe premtimet për ardhjen e kinezëve për rrugën e Arbërit. Jemi bërë me fiksime, shohim një kinez të tregu i Medresesë dhe mendojmë se është koncensionari...

Qeveria miratoi çmimet e reja të tokës arë për efekt kompensimi. Një metër tokë në Dibër kushton 121 lekë. Me aq lekë te dyqani i lagjes blen 1 pako makarona, dhe prapë i mbetesh borxh! Kështu që ata që do të ndërtojnë Skavicën, do të blejnë me më pak lekë tokën që do përmbytin!

Në Dibër kanë plasur vjedhjet, në mes të ditës dhe kulmi u arrit kur u tentua të vidhej një argjendari. Dhe pas kësaj u zbulua që shefi i policisë nuk dinte as shqip!

Dhe meqë jemi te sherri, sherr kemi edhe në Parlament. Dikur e bënin tropojanët, më vonë e mërë kuksianët, tani e kanë radhën dibranët! Do Zoti e heqin dorë shpejt, se janë edhe shumë! Plot 13-të!

Dhe në fund po e mbyll me një barsoletë, që e lexova diku. E dini që këtë muaj e nisëm para televizorit, duke parë ndeshjet e Brazilit. Dhe dy tifozë i shkruajnë njëri-tjetrit:

"Tifozi 1: Mbrëmë i pimë birrat në këmbë, se s'na la gjermani me u ul, kurse sonte na u ngroh birra t'u hap sytë nga televizori mos bahet ndonjë gol!


Tifozi 2: A s'keni Ramazan ju andej, si pini birra?

Tifozi 1: Po, e kemi një Ramazan, që s'do me ia ditë për golat. Deri tani ka pi shtatë birra!"

Mos më qesh, sepse gjatë muajit të Ramazanit, restorantet në Dibër kanë pasur shumë punë: shtronin iftar me porosi... Dikur iftarët i bënim në shtëpi, tani gatuajnë kuzhinierët. Prit pas pak vitesh, kur t'i bëjmë iftaret së bashku në skype...

Sidoqoftë, korriku u mbyll gëzueshëm më Festën e Bajramit. Tani fillon gushti i dasmave. Një miku im kishte 4 dasma me datë 17 dhe kishte dalë të kërkonte çifte me pagesë, t'i dërgonte në dasëm në këmbë të tij. Kishte gjetur plot, por më pyeti se a lejohej? Sidoqoftë, gratë dhe vajzat duhet të marrin dy palë sandale me vete, njërën me taka, kur të hyjnë brenda, që t'i xhirojë kamera, një palë të tjera të sheshta për të kërcyer, po s'e patën problem të kërcejnë zbathur…

Behar Mera fton miqtë të firmosin për rrugën e Arbrit!



Behar Mera shared a link.
29 July · Edited

Nga plazhi i Golemit, ne malin e Korabit, nga plazhi i Himares ne bjeshket e Valbones mes miqsh, familjes e te afermve po kalojne pushimet dhe kete vit. Mikepritje dashamirese, nje guzhine e pasur tradicionale, dhe nje natyre te bekuar nga zoti me mbeten ne kujtese! Por me keqeardhje ne te gjithe kete udhetim ndihej lodhja dhe strapacimi si mungese e nje infrastrukture te duhur! Prandaj po ju kerkoj edhe nje here miqte e mi vazhdimin e firmosjes se peticionit per ndertimin e rruges se Arbrit me qellim qe vitet ne vijim te kemi mundesin te shijojme vendet perrallore qe na ofron verilindja e Shqiperise!

Rruga e Arbërit: Ndiqni shembullin e Behar Merës

Së fundi në skenën kulturore shqiptare artistin shqiptar Behar Mera e kemi ndjekur me lotë në sy e duartrokitje në ekranin televiziv me "Alpazarin". Por ai nuk është vetëm atje ku 'Alpazari' shqiptar bëhet humor, ai gjendet gjithandej ku 'pazaret' bëhen edhe nëpër sirtarët e tavolinave zyrtare.

Teksa ndjek dhe ndjen arsyen e tij për atë që intelektuali akademik, Gëzim Alpion ka shtysën e tij, për 'Rrugën e Arbërit" ai ka kohë që inicon dhe fton nënshkrimtarë të rrinj, nënshkrues të denjë për të shtuar rritjen e presionin në këtë pikë. Kështu që ai natyrshëm pajtohet me atë që Dr Gëzim Alpion, lektor në Universitetin e Birminghami, Britani e Madhe citon me të madhe se "Dibra është një nga krahinat më të pazhvilluara në Shqipëri. Rruga e Arbërit do të lidhë Dibrën me rajonet e tjera të vendit duke i dhënë një shtytje shumë të nevojshme ekonomisë lokale. Rruga do të lidh edhe Tiranën me Maqedoninë duke përmirësuar ndjeshëm infrastrukturën në këtë pjesë të Ballkanit."

Pra komediani i shquar Behari Mera u bën thirrje përsëri miqve të tij në Facebook të vazhdojnë të nënshkruajnë petitionin për Rrugën e Arbërit. Ndiqni edhe ju shembullin e këtij artisti dibran që mendon për vendlindjen. Thirrje të tilla janë bërë nga dhjetëra e dhjetëra intelektualë në të gjithë hapësirën shqiptare e më gjerë.

Ndiqni këtë rrugëtim intelektual për ta bërë më pak të dhimbshme jetën e një treve sic është Dibra. Nënshkruani këtu:

http://www.change.org/en-GB/petitions/complete-the-construction-of-the-arbëri-road-ndërtoni-sa-më-shpejt-dhe-me-standarde-rrugën-e-arbërit

Ditari i një vajze...

Për një burrë

Ah mor ditar, lum si ti që nuk duhet me gjet burrë! Duket sikur çdo gjë që bëj duhet ta bëj me një qëllim të vetëm: burrin!

Mbaj ment që për herë të parë e kam dëgjuar prej gjyshes. Isha nja 12 vjeç, kishim shkuar te daja dhe po bënim byrek. Unë po i ndihmoja me qejf të madh dhe kisha marrë një shkop të vogël e një kulaç për ta hapur. Gjyshja më sheh duke tund kokën dhe më thotë:

- "Oj cuc mso me ftoll se dë shkëjsh ke burri!"

E pashë krejt çudi dhe mendova: "Po burri ç'lidhje ka me të ftollmen?! Pse po ma thotë? A duhet me u martu së shpejti?" Gati u ngusha

Një ditë të shtune, teksa po fshija me fshesë korenti siç më pëlqen mua: me muzikë, duke kënduar tekstin e mësuar përmedësh e me një sy në TV, më krahasuan me gocën e Sanies, që i bënte punët e shpisë për merak... Lidën, gocën e Saines, e kam në shkollë dhe është një analfabete, që se si ka mbërrit deri në gjimnaz mbetet mister... Më thanë që ajo është më e zgjuar se unë, që kam matematikën e fizikën 10, sepse ajo di me bë punë shpie...

Pastaj një herë tjetër kisha dalë për të fshirë oborrin e tezes. Ishin mbledhur në një cep tezja, nusja dajës e komshia dhe po diskutonin se si e fshija unë oborrin:

- "Ho mi si e kap netllën? Për çef e mçëjn kurtin."

- "Kurrizin mo s'un e ule. Mçëjn si me qën tu ngjyros ata detyrat e shpëjs.. hahaha..."

- "Duhet me e msu tibe, se dë shkëje ke burri."

Që atëherë kam dëgjuar gjërat më absurde që duheshin bërë "për burrin":

Duhet të mësosh të qëndisësh për burrin, të mësosh të gatuash për burrin, të mësosh të bësh punët për burrin, të mësosh të ndesh rrobat për burrin... pastaj, mos dil shumë se do shkosh ke burri, mos fol shumë se do shkosh ke burri, zgjohu herët se si do ia bësh pastaj kur të shkosh ke burri, mso të hash ç'të t'japin se ke burri s'ke me zgjedh, shijo lirinë tani sa s'ke shku ke burri, mso të pyesish njerëzit se do shkosh ke burri, mso të qash nëpër morta se do shkosh ke burri, mso me bë kafen e mëjr se dë shkëjsh ke vjehrra!...



Pra në thelb, fillojnë të na terrorizojnë për "BURRIN" që në pubertet dhe kur shkojmë 18 vjeç fillojnë të na bëjnë presion të gjejmë këtë "gogol" që sipas tyre na do veç për punë shpie. Janë në terezi këta njerëz? E dinë këta se pse e do burri një grua dhe se çfarë do ai që ajo të dijë në të vërtetë? If you know what I mean...

Ndiq linqet e mëposhtëme në Web dhe Facebook për më shumë foto dhe komente nga Peshkopia e Dibra...
http://peshkopidiberalbania.wix.com
https://www.facebook.com/PeshkopiDiberAlbani

vendlindje

Peladhia, për vetë pozicionin strategjik të saj që ka në Grykën e Madhe, ka qenë vazhdimisht shesh lufte me pushtuesit e shumtë që kanë ar- dhur në vendin tonë.

Peladhia, *një emër që vjen nga legjenda*

Nga **DESTAN RAMA**

Sapo lë prapa Qafën e Buallit, (në kthim nga Tirana), qytetin e vogël, por me emër të madh, Bulqizën, e luginën e bukur të saj, do të përballesh me një grykë mali të ngushtë që quhet Gryka e Qytetit. Poshtë kësaj gryke kalon duke gjarpëruar nëpër shkëmbinj lumi i Bulqizës. Kur e vështron me kujdes ujin e tij, dallon në të dy ngjyra: blu dhe të bardhë.Blu është uji i kthjellët i lumit,ndërsa e bardhë ëdhtë ngjyra që krijohet në formë shtëllungash të bardha, si të ishin pambuk, nga përplasja e tij me gurët e mëdhenj gëlqeror në shtratin e lumit.

Dy brigjet e lumit i lidh një urë e gurtë me harqe që quhet Ura e Qytetit. Në të djathtë të urës mbi një kodër të rrafshët ka qenë ndërtuar në periudhën e hekurit Qyteti i Valikardhës. Edhe sot duken fare qartë rrënojat e tij dhe të kalasë me të njëjtin emër. Gojëdhëna flet se në qendër të qytetit, i cili kishte 12000 shtëpi, sundimtari i vendit (romak) kishte ndërtuar një statujë ku paraqitej një kalë me fre me kalorësin sipër. Asaj periudhe i përkasin toponimet Ura e Qytetit, Gryka e Qytetit, Kalaja e Qytetit, Lagjja Rrethe.

Në vitet në vazhdim folësit popullorë tregojnë se ura u rindërtua nga Sheh Zyberi i Teqes së Madhe Bulqizë, bashkë me Grykën e Madhe. Mbi këtë urë kalonin karvanët e kuajve dhe të këmbësorëve që vinin nga dy Dibrat, Gryka e Radikës dhe Ohri nëpërmjet Rrugës së Arbërit. Kalanë e Qytetit mendohet se e shfrytëzoi Skëndërbeu për t'u zënë pusi turqëve, të cilët donin të kalonin në drejtim të Qafës së Buallit. Për këtë në veri të qytetit, në anën tjetër të lumit, në malin e Temlës, ai ndërtoi pikën e vrojtimit, me të cilën ai mbante nën kontroll gjithë hapësirën nga malet e Dibrës së Madhe – Majën e Lepurit (mbi Qafën e Buallit) – Krujë.

Thuhet se rrugën për në majën e thepisur të shkëmbit, ku u ndërtua pika e vrojtimit, Skëndërbeut ia tregoi një bari dhish nga lagjja Tejzallë e Fushë –Bulqizës. Ky i dhuroi Skëndërbeut një dhi nga tufa ë tij, si simbolin e fitores mbi armikun. Për këtë flasin sot toponimet: Kalldrëmi i Mushkave, Kulla e Skëndërbeut, Shkëmbi i Kullës. Lidhur me këtë histori vjen edhe emri i fshatit Peladhi. Sipas legjendës atje, në pikën e vrojtimit, Skëndërbeu rrethohet nga turqit. Ata synonin që, duke e mbajtur atë të rrethuar, do të dorëzohej për bukë, ujë dhe ushqime. Skëndërbeu ushqeu një pelë me grurë dhe e hodhi nga shkëmbi. Pelës i plasi stomaku. Turqit u mblodhën aty për të parë çudinë. Pela ishte tjetërsuar aq shumë, saqë ata filluan të diskutonin: është pelë a dhi, Peladhi. Çudia bëri që turqit të largohen.

Peladhia shtrihet në luginën e bukur të Grykës së Madhe, Komuna Zerqan, rrethi Bulqizë. Kufiri perëndimor i saj nis me Urën e Qytetit dhe ai lindor mbaron më fshatin fqinj Godvi. Në jug të saj ndodhet fshati Valikardhë, ndërsa në veri qëndron mbi fshat si një shqiponjë krahëhapur gati për fluturim mali i Temlës. Peladhia është vendbanim i hershëm, i regjistruar në Defterin turk 1467. Përpara pushtimit turk fshati ka qenë i banuar nga banorë të besimit katolik. Këtë na e faktojnë disa toponime, të cilat përdoren edhe sot në të folurën e banorëve, si: Lëma e Kasmit, Varret e Kaurrit, Varret e Ketas, Kisha e Kaljet.

Pas pushtimit turk, ashtu si kudo, edhe këtu filloi të praktikohej feja muslimane. Në krye të fshatit, në veri të tij, ka qenë ndërtuar xhamia, në të cilën banorët kryenin ritet e tyre myslimane. Bashkë me fenë ndryshoi onomastika e fshatit. Vendin e emrave katolikë e zunë emrat myslimanë: Hasan, Hysen, Bektash, Nevruz, Hajrie, Fatime, Sheqere etj. Në fshat njihen kryesisht lagjet: Lamhysa, Gjura, Gjoka, Rama dhe lagjja e sipërme (katund). Këtu banojnë disa fise me mbiemra: Lila, Dufi, Kala, Rama,Hysa, Disha, Kamberi, Meta, Gjoka, Deda, Plaku, Pasha, Pata, Gjura, Neziri, Lami, Alla, fisi Huçja i zhdukur.

Në vite disa familje në fshat për kushte më të mira jetese kanë ndryshuar vendbanim, por brenda për brenda tij. Gjatë viteve të lëvizjeve demokratike pak familje janë larguar.

Në shpatin jugor të Temlës, mbi fshat, ndodhen dy shpella (njëra e nëndheshme), të cilat duken sikur një dorë e kujdesshme e njeriut i ka ndërtuar ato. Këto objekte të bukura natyrore, përveç se ia shtojnë bukurinë fshatit, edhe i




kanë shërbyer atij, për të strehuar bagëtitë në periudhën e vjeshtës së vonë, që të ishin më afër kullotës, por edhe për të strehuar banorët sa herë që kërcënoheshin nga pushtuesit.

Në jug të fshatit, nga perëndimi në lindje, si një vijë e lakuar kalon lumi i Bulqizës.Ky e ndan fshatin dhe tërë Grykën e Madhe në dy pjesë dhe, për pasojë, kemi dy emërtime: Shulla dhe Ftohësinë.Ky lumë shfrytëzohet nga fshatarët për plazh, peshkim dhe vaditje. Ata edhe bëjnë kujdes nga dalldisjet e tij, sepse në periudha të caktuara ai u vjedh atyre tokën dhe në ndonjë rast fut në gjirin e tij edhe jetë njerëzish.

Mes për mes fshatit, paralel me lumin, si një tërkuzë e gjatë e përdredhur, kalon Rruga e Arbërit, e ndërtuar mbi rrugën e vjetër këmbësore me kalldrëm. Me rrugën është e lidhur një pjesë e jetës së banorëve të fshatit. Ata e quajnë atë si një artierie të trupit të tyre. Nëpërmjet saj ndihet një frymëmarrje më e gjerë, më e lehtë, më e hapur, që të jep krahë për të fluturuar.Por jetës së banorëve të fshatit të Peladhisë u jep forcë, gjallëri e krenari edhe mali i bukur i tyre, Temla, emri i të cilit vjen në shekuj nga përcaktori (të ëmbla). Me këtë mal lidhet emri, jeta, historia e lavdishme e fshatit. Nga Temla fshatarët marrin drurin për ndërtim e dru zjarri, ujin e ftohtë të burimit, çajin e mrekullueshëm të mali, sherbelin, trumëzën, trëndafilin e egër, dëllinjën e mbi të gjitha lulen e bukur të batrës, nga e cila ka dalë edhe toponimi Shkëmbi i Batrave.Me malin lidhen disa toponime, të cilat përdoren në fjalorin e përditshëm të banorëve. Shkëmbi i Epër, Shkëmbi i Thyer, Shkëmbi i Poshtëm, Lugu i Gjerë, Lugu i Peçit, Lugu i Dacit, Lugu i Gjeçit, Lugu i Mollës, Lugu i Qyqes, Lëma e Rrahit, Lëmëza e Vreshtit, Mangalle, Shulore, Guri i Gjatë, Mrizi i Plleve, Livadhi i Lamhysës, Qafa e Sheshit, Qafa e Liqenit, Progna, Kodra e Kraneve, Xana, Brinja e Plepit, Baraku.

Mbi fshat, në verilindje të tij, ndodhet fusha e bukur e malit të Peladhisë, e quajtur ndryshe "Hambari i fshatit". Fusha vjen në formën e kupës me një dalje të nëndheshme në fundin e saj, që banorët e emërtojnë "vendi ku humb uji". Bari gjer në mesin e trupit të njeriut, lulet e bukura shumëngjyrëshe, ajri i freskët, përkëdhelës, uji i ftohtë i pastër si kristali të zgjasin jetën. Vend i mrekullueshëm për turizëm malor. Rritja e shumë kulturave bujqësore, si: grurë, thekër, elb,



tërshërë, veçanërisht patate, bëjnë që hambarët të mbushen plot e fshatari t'i gëzohet punës së tij e të harrojë lodhjen. Melodia e bukur e këmborëve të bagëtisë që mbarështrohen në stane gjatë verës, gërshëtuar me këngën melodioze të pyllit, të magjepsin. Puna e kujdesshme e stanarëve Veli Rama, Sinan Hysa, Sali Kala, Hajdar Pata, Sabri Rama, Hamit Rama e shumë të tjerë do të mbeten modeli i punës shembullore për çdo banor e më tej.

Peladhia, për vetë pozicionin strategjik të saj që ka në Grykën e Madhe, ka qenë vazhdimisht shesh lufte me pushtuesit e shumtë që kanë ardhur në vendin tonë. Ka qenë pjesë e rëndësishme teritoriale e Betejës së Torviollit (29 qershor 1444) zhvilluar në Fushën e Kalasë. Që këtu filloi goditja e parë e ushtrisë turke. Në një shkrim në gazetën "Rruga e Arbërit", prill 2013, lexojmë:... Qe një sulm i furishëm me forca kalorsiake dhe këmbësorie me trungje, breza zjarri, rrokullisje gurësh të mëdhenj nga shpati jugor i Temlës.Në luftën e Drinit të Zi, tetor 1844, peladhiasit iu bënë krah i fuqishëm udhëheqësit të kësaj beteje të famshme Sheh Mustafë Zërqanit. Grusht të bashkuar kanë qëndruar banorët e fshatit kundër çdo pushtuesi.

Dorëzo armët, - i thanë Hasan Patës së Peladhisë xhandarët serbë. Nuk kam armë, - u përgjigj ai. Gjaku i tij rrodhi si uji i gurrave të Peladhisë dhe lagu tokën mëmë në kodrën e xhamisë me 1913. Hasani trim mbeti simboli i qendresës për të mos u harruar kurrë."

Prof. Dr. Ahmet Kamberi (nga ky fshat) në gazetën "Rruga e Arbërit", prill 2013, shkruan:

"Kur u mor vesh se Italia fashiste po sulmonte Shqiperinë rreth 600 burra, vullnetarë nga Gryka e Madhe dhe Bulqiza, midis të cilëve 15 burra nga Peladhia, të prirë nga Sheh Hajredini i Zerqanit u nisën për në Burrel, për t'u furnizuar me armatim e për të shkuar në Durrës për të mbrojtur Atdheun nga pushtimi i Italisë fashiste. (Po aty). Këta ishin: Sulejman Kamberi, Mehmet Deda, Xhemal Kala, Nasip Pasha, Isuf Hysa, Tush Hysa, Halil Rama, Veli Rame, Ramiz Pata, Zenel Huçja, Riza Kala, Shahin Kala, Muharrem Gjura, Bajram Alla, Myftar Plaku."

Në vite, përpjekjet e peladhiasve për të dalë nga errësira mesjetare, ku e kishin fundosur shekujt, nuk reshtën kurrë. Vetëm tek dituria ata e shihnin shpresën e tyre, të ardhmen e fshatit

Peladhia shtrihet në luginën e bukur të Grykës së Madhe, Komuna Zërqan, rrethi Bulqizë. Kufiri perëndimor i saj nis me Urën e Qytetit dhe ai lindor mbaron më fshatin fqinjë Godvi. Në jug të saj ndodhet fshati Valikardhë, ndërsa në veri qëndron mbi fshat si një shqiponjë krahëhapur gati për fluturim, mali i Temlës.

dhe të vendit. Nisur nga kjo ëndërr e dëshirë pa fund, patrioti e atdhetari Sadik Kamberi bukën dhe shkollën i quante një. Ndaj në mërgim, në Stamboll, vendosi abetaren në brumin e bukës dhe e solli në shtëpi, në Peladhi. Kjo abetare qarkulloi në çdo derë të bashkëfshatarëve të tij dhe në gjithë Grykën e Madhe. Me 1910 u çel në Godvi mejtepi turk në shtëpinë e Hamit Danit. Këtu mësuan me këtë abetare të lexonin e të shkruanin shqip krahës të tjerëve edhe nxënësit nga Peladhia: Myftar Plaku, Hasan Meta, Zenel Hysa, Isuf Hysa, Ramiz Pata, Hamit Kala, Mehmet Deda etj... me mësues Mërsim Dacin nga Dibra e Madhe e Mustafa Dervishin nga Krajka.

Çelja e shkollës fillore e më vonë plotore në Zerqan më 1921 i gëzoi pa masë peladhiasit. Vrapuan dhe u regjistruan në këtë shkollë me dëshirën e tyre, nxënësit: Sami Kamberi, Seit Rama, Like Dufi, Sabri Rama, Osman Kala, Hasan Hysa, Vebi Meta e shume të tjerë në vite.

Duhej pritur viti 1938, ku në Godvi u çel shkolla e parë fillore për të tre fshatrat e shullanit. Nxënësit e parë që u ulën në bankat e shkollës së re nga Peladhia kanë qenë: Osman Gjoka, Elmaz Rama, Rifat Rama, Xhafer Rama, Bukurie Gjura, Bajram Pata dhe në vitet në vazhdim Ali Rama, Xhelabie Kamberi, Gjerie Pasha, Qemal Gjura, Zenel Disha, Ismet Rama, Sherif Lala, Ahmet Kamberi, Nazmi Plaku, Bujar Pata, Enver Hysa etj.. Me 1 shtator 1949, në mes të fshatit Peladhi u çel shkolla fillore. U gëzuan pa masë vogëlushët e fshatit e banorët mbarë. Por dija nuk mbaronte këtu. Ajo duhej kërkuar e gjetur ku të ishte. Ndaj shumë nxënës nga fshati Peladhi vazhduan, në fillim vullnetarisht e pastaj arsim i detyruar shkolën 7 – 8 vjeçare e të mesmen në Zerqan. Mori udhë kështu rruga e dijes, u hapën shtigje për arsimin e lartë, i cili u bë pronë e shumë vajzave dhe djemve të fshatit. Nga kjo shkollë dolën kuadro me vlera të larta shoqërore e profesionale, që me dijet e tyre lanë dhe po lënë gjurmë të pashlyera në të gjitha fushat e jetës. Si të tillë mund të shkruajmë disa prej tyre, në pamundësi për t'i shkruar të gjithë, pasi numri i tyre është i madh: Jonuz Gjoka, Sami Kamberi, Seit Rama, Osman Kala, Mehmet Hysa, Lik Dufi, Enver Pasha, Ahmet Kamberi, Enver Hysa, Bujar Pata, Shaban Hysa, Agim Hysa, Luan Hysa, Ali Meta, Sadik Plaku, Nazmi Plaku, Hasan Gjura, Dilaver Rama, Islam Hysa, Destan Rama, Hysen Kamberi. Flutra Dufi,Hatixhe Gjoka, Rudina Gjura etj..

Fshati im i dashur! Jam krenar që jam biri yt.

Ti më linde, më mëkove, më rrite, më mësove të të njoh më shumë vlerat e tua. Historia jote me rrënjë të thella në shekuj e deri në ditët e sotme, lavdia jote më japin krahë për të fluturuar nga Kulla e Skëndërbeut e deri në fushën e malit, nga bregu i lumit e deri në majën e Temlës për të shijuar bukurinë tënde, aromën e këndshme të luleve, ajrin e freskët, të shoh nga lart të gjithë bashkëfshatarët e mi që lëvizin si milingonat e dheut për t'i rrembyer natyrës pasurinë më të çmuar, të mirat materiale.

Sa do të dëshiroja që një ditë ne, intelektualët e fshatit, të mblidhemi në një ditë vere, të ulemi në hijen e drurit, që ne e quajmë Druri i Male Zeqirit, ku mblidheshin të parët tanë. Aty të diskutonim me nostalgji për vitet e fëmijërisë për lojërat e bukura, për shkollën, për punën, e pse jo ndonjë kontribut sado modest i yni do të ishte mjaft domethënës për fshatin tonë, që e duam aq shumë.

Mirënjohe e respekt për ju, pa fund.

Rruga e Arbërit nr. 99

sport



Flet kampioni i ri i Europës
në boksin profesionist Gjetan Keta

Titullin tjetër **do ta fitoj** në Shqipëri!

Një titull tjetër në Shqipëri! I saposhpallur Kampion Europe, djaloshi shqiptar 31- vjeçari nga Bulqiza, Gjetan Keta, nuk ngurron të deklarojë menjëherë se ky titull është dhuratë për të gjithë shqiptarët.

Edhe pse vetëm 21 ndeshje në karrierën e re si boksier, prej të cilave 18 fitore, 15 me "nokaut", vëllai i Kampionit të Botës në Kik- Boks, Ismail Ketës, bëhet tashmë numri 1 në ringun profesionist, duke tërhequr vëmendjen jo vetëm në Gjermani, ku jeton që nga viti 2005, por në gjithë Botën.

Pasi doli fitues i turneut europian në Kik- Boks në Tiranë në vjeshtën e vitit 2007, titulli që fitoi më 19 korrik 2014 ishte kulmi si sportist profesionist në Mynih, qytetin në të cilin jeton.

Si duket, fejesa e pak ditëve më parë me një studente nga Bulqiza në Universitetin e Tiranës, i solli mbarësi për të bërë "pronë" ëndrrën tjetër të jetës, titullin kampion Europe në boks.

Gjithashtu, po këtë mbrëmje, një tjetër Ketë (Feriti), është shpallur Kampion i Gjermanisë në Kik-Boks. Feriti ka zhvilluar 18 ndeshje, nga të cilat 16 fitore dhe 2 humbje. Gjetani dhe Feriti stërviten, si trajner, nga vëllai i tyre, Ismaili, i cili edhe ky është shpallur tri herë Kampion Bote në Kik dhe Taj-Boks....

Gjetani, menjëherë pas ndeshjes ka folur për gazetën "Rruga e Arbërit", për suksesin e fundit.

- Gjetan, si erdhi ky titull dhe sa t'u desh të presësh?

- Është titulli im i parë si kampion Europe dhe më bën shumë të lumtur. Kam vite që merrem me sport, por fillimisht kam nisur me Kik dhe Taj-Boks. Pas vitit 2007 vendosa të futem në boks, sepse vëllai im, Ismaili, një kampion i njohur në të tilla sporte, shikoi tek unë cilësi të mira në ringun e boksit. E nisa dhe më eci përgjithësisht mbarë. Kjo ishte ndeshja e 21-të, duke numëruar 18 fitore dhe 3 humbje, ndërsa 15 ndeshje janë fituar me "nokaut". U deshën vite, sepse konkurrenca në boksin profesionist është tejet e madhe. Nuk ka qenë e lehtë që të vinte kjo ditë, sepse kam kohë që jam stërvitur, por mendoj që erdhi shpejt, kur mendoj vitet që kam...

- Ç'mund të na thoni për kundërshtarin që kishe përballë?

- Ishte gjeorgjiani Mishel Kotsishvilli, një boksier shumë i fortë me 61 ndeshje të luajtura dhe thuajse të gjitha të fituara. Ishte mjaft i rrezikshëm dhe kishte një përvojë interesante.

Ëndrra ime është që një titull ta fitoj në Shqipëri, në prani të sportdashësve shqiptarë dhe vëllezërve të mi që jetojnë atje. Edhe këtu më mbështesin shumë shqiptarë dhe më duhet t'i falënderoj, por si atje s'ka vend në Botë; vjen era Shqipëri, era tokë shqiptare.

Imagjinoje, tri herë e hodha nokdaun në raundin e 5-të dhe u ringrit sërish e boksonte si të ishte fillimi i ndeshjes. M'u desh shumë punë për ta ulur. Në raundin e shtatë, pas një goditje në ije, mbeti pa frymë dhe nuk u ngrit më.

Natyrisht, që u ndjeva shumë i lumtur dhe më në fund mora frymë lirisht, tashmë si kampion, një titull që e prisja prej kohësh.

- Kujt ia dedikon këtë sukses të radhës dhe kaq të rëndësishëm?



Ferit Keta, kampion i Gjermanisë në Kik & Taj Boks



Ferit Keta u shpall Kampion Gjermanie në Kik & Taj Boks. Ai është vetëm 25 vjeç dhe ka zhvilluar 18 ndeshje dhe ka fituar 16.

Para katër vitesh, me ëndrrën për sportin, ai është nisur drejt Munihut dhe është stërvitur nga kushëriri i tij, Ismaili. "Feriti ka goditje të fortë dhe pret goditje të forta", thotë trajneri i tij, Ismaili. Kundërshtari në finale ishte gjerman dhe pati fatin, që ndërsa kushëriri i tij shpallej kampion Europe në boks, ai të shpallej kampion I Gjermanisë.

Feriti tani bën një jetë mes Tiranës dhe Mynihut. Ai kryen punën e trajnerit në qendrën sportive të vëllezërve Keta pranë maternitetit të ri në Tiranë. Pesë djemtë shqiptarë që fituan në Mynih në turneun e fundi, kanë brenda edhe suksesin e tij si trajner.

- Ia dedikojë të gjithë shqiptarëve që më ndjekin dhe më admirojnë kaq shumë; Gjermanisë, vendit ku unë u bëra sportist i niveleve të tilla dhe Ambrës, vajzës shqiptare që vuan prej tumorit në spital prej një viti në Mynih dhe tashmë është bërë si vajza jonë. Por s'mund të lë pa përmendur vëllain tim, Ismailin, pa të cilin s'do të isha ky që jam sot, kampion dhe sportist kaq i fortë.

- Gazetat gjermane ju kanë quajtur "një egërsirë e pandalshme". Si e konsideroni etiketimin e tyre?

- Ju gazetarët përdorni shprehje dhe tituj të tillë. Unë jam një njeri që bëj detyrën në sport dhe mendoj se titulli ishte objektivi im dhe detyra ime për të qenë fitues. Kam punuar shumë për këtë ditë dhe kur beson te vetja dhe puna, s'ka gjë që nuk arrihet. Rëndësi ka që të vazhdoj kështu, duke kërkuar trofe dhe suksese të tjera, sepse sporti i ngjan një rruge të gjatë, e cila ka stacione, por s'ka fund...

- Tashmë pas këtij titulli, cili është stacioni tjetër?

- Më duhet ta mbroj titullin që fitova në vjeshtë, sepse e tillë është rregullorja në këtë sport dhe më pas të mendoj për titullin "Kampion Bote". Ëndrra ime është që një titull ta fitoj në Shqipëri, në prani të sportdashësve shqiptarë dhe vëllezërve të mi që jetojnë atje. Edhe këtu më mbështesin shumë shqiptarë dhe më duhet t'i falënderoj, por si atje s'ka vend në Botë; vjen era Shqipëri, era tokë shqiptare.

- Ju mbani në krah portretin e heroit tonë kombëtare Gjergj Kastriot Skënderbeu dhe asnjëherë nuk e fshihni atdhetarizmin tuaj? Pse?

- E kam të trashëguar prej gjyshit tim. Në shtëpinë tonë shkruhet mbi një gur: "Atdheu mbi të gjitha"!... E dua shumë vendin tim, sepse jo vetëm e kam amanet, por edhe vëllai im Ismaili, më edukoi gjithnjë me të tilla virtyte. Thashë, ëndrrën e madhe që kam dua ta bëj realitet shumë shpejt, për të bërë një ndeshje në Shqipëri. Dua t'i gëzoj ata njerëz dhe t'i bëj të ndjehen krenarë!

cyan magenta yellow black

botime

Një këndvështrim mbi librin "Ushtria Çlirimtare Kombëtare" i autorit dibran, Dr. Gëzim Ostreni

Një **libër** më i mirë se qindra **armë**!

Nga **SHPËTIM CAMI**



Libri është një kontribut shkencor në fushën e studimeve për menaxhimin e krizave. Zgjerimi i analizës së thelluar të kapitujve të tij janë objekt studimesh universitare apo studiuesish të historisë dhe të marrëdhënieve ndërkombëtare.

Ai mund të radhitet në enciklopedinë shqiptare si një burim madhor informacioni, shkruar nga një prej aktorëve kryesorë të kësaj historie.



Çdo konflikt apo krizë ka një histori dhe, kur ajo studiohet e plotë, shërben më shumë dhe prej saj nxirren mësime, duke shërbyer si një përvojë me vlera të shumëfishta.

I tillë na vjen në dorë libri enciklopedik, "Ushtria Çlirimtare Kombëtare" e Dr. Gëzim Ostrenit, një nga drejtuesit e kësaj ushtrie, organizator i rrallë, për të cilin kishin aq shumë nevojë shqiptarët në atë periudhë.

Në luftën e 2001-shit, strateg ushtarak në Hagë, dëshmitar mbrojtës me argumente, sot një studiues dhe doktor shkencash, që merr përsipër ta shkruajë këtë histori e për ta bërë atë të pavdekshme.

Duke e trajtuar me fakte e dokumente historinë e popullit shqiptar, autori na sjell në vëmendje që në fillim, pozitën e shqiptarëve në Maqedoni, duke na argumentuar se diskriminimi etnik, klasor, fetar, administrativ, politik, shoqëror, ka shërbyer dhe shërben si burim pakënaqësie e brendshme deri në nivelin e një konflikti të armatosur.

Me shembuj të shumtë nga zona ku është lindur e rritur, por edhe me statistika zyrtare për statusin e shqiptarëve në Maqedoni, autori e fillon analizën që në fillim të shekullit XX me kontributin për Shpalljen e Pavarësisë, me ngjarjet e rënda gjatë luftërave ballkanike, duke e vazhduar me analizën e Luftës Nacional Çlirimtare.

Analiza e pozitës së shqiptarëve në Maqedoni bëhet e plotë edhe për periudhën e pas Luftës së Dytë Botërore deri në vitin 1991, kohë në të cilën Maqedonia shpall pavarësinë dhe miraton Kushtetutën e saj.

Pikërisht te kjo Kushtetutë autori na thekson se janë shkaqet kryesore të zhgënjimit dhe rritjes së pakënaqësisë së shqiptarëve dhe fillimin e një lëvizje politike për ta kundërshtuar atë si dhe për të fituar të drejta të plota.

Kjo lëvizje politike përbën edhe hapat e parë të një konflikti, që nga pikëpamja shkencore, trajtohet si një konflikt i brendshëm në një shtet.

Menaxhimi dhe zgjidhja e konflikteve të brendshme nga pikëpamja e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe zgjidhjes së konflikteve janë shumë më të ndërlikuara sesa menaxhimi i konflikteve midis dy shteteve.

"Njohja e shpejtë e kësaj kushtetute dhe e shtetit të ri, - shkruan autori - e vështirësoi zgjidhjen e të drejtave të shqiptarëve, pasi në këtë mënyrë konsiderohen të zgjidhura problemet e brendshme dhe roli ndërkombëtar për zgjidhje zvogëlohet".

Autori na sjell një argument interesant dhe një faktor më shumë në prodhimin e konfliktit. Ato janë mjetet e informimit publik. Radiot, televizionet, gazetat, tashmë, kanë një frymë ekstreme antishqiptare. "Në qoftë se i hedhim një vështrim veprimtarisë së tyre, atëherë kjo gjendje është keqësuar pa masë".

Çka u arrit nga qëllimet e partive politike në Maqedoni? – pyet përsëri autori në vazhdim të analizës së tij, duke na sjellë në vëmendje një temë të trajtuar më 5 shkurt 1994 me titull: "Aspekte teorike dhe praktike të zgjidhjes së çështjes shqiptare në Maqedoni".

Nga kjo analizë autori arrin në përfundimin se faktori politik dhe ai intelektual nuk ishin në gjendje të merrnin përsipër të zgjidhnin çështjet e të drejtave të shqiptarëve në Maqedoni.

Cila do të ishte zgjidhja e radhës? - do të pyeste lexuesi apo studiuesi, pasi do të njihej me historinë e plotë të ndodhive të kohës.

Edhe pa e ditur se çfarë do të ndodhte në Maqedoni më vonë, përgjigjja, nga pikëpamja shkencore, vjen e drejtpërdrejtë. Radhën e kanë protesta dhe konflikti i armatosur, mjetet e fundit për garantimin e lirive dhe të të drejtave të njeriut.

"Kryengritja nisi në rajonin Tanushë të Shkupit - shkruan autori - prandaj duhej me shpejtësi të bëhen të gjitha përpjekjet për transformimin e saj nga disa turma njerëzish, në forcë me strukturë dhe hierarki të zhvilluar".

Në këndvështrimin tim, këtu qëndron çelësi i strategjisë, largpamësisë dhe përvojës për të udhëhequr një luftë, për të arritur fitore dhe për ta mbrojtur atë pas fitores.

Jemi në fillim të vitit 2001, ku puna fillon me organizimin dhe konsolidimin e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK, truri i organizimit të luftës dhe zgjidhjes së konfliktit.

Autori na përshkruan faqe pas faqeje të këtij libri të gjitha masat organizative, strategjinë ushtarake, taktikat, shtrirjen territoriale, platformat politike, dokumentet dhe strukturat organizative si dhe zhvillimin e shpejtë të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare për të përballuar një konflikt të brendshëm të armatosur dhe me sa më pak pasoja në njerëz.

Duke na e paraqitur në një kapitull të veçantë veprimtarinë e Diplomacisë Proaktive, autori na provon shkencërisht, se sa i vështirë dhe kompleks është veprimi i diplomacisë dhe faktorit ndërkombëtar në konfliktet që krijohen brenda një shteti.

"Në një hark kohor shumë të shkurtër nga fillimi i luftës, UÇK-ja arriti të realizojë planin e luftës dhe të vendosë kontrollin mbi zhvillimet e ngjarjeve" - e fillon autori kapitullin "Planifikimi i paqes".

Të detyruar nga kjo epërsi e UÇK-së, autori na prezanton fazën e re të planeve për paqe dhe negociata, ku sigurisht kërkohet vigjilencë, aftësi negociuese, njohje e vazhdueshme e veprimeve dhe e strategjisë së shtetit maqedonas, mbrojtje e interesave të shqiptarëve, komunikim me faktorin ndërkombëtar dhe rritjen e angazhimit të tij, mbajtjen në gatishmëri të ushtrisë për veprime luftarake apo tërheqje kur është e nevojshme, nën udhëheqjen e përfaqësuesit politik z. Ali Ahmeti dhe Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së.

Si produkt të të gjithë kësaj veprimtarie intensive, autori na paraqet me detaje arritjen e Marrëveshjes së Armëpushimit më 6 Korrik 2001, të kërkuar me aq këmbëngulje edhe nga ndërkombëtarët si NATO, SHBA, BE dhe OSBE.

Cilat janë hapat pas arritjes së një marrëveshjeje politike?

A do ta respektojnë atë palët nënshkruese? Cili do të jetë qëndrimi ndërkombëtar ndaj kësaj marrëveshjeje? Cili do të jetë roli i faktorit ndërkombëtar në vazhdim? Cilat do të jenë kushtet e dy palëve për arritur paqen e plotë dhe realizimin e kërkesave të shqiptarëve të arritura me mjetin e fundit në një konflikt siç është lufta e armatosur?

Të gjitha këto pyetje marrin përgjigje nga autori duke na i përshkruar, hap pas hapi, me durim dhe me dokumente, veprimet dhe qëndrimet e dy palëve deri tek finalja, që është ndryshimi i Kushtetutës, dorëzimi vullnetar i armëve dhe sigurimi i amnistisë të pjesëtarëve të UÇK-së.

Libri është një kontribut shkencor në fushën e studimeve për menaxhimin e krizave. Zgjerimi i analizës së thelluar të kapitujve të tij janë objekt studimesh universitare apo studiuesish të historisë dhe të marrëdhënieve ndërkombëtare.


Ai mund të radhitet në enciklopedinë shqiptare si një burim madhor informacioni, shkruar nga një prej aktorëve kryesorë të kësaj historie.

Ky libër është një mësim i mirë për lidershipin ballkanik, që ka prodhuar e prodhon çdo ditë konflikte që prej më shumë se 100 vitesh.

Një libër si ky, është më i mirë se qindra armë!

Faleminderit Gjeneral, për këtë pasuri të madhe që na ke sjellë në duart tona!

Botim i ri



William Shakespeare
50 sonete të Shekspirit
Përkthyer përballë origjinalit,
nga Naim Berisha

Botimet M&B
ISBN: 978-9928-172-32-7
Nr. faqeve: 112
Çmimi: 400 lekë

Botimet e Shtëpisë Botuese M&B, mund t'i gjeni pranë librarisë në Rrugën e Dibrës, në rrjetin e librarive "Adrion", libraria "Eva" pranë Pallatit të Kulturës, Libri Universitar si dhe në pikat e shpërndarjes së librit.

Të gjitha sonetet e Shekspirit janë perla poetike që të mrekullojnë, më së shumti, sepse ato u bëjnë jehonë kryeveprave botërore, tragjedive dhe komedive të tij. Kontradikta të pashmangshme na kujtojnë përplasjet e tmerrshme që hasen tek "Hamleti", "Othello", "Makbethi", e tjerë.

Ju, lexues të nderuar, do t'i shijoni vetë këto thesare. Lum ata, që do të kenë shansin t'i lexojnë këto sonete magjepsëse të Shekspirit, të lavdisë më të madhe letrare në botë, në të dyja gjuhët, si në gjuhën origjinale të autorit, ashtu dhe në shqipen tonë, e cila, gjithashtu, tingëllon po aq bukur dhe madhërishëm sikundër anglishtja! - Naim Berisha

Naim PLaku na la mjaft tekste këngësh, ku fjala e zgjedhur, e gdhendur për merak, nuk i lodhte as kompozitorët e as këngëtarët...



Naim Plaku *la gëzimin dhe dhimbjen*

Nga **Dr.FEJZULLA GJABRI**

Për Naim Plakun gjithkush flet, se, çdonjërin që ta pyetësh, ka se ç'të flasë. Ka një jetë të mbushur më punë intelektuale, me poezi, prozë poetike, me kërkime etnografike, kërkime etnologjike, folklor e botime të shumta.

Na la Naim Plaku. Na la dhe na la veprat e shkruara me përkushtrim ndaj Dibrës dhe kombit. Lindi në Sllatinë të Dibrës më 14 Nëntor 1940. Veç vlerave të trungut sllatinas, Naimi është nipi i Elez Isufit, të cilësuar tashmë "Gjenerali me shajak".

Në vitin 1958 caktohet mësues në 7-vjeçaren e Fushë- Alijes, pastaj në Ceren të Kalasë së Dodës, në Shumbat e në Sllovë për shumë vite, pastaj në Zall-Dardhë e Ostren të Gollobordës. Për nevoja pune (jo se e deshën fort) punon pran Shtëpisë së Kulturës të rrethit, nevoja të cilat i kishte përballuar duke qenë mësues; e emruan fillimisht metodist e më pas drejtor në shtëpinë e Kulturës "Haki Stëmilli" të Peshkopisë, gjer sa doli në pension. Naim Plaku nuk ka dekorata të nalta, apor ka dekoratën e madhe, të mijëra nxënësve e prindërve që punoi për ta. Sigurisht edhe për vete.

Ç'NA LA NAIMI?

Nuk kërkoj të përgjigjen të tjerët, kur kam shumicën e veprave të tij në bibliotekën time. Ai la: Vargje për fëmijë, na la këngë dasme. rite, na la vëllimin "Këngët e Korabit', na la vëllimin 470 faqesh me folklor nga viset e Dibrës, me titullin mitologjik shqiptar "Krojet e zanave", na la "Fllad e frullizë", na la "Sikur të mos ishte Seta" dhe së fundi, monografinë e fshatit të tij "Sllatina".

Jo, na la më shumë, la një rubrikë më humor në gazetën "Rruga e Arbërit", me një titull të njohur popullur, por të përdorur bukur "Fjalë në sepete".

Na la mjaft tekste këngësh, ku fjala e zgjedhur, e gdhendur për merak, që nuk i lodhte as kompozitorët e as këngëtarët. I kam dëgjuar vetë këngëtarët te iu lutë: Aman, mësues Naimi, na bëj një tekst kënge që të më përshtatet mua. Kam dëgjuar edhe kompozitorë te iu lutë për tekse. I jam lutë edhe unë për librat e tij.

Fjala 'la' do thotë më shumë se ato që kreu, ato që i këmi në dorë, ato që u bënë publike, ato që kënaqën leguesit, studiuesit e dëgjuesit. Fjala 'la' thotë edhe se Naimi la shumë pa kryer, la shumë pa i publikuar. Kam dëgjuar se në komjuterin e tij la edhe vepra të përgatitura. Këto la Naimi.

Mbi të gjitha, Naimi ka pse të jetë i qetë, se la djem, la familjen që e kujton, po la edhe të arfërm e miq që e kujtojnë me mall.

Këto la Naimi.

PSE VUAJTI NAIMI?

Ashtu i qetë, si shumica e poetëve popullorë, me hallet historike dhe të kohës së re, vuajti shpirtërisht. Vuajtja fizike është e rëndë, po më e rëndë është vuajtja shpirtërore. Dhe Naimi ka një veçori: Diti ta përballojë dhimbjen shpirtërore pa rënkime, pa ankime.

Vuajti se, për Naimin dhe autorët e teksteve të këngëve, kompozitorë të një kohe jo të largët, ka qenë ndryshe, sigurisht shumë ndryshe nga ditët e sotme. Të shkruaje një tekst kënge, duhet të kishe parasysh ca pika, të cilat nuk duhej t'i shkelje. Ishin disa kuadrate, të cilave duhej t'u qëndroje me strikt, të mos kaloje aspak më tej, ndryshe të zinte 'farkofshi' (nëperka).

Kontraste natyre që ngjasonin me kontraste shoqërore: "..gërryenin parreshtur ..zemrën e plakur..". Prap me të gjallët: "Hynin dhe zogj e lule, pranvera me borë të bardhë e dimra me cingërima, djepe të përmbysur e shtretër nusesh të lagura më pshertima".

Ja këto mendime të qeta e shpesh kryengritëse ashtu në heshtje, pra vetëm në shpirt, me ofshamën e fyellit, ofshan dhe poeti popullor Jo se s'dinte të ankohej, po kujt se? Diku në vëllimet e tij, konstaton: "Tek qoshja ku isha futur, nga ajo dritarja e vogël e shtëpisë në fshat, vështroja mëngjeset e bukura të qullura me vesë dhe mbrëmjët e trishtuara që laheshin me dritën e verdhë të hënës. Shikoja rrëketë ..."..

Metaforë? Po, po metaforë e jetës së tij!

EPIK, LIRIK DHE STUDIUES

"Fluturo, Shqipe...", një këngë që vazhdon të këndohet në ditët e sotme. Teksti: Naim Plaku. Naim Plaku i freskët, që në moshën 20-vjeçare shijon këngët e Kalasë së Dodës, ndoshta pa e ditur se më vonë do t'i vendosë në visarin e trashëgimisë, siç mund ta quaj vëllimin "Krojet e Zanave", pa i lënë "të vdisnin brenda meje", siç thotë vetë autori. Kalon fshat më fshat nga veriu në jug, nga Lura në vargmalet Korab – Gramë - Deshat, e prej andej brigjeve të Drinit për t'u ushqyer me baladat e bukura të tij, që disa prej tyre të bëjnë të pikëllohesh.

Vargu i tij popullor vërtet u shijua nga mijëra artdashës në interpretimin e këngëtarëve të njohur kombëtarë si Lirie Rasha, Arif Vladi, Cajhe Poleshi, Sherif Dervishi, Qerim Sula e dhjetëra të tjerë, po Naimi ku ishte!? Disi i mënjanuar, apo i anatemuar. Merrej krijimi, teksti i këngës, po ku ishte Naimi? Nuk thuhej se ... ishte koha...

Një cikël i veçantë i lirikave popullore të këngëve të mërgimit, dashurisë dhe natyrës, mund të them se është një poemë, që i ka të gjitha tema jetësore: dashuria njerëzore, malli për njeriun e larguar nga shtëpia, toka, natyra, bagëtia, meraku etj. Pra cilkël i plotë. Nuk janë vetëm krijimet artistike; ka botuar shumë artikuj shkencorë për çeshtje të gjuhës, të folklorit e mësimdhënies në shtypin perodik si " Mësuesi", "Studime pedagogjike", "Studime filologjike", "Gjuha jonë" etj.

Ka qenë bashkëpunëtor i Institutit të Gjuhësisë dhe Institutit të Kulturës Popullore, ka marrë pjesë në shumë ekspedita kërkimore shkencore për mbledhjen e leksikut, të folklorit etj, në vise të ndryshme të Shqipërisë ,që janë përfshirë edhe në botimet e këtyre institucioneve, apo janë arkiv.

VLERËSIMI?

Deri në vitet '90 të shekullit të kaluar, gjitha këto punime janë vlerësuar me një distiktiv "Mësues i dalluar"! Më pas, Naimi ka "Mirënjoje" nga Këshilli i Komunës së Sllovës dhe "Qytetar Nderi i Qakut" nga Këshilli i Qarkut të Dibrës". Dy vlërësime shumë të rëndësishme. Sigurisht që i takonte më shumë. Po, mbi të gjitha, ka veprat e shkruar, që s'vdesin kurrë.

* * *

Për Naim Plakun gjithkush flet, se, çdonjërin që ta pyetësh, ka se ç'të flasë. Ka një jetë të mbushur më punë intelektuale, me poezi, prozë poetike, me kërkime etnografike, kërkime etnologjike, folklor e botime të shumta. Ndërsa ata që s'e ose e njohin pak, po u themi që në fillim, se mund të kenë dëgjuar këngën "O, prite Azem Galicën", kënduar në vitet '80-të. Është teksti i Naim Plakut, që e këndon Arif Vladi. Kur dëgjonim zërin e bukur të këngëtareve Cahje Puleshit, Liri Rashës e të tjerë këngëtarë dibranë, shumë pak e dinin se prapa tyre ishte poezia e Naim Plakut. U thuri vargje figurave historike, Drinit plak, Korabit etj. I qetë, "i urtë" (në thonjëza se ashtu ishte puna), por poet. Ndoshta nuk duhet thënë më.

homazh

Naimi ishte si ata poetët trubadurë që në Mesjetën e hershme u prinin ushtrive në fushat e betejave. Ata ishin si të gjithë luftëtarët, madje më të rrezikuar se nuk kishin armë për t'u mbrojtur, por në vijën e parë luftonin.

Tani *do të jemi edhe* **pa Naimin**

Nga **XHAFER MARTINI**

Ndërsa po punoja mbi monografinë kushtuar folkloristit të shquar Hilmi Kolgjegja, po rrekesha për të reflektuar mbi karakterin e poezisë si një art shumështresor, të shtresave që i shikojmë dhe i përceptojmë, por edhe të atyre që nuk i shikojmë, por i ndjejmë e i përjetojmë. Janë këto të fundit që prodhojnë shoqërim idesh, paralelizma dhe krahasime të pashprehur, gjendje emocionale që nuk ka fuqi t'i bëjë vetëm teksti pa nëntekstin.

Duke e vërejtur këtë dukuri tek krijimtaria e Naim Frashërit, Shaban Sinani shkruan: "Vjershëria e Naimit dhe letrarësia e tij në përgjithësi do të vazhdojnë të pasurohen në të dyja rrugët: përmes zhvillimit të herëpashershëm të traditës së shkrimeve të tij për të, si dhe përmes leximeve alternative, që çdo brez do t'i ofrojë vetes". Rexhep Qosja në veprën "Porosia e madhe", kushtuar po Naim Frashërit ka treguar si është lexuar Naimi para Shpalljes së Pavarësisë, si është lexuar ai ndërmjet dy luftërave botërore dhe si është lexuar pas Luftës II Botërore, çka do të thotë se vepra e Naimit mbart ide dhe kuptime të reja. Tekstet e fiksuara e bardha mbi të zezën, të palëvizshëm, të pandryshuar, kur kemi të bëjmë me art të vërtetë, pasurohen vazhdimisht me mendime të reja, të freskëta. Kjo ndodh jo vetëm kur lexohen nga breza të ndryshëm njerëzorë, por edhe nga një njeri i vetëm në kohë dhe rrethana të ndryshme.

Ndërsa po përpiqesha, pra, për të qartësuar këtë problem, më vjen njoftimi se vdiq poeti dibran Naim Plaku. Krejt pa dashje, krejt spontanisht, më erdhi ndërmend poezia e Çajupit "Vdiq Naimi" të cilën fillova ta recitoja me zë të ulët. Mbase kjo ndodhi për faktin se Naim Plaku kishte të njejtin emër me poetin Naim Frashëri. Por ndërmendja e vjershës së Çajupit nuk m'u nda për një kohë relativisht të gjatë dhe unë u shtyva në mendime të kërkoja një arsye më shumë veç përkimit të emrave të dy poetëve të kohëve dhe të përmasave të ndryshme. Po të kishte vdekur një poet tjetër me emrin Naim, zor se do më kishin trokitur në nënndërgjegjen time me aq këmbëngulje vargjet e Çajupit për Naimin e madh.

Kjo dëshmon se çdo krahasim në nënndergjegjen tonë ka dy krahë që funksionojnë së bashku, në të njejtën kohë, ndihmojnë njeri-tjetrin dhe harlisin përfytyrimet dhe shoqërimin e ideve, i japin, me pak fjalë, vjershës së shkruar shekuj më parë një kuptim të ri, e bëjnë të freskët dhe më aktuale . Në rastin konkret dhimbja e Çajupit për Naim Frashërin është kaq e madhe dhe e fuqishme sa e nxë edhe dhimbjen time për Naim Plakun, çka dëshmon që shtresat dhe shtresimet, kuptimet e nënkuptimet, të fshehtat dhe përvëlimet janë veti e artit të madh dhe jo e çdo lloj krijimi. Por kjo dëshmon edhe një gjë tjetër: këto krjime të mëdha e të fuqishme të trokasin sërish në mendje në situata pak a shumë të afërta me ato që i kanë lindur.

Megjithatë, unë nuk do ta shkruaja një shkrim si ky nëse do të mbetesha me atë përfytyrimin e çastit, sepse do ta quaja diçka të rastit. Por situata të tilla, të ngjashme dhe të afërta nuk m'u ndanë gjatë gjithë asaj dite. Dy orë më vonë, kur unë shkova të pija një kafe dhe të takoja dhe të ngushëlloja njerëzit e familjes dhe të afërmit e Naim Plakut, ishte e pamundur të rrija pa




Naim Plaku na bashkoi me jetën, me këngën, por na bëri bashkë edhe me vdekjen. Këtë nuk e bëri thjesht pse qemë, pse u mblodhëm për një qëllim, por pse qëllimi u pasurua me përmbajtje të re, me gjendje të re emocionale nga ato që krijojnë vetëm arti dhe artisti i madh.

ngushëlluar këngëtarët e njohur dibranë Arif Vladi, Liri Rasha, Qerim Sula e të tjerë, që suksesin në fushën e këngës ia dinë për nder jo vetëm natyrës, zërit të tyre të bukur, por edhe teksteve të mrekulleushme që ka bërë Naim Plaku. Ne ishim shkrimtarë, poetë, këngëtarë dibranë që këtu në Tiranë nuk do të mblidheshim të gjithë bashkë, po të mos na *kishte mbledhur* Naimi. Prapë një shoqërim idesh që është shprehur në titullin aq shumë të goditur të Kadaresë për librin e tij kushtuar ngjarjeve në Kosovë: "Ra ky mort dhe u pamë". Tjetër ishte morti i Kosovës, tjetër i Naimit, por, edhe pse, në mënyra dhe përmasa të ndryshme, morte ishin dhe ta kujtonin njeri-tjetrin.

Naim Plaku na bashkoi me jetën, me këngën, por na bëri bashkë edhe me vdekjen. Këtë nuk e bëri thjesht pse qemë, pse u mblodhëm për një qëllim, por pse qëllimi u pasurua me përmbajtje të re, me gjendje të re emocionale nga ato që krijojnë vetëm arti dhe artisti i madh.

Dhe përfytyrimet, shoqërimi i ideve, asociacionet, shembëlltyrat e krahasimet atë ditë nuk kishin të mbaruar. Njëri prej të pranishmëve bëri një pyetje të çuditshme: "A i keni çuar fjalë Ali Ahmetit?"

Por pse do të vinte një njeri tashmë i njohur, një ndër krerët kryesor të politikanëve shqiptarë në Maqedoni? Pse do të vinte një njeri me emrin e të cilit, njihet ajo lavdi e re e popullit shqiptar që jeton në trojet e tij në ish-Republikën e Maqedonisë, që u kurorëzua me Marrëveshjen e Ohrit, që, mjerisht, nuk po zbatohet kurrë!? Pse do të vinte, pra, një nga ata njerëz që, kur rriten në famë dhe në pozitë, nuk "i shkep" kollaj



Naimi Plaku nuk qe vetëm poet që krijoi tekste këngësh shumë të bukura. Ai qe edhe një mësues i dalluar prej të cilit merrnin përvojë edhe mësuesit e tjerë, qe edhe një mbledhës i pasionuar i folklorit, qe një njeri me shumë prirje dhe talente, por unë po i qëndroj "linjës" që kam kapur dhe dua t'ua lë të tjerëve të shkruajnë hollësira për Naim Plakun.

nga puna që kanë? Por pyetja nuk ishte e pakuptimtë. Edhe në këtë pyetje vepronte po ai mekanizëm i fshehtë, që vepron në artin e madh, po ajo përshfaqjeje e përfytyrimeve, shembëlltyrave, shoqërimit të ideve ku një gjë të kujton një tjetër, ku tashmë objekt i një shtresimi kulturor dhe artistik, mendor dhe filozofik, nuk është një poezi, por vetë jeta që në momente të caktuara vë përballë shumë dukuri që mendja e zakonshme ose mendja në "pozicionin normal" nuk i prek fare. Ali Ahmeti katër vjet më parë, në kremtimin e 70-vjetorit të ditëlindjes së Naim Plakut, ndër të tjera, tha: "Mua dhe shokëve të mi, kur luftonim për të drejtat e popullit shqiptar, na jepnin zemër dhe na hidhnin në flakën e betejave këngët e mrekullueshme që këndonin Arif Vladi, Liri Rasha, Qerim Sula, dhe të tjerë këngëtarë, por në atë kohë unë nuk e dija që tekstet e tyre aq të fuqishëm i kishte bërë Naim Plaku!"

Pra, Naim Plaku në një kuptim kishte qenë në luftën që bënte Ali Ahmeti me shokë për të drejtat e shqiptarëve në Maqedoni. Naimi që mezi merrte frymë dhe mezi qëndronte në këmbë nga sëmundja, ishte baraz me një brigadë luftëtarësh nga ata më të mirët, dhe "luftonte" bashkë me Ali Ahmetin dhe trimat e tij në një nga frontet për të drejta kombëtare. Prandaj edhe pyetja që u bë, nuk ishte pa kuptim.

Naimi ishte si ata poetët trubadurë që në Mesjetën e hershme u prinin ushtrive në fushat e betejave. Ata ishin si të gjithë luftëtarët, madje më të rrezikuar se nuk kishin armë për t'u mbrojtur, por në vijën e parë *luftonin*. Lufta e tyre ishte kënga, ishin vargjet. Prandaj ato përfytyrimet, ato nënkuptimet, shtresimet kulturore e artistike, nuk u krijuan kot në mortin e Naim Plakut. Dhe nuk ishte vetëm përkimi i emrit me poetin e madh që ta kujtonte vjershën "Vdiq Naimi!"

Por Ali Ahmeti nuk ishte lajmërar, dhe nuk erdhi, nuk ishte lajmëruar as Radio Televizioni Kombëtar Shqiptar që të jepte një lajm, kurse Pallati i Kulturës në Peshkopi, Këshilli i Rrethit që Naimin e ka shpallur Qytetar Nderi, Bashkia e qytetit të Peshkopisë, komuna e Sllatinës që e ka shpallur gjithashtu Qytetar Nderi, më duket se nuk u përfaqësuan me asnjë njeri. Të paktën, një mikrobuz me njerëz duhej të kishte ardhur nga Dibra se Naimi ka bërë shumë për Dibrën.

Në një vjershë për veten (Fyelli) Naim Frashëri ka shkruar:

"Kraharor e kam shpuar
e kam bërë vrima-vrima!"

Kështu e kishte prej kohësh edhe Naim Plaku kraharorin. Ja, pra, edhe *një* e *përbashkët* e tyre.

"Vdiq Naimi, po kush mbeti?!

Si Naimi s'ka të tjerë!"

Këto vargje, natyrisht, janë thënë për Naim Frashërin. Krahasimet gjithnjë çalojnë, sidomos kur i bën në emocion e sipër, por edhe si Naim Plaku për tekste këngësh të fuqishme nuk ka të tjerë. Ja, vdiq Gjok Beci, vdiq edhe Naim Plaku. Po kush mbeti!? Tekste këngësh prapë do të bëhen, por jo si ato që bënte Naimi.

Naimi Plaku nuk qe vetëm poet që krijoi tekste këngësh shumë të bukura. Ai qe edhe një mësues i dalluar prej të cilit merrnin përvojë edhe mësuesit e tjerë, qe edhe një mbledhës i pasionuar i folklorit, qe një njeri me shumë prirje dhe talente, por unë po i qëndroj "linjës" që kam kapur dhe dua t'ua lë të tjerëve të shkruajnë hollësira për Naim Plakun.

Sot Pallati i kulturës është i heshtur, s'dëgjohet asnjë instrument, ngase komuna është e varfër, Ministria dorështrënguar për këto anë, prekatarët shuhen.

Dibra të bëjë më tepër për artin e kulturën e saj

Nga **PETRIT FETAHU**



Dibra,qytet i lashtë e më i zhvilluar në të kaluarën në regjion,me arkitekt vizionarë ndërtimi dhe me gravurë artistike të brendshme dhe të jashtme, i kuvendit të burrave endigjian dhe gjenialë, përveç tipareve trimërore, zgjuarsisë dhe bujarisë, njihet edhe si qendër e qytetërimit,ku arti dhe kultura patën rritje të vazhdueshme që nga ahengjet e dasmave, kur ekzekutonin me çifteli,këngë e valle dyshe autoktone burrash dhe grash, qe zhvilluar edhe fjala artistike, përmes komunikimit alegorik, satirik dhe humoristik të rrëfimeve, të anekdotave, përrallave origjinale, të rrëfimeve metaforike dhe simbolike nëpër odat e burrave, ku qe shfaqur intuita krijuese, ndaj treva e Dibrës ka krijuar opus të pasur folklorik në të gjitha zhanret.

Pra, dibranët kanë një krijimtari të bollshme nga lëmi i kulturës, artit, letërsisë, muzikës, shkencës, kanë dhënë emra të njohur e me dije, ku përmendet Seit Najdeni, Josif Bageri, me veprën "Kopsht malësori", Vehdi Dibra, Haki Stërmilli, letrar dhe historian, Hafes Ismet Dibra, studiues i zellshëm, Haki Sharofi, monograf, Mahmud Hysa, studiues, Eqerem Basha, shkrimtar e përkthyes e shumë të tjerë. Pra,dibranët kanë pririje, talent dhe aftësi, që i kanë trashëguar nga tradita e pasur, bazament për brezat e ardhshëm, por u mungon përkrahja institucionale nga persona përkatës dhe përgjegjës dhe biznesmenëve të ndërmarrjeve, ngase Dibra ka shumë të rinj krijues në lëmë të ndryshme që hapin perspektivë, ndaj duhet të formohet një fond në mbështetje të tyre për identifikimin e talenteve, për kultivimin e pasioneve dhe afiniteteve me prirje arti, kulture, muzike, kënge, koreografie, letërsie etj.

Komuna e Dibrës disponon një fond për kulturën, por shpesh këto mjete minimale janë derdhur më shumë vetëm në lëmin e sportit, konkretisht në atë të futbollit dhe thuajse më pak janë destinuar për cytjen e stimulimin e të rinjve të talentuar në veprimtaritë artistike, si në botimin e veprave të krijuesve të rinj, të valltarëve, këngëtarëve, instrumentistëve, aktrimin dhe aktiviteteve të tjera, për të vazhduar kontinuitetin për ardhjen e brezave të talentuar. Por kjo s'mund të arrihet vetëm me fondin komunal, pa kontributin edhe të pronarëve të bizneseve të mëdha dhe fitimprurëse, vetëshërbimeve, argjendarive të qytetit, si "Dashi Komenrc", Banjat e Dibrës-Capa, ndërmarrjet ndërtimore Erebara, Jani, Kolari etj. Biznesmeni Rusi nga Amerika, që disponon fitme të mëdha, nuk ka derdhur asnjë metelik për këtë qytet dhe për zhvillimin e tij në çdo aspekt. Edhe një aktivitet që ka hapur e ka hapur për fitime personale. Këta pronarë derdhin para nëpër restorante luksoze, nëpër muzika me këngëtare tra-la-la, ndërsa bëhen dorështrënguar për t'u bërë donatorë aktivitetesh krijuese dhe artistike, për të lënë emër në historinë kombëtare. "Arti dhe literatura dalin nga morali i shoqërisë, spiritualizmi nga shpirti i popullit" - ka thënë Giosue Corduci.

Nga e kaluara jonë s'kanë mbetur të paharruar vetëm emra shkrimtarësh, por edhe emra tregtarësh, fabrikantësh e të tjerë të kamur, që kanë kontribuar gjatë Lëvizjes së Rilindjes në financimin e veprave të veprimtarëve krijues e patriotik që, gjithashtu, kanë zënë vend në faqet e historisë sonë. Përmendet Dhimitër Mborja, kurbetqar nga Bukureshti, pronar restoranti, i cili, përveç aktiviteteve patriotike, botoi marshe me karakter nacional, si "Bod i lirisë" dhe "Kongresi i Dibrës". Nikolla Naço, i cili nga Korça emigroi në Egjipt, ndërtoi dy fabrika e vuri pasuri marramendëse, por bleu në Paris shtypshkronjë e në Bukuresht dhe tërë pasurinë e harxhoi për botimin e librave shqip, vepra të Naim Frashërit etj., por i mbeti nami dhe zë vend të rëndësishëm për kontributin e tij për çështje kombëtare dhe arsimore-kulturore, që s'do ta arrinte kurrë me veprimtarinë tregtare. Këtë duhet të ndjekin edhe pronarët e mëdhenj, që të venë nga ndonjë gur në themelet e krijimtarisë krijuese e kulturore të Dibrës me financimin e tyre, se vetëm ashtu lartësojnë veten, mbeten në historinë tonë të lavdishme, se vetëm ashtu do të mund të identifikohen talentet me prirje, që do t'i japin qytetit, kombit, vlera të dalluara që do të mbesin për të ardhmen, se vetëm ashtu do të mund të zhvillohen aktivitete të bujshme kulturore-artistike.

Nëse s'lamë asgjë të shkruar, si trashëgim brezave të ardhshëm, ne kemi humbur pjesë të jetës, të së kaluarës dhe të identitetit tonë kombëtar për t'ua transmetuar të tjerëve që të vazhdojnë më tej, humbim nga vetja vetitë shpirtërore, morale dhe edukative, jetën tonë të tashme si dëshmi për të ardhmen, ngase Dibra ka rini me prirje në shumë lëmë të artit, por mungon vetëm përkrahja dhe organizimi i mire për t'u shfaqur ato vlera. Në të kaluarën e afërt në qytete funksiononin dy SHKA, "Liman Kaba" dhe "Dibra", që krijuan një reputacion me nam jo vetëm brenda, por edhe jashtë, që merrej me kultivimin e folklorit, nga dolën emra të përmendur këngëtarësh, si Sulejman Borova, Violeta Turkeshi etj. Një kohë u aktivizua edhe grupi i serenadave "Penestia" dhe në Dibër zhvillohej Festivali i këngëve qytetare, por s'i gjen asnjë prej tyre.

Sot Pallati i kulturës është i heshtur, s'dëgjohet asnjë instrument, ngase komuna është e varfër, Ministria dorështrënguar për këto anë, prekatarët shuhen. Edhe ato pak mjete që ndahen, derdhen pa kriter, pa vizion, vetëm kur ka ndonjë manifestim jepen me një grusht, në vend që të formohet një grup valltarësh, instrumentash dibranësh të pasionuar kontinuiteti.

Ndaj duhet investuar në këtë lëmë nga donatorët, nga pronarët, nga tregtarët, nga Komuna dhe Ministria, por duhet edhe individë që të bëjnë organizimin, programet, projektet dhe mënyrat për gjetjen e mjeteve, ngase kemi obligim të mos lëmë të shuhet thesari ynë shpirtëror.

Dibra dhe **reforma** territoriale

Nga **BESNIK ALKU** *

NEVOJA PËR REFORMËN

Nevojën për këtë reformë e kanë theksuar të gjitha qeveritë, si ajo që iku, edhe kjo që është, pasi ndarja aktuale nuk i përgjigjej ritmit dhe kërkesave të zhvillimit.

Ndarja e fundit territoriale i përket fillimit të viteve 1990 dhe Njësite vendore të dala nga ajo reformë përkonin me territoret e kështillave të bashkuara të kooperativa dhe qyteteve që në shumë raste krijuan një fragmentarizmi artificial, nuk i përgjigjeshin lëvizjes demografike që ndodhi në këto 24 vite që u shoqërua me fenomenin e largimin ose prurjeve të popullsisë, ishte pengesë për planifikimin dhe menaxhimin urban dhe të territorit, pengesë për zhvillimin ekonomik, keq administrimit të pushtetit lokal, staf jo-profesional, udhëheqës që vinin si produkt i klaneve dhe cilësi e ulët e shërbimit ndaj komunitetit sidomos të atyre bazë si furnizimi me ujë të pijshëm, menaxhimi i mbetjeve urbane, arsimi, shëndetësia etj.

Pra, nevoja për një reformë territorial që do jetë me më pak njësi vendore dhe e fokusuar në përmirësimin e administrimit të territorit, të zhvillimit ekonomik lokal, të ofrimit me cilësi të shërbimeve publike etj. ishte e nevojshme

MANIPULIMI POLITIK

Reforma e propozuar ka shumë kundërshti nga një spektër i gjerë i grupeve të interesit. Kundërshtitë që vijnë nga forcat politike kryesore për interesa politike. Kryetarët e njësive vendore humbin fuqinë, privilegjet dhe vendet e punës, komuniteti humbet traditën administrative të krijuar, të tjerët kanë interesa protagonizmi, spekullimi etj.. Por pavarësisht nga interesant, procesi dhe produkti i dalë nga drafti i propozuar i munguan principet në të cilat bazohej kjo reformë, si gjithëpërfshirja, barazia, fokusi në rezultate të matshme, objektivi i qartë, pranueshmëria, kriteret të qarta, etj. Nuk u bë asnjë përpjekje serioze për të ftuar dhe përfshirë gjithë spektrin politik në këtë proces.

Politikëbërësit e lartë, procesin e reformës e panë si ndarje tokash dhe hartash, ku më i fuqishmi përcaktonte më shumë njësi në zonën e tij, duke pasur një numër më të madh njësish se në zonat e tjera.

Kështu, Bashkim Fino që ishte përgjegjës për dështimin e procesit të parë të reformimit të pushtetit lokal, ish-ministër i pushtetit lokal, është lideri i reformës së re, në Qarkun e Gjirokastrës, ku janë 4 deputetë dhe 4 ministra, ka më shumë njësi vendore se në Dibër. Po ashtu në qarkun e Beratit, etj. Kjo influencë politike bëhet me qëllim që të kemi më shumë njësi, më shumë ndere dhe vende pune për njerëzit tanë, më shumë fonde nga qeveria qendrore e cila është në duart e tyre, sepse në ndarjen e fondeve për njësitë vendore do të bëhen për njësi, jo për banorë. Dhe kjo deformoi procesin politik, kur në skenë dolën grekët dhe çamët, të cilët duan të ndajnë dhe fshatrat, mundësisht mëhallat, fiset dhe familjet, duke sajuar dhe një kriter të drejtave të njeriut për mbrojtjen e pakicave. Çfarë do të ndodhte sikur dhe romët të kërkonin njësitë e tyre vendore, LGBT të kërkonin të tyren apo gratë e trafikuara të kishin njësinë e tyre?

Opozita nuk ka dhënë një sinjal ose alternativë, edhe zërat se çdo zonë elektorale të jetë një njësi vendore nuk është e studiuar dhe nuk përputhet me funksionin e njësisë vendore.

Pra, në këtë kontekst, politikanët e manipuluan procesin dhe produktin e kësaj reforme, duke u nisur nga motoja "të ndajmë tokat, se pastaj i gjejmë bujqit që ta punojnë atë".

MUNGESË E STUDIMEVE TË FIZIBILITETIT

Megjithëse nga shumë organizata dhe donatorë janë bërë disa studime fizibiliteti cilësore për ndarjen territorial në Shqipëri, politikëbërësit nuk u mbështetën tek asnjë studim si model. Nuk paraqitën asnjë referencë studimi fizibiliteti dhe kriteresh se ku bazohej ndarja territoriale. Kështu, asnjëherë nuk u përcaktua se sa do të jetë përfitimi ekonomik i bashkimit të njësive vendore, sa do përmirësohen shërbimet, sa do jetë reduktimi i shpenzimeve administrative, si do jetë struktura qeverisëse e ardhshme, cilat do të jenë marrëdhëniet me njësitë që nuk do të jenë më me njësinë e re të madhe të krijuar, cilat do të jenë profilet e këtyre njësive cila do jetë marrëdhënia me qarkun, a do të kemi rajone, cila do jetë baza ligjore, a do të kemi ndryshime në ligje, e shumë e shumë çështje të tjera.

DIBRA NË NDARJEN E RE TERRITORIALE

Qarku i Dibrës është një nga 12 qarqet e Shqipërisë dhe u formua nga 3 rrethe: Dibër, Bulqizë dhe Mat me 35 njësi vendore të ndara në 31 Komuna dhe 4 Bashki (Peshkopi, Bulqizë, Burrel dhe Klos). Dibra në këtë variant të propozuar nga 35 njësi të qeverisjes lokale parashikohet të ketë 4 njësi bashkiake, Peshkopi me 14 komunat e rrethit të Dibrës, Bulqiza me 8 Njësite e rrethit të Bulqizës, Klosi me 4 Njësi të qeverisjes, dhe Burreli me 7 Njësi. Praktikisht 4 bashkitë ekzistuese do të jenë qendra të njësive të ardhme vendore, sipas këtij drafti të propozuar.

Nëse bazohemi në kriterin se si janë ndarë njësitë vendore në qarkun e Gjirokastrës dhe Beratit, atëherë Dibra duhet të kishte 7 ose 8 Njësi vendore si: Kastrioti me komunat Kala, Sllovë, Reç, Fush-Çidhën, Arras, Muhurr, Lurë dhe Selishte; Peshkopia me komunat Melan, Tomin dhe Luzni; Maqellara me komunat Shupenzë dhe Gjoricë; Ostreni me komunën Trebisht; Bulqiza me komunat Zerqan, Fushë-Bulqizë, Martanesh; Klosi me komunat Xiber, Suç, Gurë; Burreli me komunat Komsi, Lis, Derjan dhe Ulza me komunat Bazë dhe Rukaj.

Por kjo nuk është ndarja e mirë. Ajo ngjason me një bashkim artificial të njësive vendore, ashtu siç janë bërë disa herë njësitë tona. Kështu Ulza dhe Baza dhe një pjesë e Rukaj janë të gjitha njësi të Mirditës, por për arsye politike në të kaluarën për të ndarë krahinën e Mirditës kaluan me Matin. Edhe Krasta është e krahinës së Martaneshit që i takon malësisë së Tiranës dhe shumë komuna të tjera periferike që afrojnë dhe ngjasojnë me qendrat e mëdha fqinje.

Në Dhjetor të vitit që kaloi u mbajt një studim i bërë nga DLDP, një program i financuar nga Qeveria Zvicerane, dhe që bazohej në metodologjinë e Zonave Funksionale, që bazohet në ndërveprimin në një hapësirë gjeografike mes njerëzve, institucioneve bizneseve, dhe që nuk përfaqëson një linje politike. Studimi u bazua në pesë kritere bazë që u përgjigjen një grupi pyetjesh dhe të dhënash për ndërveprimi dhe tendencën ekzistuese ku njerëzit janë të Punësuar, ku bizneset janë të përqendruar, ku konsumi është më i madh/tregjet, ku janë të përqendruar shërbimet bazë si arsimi, shëndetësia, kulturara, bashkëpunimi ndërmjet njësive vendore dhe mundësia e bashkëpunimit ndër-kufitarë, infrastruktura rrugore dhe lehtësirat e biznesit. Bazuar në këto kritere u përcaktuan katër zona funksionale potenciale të cilat lidhet me qendrën aktuale te rretheve që janë qytetet e Peshkopisë, Bulqiza dhe Burreli.

Autorët e studimit si zonë të katër funksionale përcaktuan zonën e Maqëllarës së bashku me Shupenzën, Gjoricën, Ostrenin dhe Trebishtin si zonë potenciale për bashkëpunim me Dibrën e Madhe ku janë dy pika kufitare, dhe në tre zonat kemi tregje tradicionale dhe shërbime te reja tregtare dhe biznesi. Kjo zonë funksionale ka më shumë akses dhe funksione se zona e Klosit, si në numrin e popullsisë, dhe në shërbimet dhe mundësitë që ndërvepron.


Një ndikim shumë të madh në zonat funksionale luan dhe infrastruktura rrugore, e cila ofron shumë qendra periferike me qendra të tjera të zhvilluara si Miloti që është më afër për Ulzën se Burreli, apo zona e Gollobordës që nëse asfaltohet dhe rregullohet rruga është shumë afër Librazhdit dhe Elbasanit se Peshkopia dhe Bulqiza, apo nëse ndërtohet rruga e Arbërit komuna e Xibrit është shumë afër me Tiranën.

Pra nëse do të kërkojmë një reformë territoriale që nxit Zhvillimin ekonomik, që përmirëson shërbimet publike, të sigurojë një furnizim cilësor me ujë të pijshëm dhe menaxhojë mbetjet urbane, të planifikojë dhe mbroje territorin, të sigurojë një administratë të aftë dhe profesionale, Dibra duhet të kishte një ndarje territorial që bazohet në zonat funksionale që përmendëm më sipër.

** Autori është aktivist i shoqërisë civile dhe është pjesëmarrës në studimin mbi ndarjen territoriale, hartuar nga DLDP dhe financuar nga Qeveria Zvicerane*

Për opinione dhe komente mund të na shkruani në adresën: <rrugaearberit@gmail.com>
OPINIONET DHE KOMENTET E BOTUARA NUK SHPREHIN DOMOSDOSHMËRISHT QËNDRIMIN E REDAKSISË

vlerësim


Haki Sharofi


Raif Kadiu (1883-1943)

Edhe tani pas 100 vjetësh, por edhe në të ardhmen na detyrojnë të përulemi para tyre dhe t'i respektojmë.

100 vjet më parë, 14 prill 1914, ne qytetin e Peshkopisë, në xhaminë e vjetër, u hap shkolla e pare shqipe. Haki Sharofi dhe Raif Kadriu edhe tani pas 100 vjetësh meritojnë e do te meritojnë respekt.

Haki Sharofi dhe **Raif Kadiu**, kontributi i tyre për shkollën shqipe

Nga **AHMET ÇAUSHI** *

100 vjet më parë, 14 prill 1914, ne qytetin e Peshkopisë, në xhaminë e vjetër, u hap shkolla e pare shqipe. Haki Sharofi dhe Raif Kadriu edhe tani pas 100 vjetësh meritojnë e do te meritojnë respekt.

600 vjet pushtim romak, 500 të tjera – bizantin, 300 vjet luftë me serbët, të cilët synonin zhdukjen e farës shqiptare, kërkonin të zëvendësonin gjuhën shqipe me atë serbe. Ata ndërruan emrat e njerëzve, të fushave e luginave, të fshatrave e të maleve, gjithçka ishte shqiptare, duke përfshirë edhe tregimet për luftërat patriotike dhe legjendat. Ata e shtrinë luftën e tyre në të gjitha elementet e popullit shqiptar. Pushtimi 500 vjeçar turk e gjeti të lodhur popullin tonë, por jo të dorëzuar. Çdo pushtues synon të zgjasë sa më shumë pushtimin e tij. Populli ynë, i udhëhequr nga Skënderbeu dibran, në të kundërt të dëshirës së pushtuesve u dha jetë tërë elementeve të identitetit kombëtar. Rreth 25 vjetët luftë e fitore kundër turqve forcuan ndjenjat kombëtare dhe e bënë më të qëndrueshme gjuhën shqipe.

Mesi i dytë i shekullit të XIX solli ndryshime. Rusia fuqizohej. Përkrahte me të gjitha mënyrat popullsinë sllave të vendosur në Ballkan për ta pasur mbështetje kundrejt Europës ndoshta edhe Afrikës së Veriut. Turqia kish nisur rënien. Serbët e bullgarët të ndihmuar nga Rusia synonin tokat shqiptare. Edhe aleati i tyre në besim, Greqia, të njëjtin synim kishte. Në tërë Shqipërinë filluan me shpejtësi të fuqizonin kishat e vjetra dhe të hapnin të reja. Mjafton ta kishte emrin kishe edhe pse ishte 4 m katrorë, siç është ajo e Kërçishtit. Atje ishte detyrim të flitej në gjuhën e pushtuesit: serbisht, bullgarisht ose greqisht. Ndalohej kategorikisht të folurit shqip. Ata i shpallën luftë të hapur elementit bazë të identitetit, gjuhës shqipe. 2000 vjetët pushtim e luftëra nuk u mjaftuan për ta nënshtruar dhe asimiluar këtë shpirt të pamposhtur, prandaj vendosën të përdorin armën e fundit, të ndalonin të folurit shqip në kishë dhe jashtë saj, të asgjësonin elementin bazë të identitetit kombëtar Shqiptar. Feja ishte arma e tyre në këtë front. Njerëzit kërkohej të identifikoheshin sipas fesë: sllavë, grekë, latinë.

Feja Islame nuk është element identiteti siç kërkonin pushtuesit për të ndarë në parcela botën. Feja Islame u jep të drejtën popujve ta ndërtojnë jetën sipas kombësive. Në Kur'an thuhet: "E krijova njeriun në kombe dhe fise të njihen e të bashkëjetojnë. Më i shpërblyeri është ai që kryen këtë porosi." Huxhurat 13.

2-Ndër mrekullitë e kësaj bote është gjuha për çdo kombësi e cila është bazë e identitetit të çdo populli.

3-Shpirtrat tanë i solli Zoti në Shqipëri, në këto vise, për të jetuar, shijuar dhe për t'i mbrojtur nga të tjerët.

Edhe populli Shqiptar u krijua si komb më vete, me tërë elementet dalluese si gjuha, veshja, traditat, historia, legjendat etj. Kështu e krijoi Zoti dhe askush, as Turqia, as Serbia, as Rusia dhe askush tjetër nuk ka të drejtë ta nëpërkëmbi. Kjo është e drejta hyjnore e çdo kombi, pra edhe e popullit shqiptar. Turqia për t'ia arritur qëllimit të saj kurrë nuk e dha fenë Islame të plotë, ashtu siç e ka Kur'ani. Ajo e pasqyroi fenë Islame në sipërfaqe, aq sa ndihmoheshin qëllimet e saj: Puno se urdhëron Zoti, bindju sunduesit (nuk është dhënë e plotë), rri urtë, lexo Kur'an në gjuhën arabe edhe pa ia ditur përmbajtjen, falu, lutu, agjëro se je musliman. Këta ishin vetëm një pjesë e fesë Islame. Feja Islame ndalon të pushtuarit e popujve të tjerë. Ndalon dhunën mbi popujt e tjerë. Ndalon përhapjen e fesë me dhunë. Përjashton injorancën. Feja Islame edhe popullit Shqiptar i jep të drejtën të jetojë në vete si Turqit, Rusët, Arabët etj. Të tërë, serbë, bullgarë, turq, grekë etj., ishin kundër këtij grupi shqiptarësh.

Dibranët me zgjuarsi e guxim ditën të bashkojnë dashurinë e përkushtimin për atdheun me mësimet e fesë Islame e u bënë më të fuqishëm, më të organizuar dhe më të bashkuar, sepse feja Islame kishte normë të saj bashkëjetesën me të gjithë, pa përjashtim të besimit fetar. Edhe më parë e kish realizuar këtë. Le të kujtojmë kur në anën e djathtë të lumit Drin, njerëzit në përgjithësi ishin të besimit ortodoks dhe quheshin serbë, bullgarë etj., ndërsa në anën e majtë ishin të besimit katolik dhe quheshin latinë. Banorët e të dy anëve të Drinit pranuan fenë Islame për t'u quajtur Muslimanë shqiptarë. Së pari, për t'iu kundërvënë situatës, ndër më të vështirat në historinë e popullit tonë, hoxhallarët e dijetarët, hapën shkollë në çdo xhami. Quheshin mejtepe. Në të mësohej feja Islame në gjuhën arabe, jepeshin dhe njohuri matematike, gjeografie dhe biseda për luftërat patriotike. Në vazhdim të mejtepeve u hapën rruzhdiet, medresetë, e së fundi studentët më të mirë udhëtuan për në Universitetin e Stambollit. Në tërë këtë vazhdimësi shkolle fetare Islame, mësuan në thellësi përmbajtjen e Kur'anit, mësuan se Kur'ani urdhëronte me mësue dijen pa kufij, me dashtë e me u përgjerue për atdheun tënd. Kjo ishte detyrë edhe për shqiptarët. Tani ndjenjat kombëtare u bënë më të fuqishme. Tabani patriotik, e kaluara historike, luftërat e vazhduara të popullit tonë për liri e pavarësi, gjuha shqipe, veshjet dhe traditat kombëtare së bashku me fenë Islame, u bënë forcë e madhe, i dhanë dashuri e guxim shqiptarit për t'i bërë ballë situatës së krijuar. Nuk e kuptojmë pse studiuesit e kanë të vështirë ta thonë hapur këtë. Edhe Ben Blushi me prejardhje besimi ortodoks, shkruan në librin e tij të fundit: "Nëse nacionalizmi do të jetë një bimë që pritet të lulëzojë në xhunglën shqiptare, humusi i tij (ushqimi) do të jetë diçka tjetër, feja Islame." Feja Islame ka qenë tërë kohës ushqim nacionalizmi për të gjithë popujt, edhe për popullin tonë. Pushtuesit kanë abuzuar me këtë të drejtë Islame. Ja si e thotë këtë të vërtetë të marrë nga Kur'ani hoxhë Seid Najdeni në librin e tij "Fe rrëfenjësja e Muslimanit": "Sot për neve është bom farz (detyrë e domosdoshme) një orë e më parë t'i biem mrapa ditunisë, ta mësojmë bashkë me dituni të fesë, dituni e fesë jeton. Nuk është kjo dituni kundër fesë, si e xhexhim (dëgjojmë) me sy të dhembshëm prej disa njerëzve të verbuar, kjo tufë njerëzish quhen armiqtë e mëmëdhesë e të fesë."

Binomi fe atdhe formojnë nacionalistin në masën më të kënaqshme, formojnë atdhetarin e përkushtuar, të guximshëm e të vendosur, për ta bërë vendin e tij të pavarur e të begate. Tërë rilindasit dhe brezat e mëvonshëm u ushqyen me vullnetin për dije dhe dashurinë për atdhe. Të tëra i morën në mejtepet, rruzhdiet, medresetë dhe universitetet islame në qendër të perandorisë, që na kish mbajtur në pushtim rreth 500 vjet duke i dhënë këtij populli vetëm aq sa i interesonte pushtuesit. Në këto kohë delikate për liri e pavarësi lindën Haki Sharofi dhe Raif Kadriu. Ata dëgjuan në Odat Dibrane për të kaluarën krenare. Ata mësuan e morën dije në mejtepet, rruzhdiet e medresetë e së bashku formuan luftëtarët e lirisë.

Haki Sharofi lindi në Dibër të Madhe, në një familje intelektuale në vitin 1894. Ai vrapoi pas dijes brenda e jashtë qytetit të Dibrës së Madhe. Qe nxënës shembullor. Mbaroi shkëlqyeshëm mejtepin, rruzhdien, "Darulmual-limin" (shkollë dy vjeçare pedagogjike), mbaroi gjimnazin turk në Elbasan ku mësoi edhe frëngjishten, mbaroi edhe normalen e Elbasanit. Ai vazhdoi liceun e Manastirit, por për arsye ekonomike i ndërpreu studimet. Për pak kohë bëri punën e mësuesit në Gjurrah, të cilën e ndërpreu pasi shpërtheu lufta e parë ballkanike. Në pranverën e vitit 1913 shkoi me të atin (Islamin) në Stamboll. Nuk qe i kënaqur me jetën dhe as me punën e mësuesit në Turqi. Në gusht të vitit 1913 zbriti në Vlorë. Me ndihmën e Luigj Gurakuqit, 100 groshë në muaj, filloi e mbaroi një kurs pedagogjik në normalen e Elbasanit. Kursin e mbaroi në fillim të shkurtit 1914. Ai njihte alfabetin shqip të Stambollit. Njihte dhe alfabetin e Seid Najdenit dhe në vitin 1909 drejtoi një kurs me moshatarët e tij. U mësoi atyreve alfabetin e gjuhës shqipe. Këtë kurs e organizoi tek livadhet e Qernanincës. Me gjithë përpjekjet e vazhduara të Seid Najdenit, Vehbi Dibres, Sherif Langut, megjithëse numri i atyre që lexonin shqip ishte rritur shumë në qytet dhe në fshatra, gjendja politike vështirësohej më tej. Propaganda kundër gjuhës shqipe vazhdonte. Bindja e rilindasve dhe në vazhdimësi e inteligjencës së re të krijuar në Dibër të Madhe ishte vazhdimësia e ngritjes së shkollave dhe e të mësuarit shqip. Ishte elementi bazë i identitetit shqiptar. Sa mbaroi kursin pedagogjik Haki Sharofi iu drejtua qeverisë që ishte në Durrës me një kërkesë për të hapur një shkollë shqipe në Peshkopi. Për të marrë këtë kërkesë ndihmoi prefekti i Durresit Mehdi Frashëri. Haki Sharofi në Peshkopi gjeti përkrahjen e pakursyer të myftiut Raif Kadiu. Raif Kadiu kishte lindur në Dibër të Madhe në vitin 1883. Raifi filloi shkollimin në mejtepin, rruzhdien, medresenë dhe mbaroi universitetin e Stambollit për Teologji. Si të gjithë dibranët dhe shqiptarët tjerë, ata ishin brumosur me ndjenjat kombëtare të vendlindjes së tyre, me trashëgiminë atdhetarë të brezave të mëparshëm dhe me mësimet e fesë Islame, të cilat u jepnin popujve të drejtën e pavarësisë, forcë dhe përkushtim për liri e pavarësi. Raif Kadiu kishte trup të gjatë; mbante veshje drejtuesi fetar Islam, inpononte respekt e nderim. Ai u bë mbështetje e fuqishme e Haki Sharofit. I dha të drejtë mësuesit të ri të bënte mësim në xhami, në sallën ku mblidheshin e faleshin. Nuk kish as libra e as banka, as fletore e as lapsa. Morën secili nga një shkamb e një lëkurë për t'u ulur si në shtëpi. Sipas Mosi Murrës, Hakiu udhëtoi në këmbë nga Durrësi në Peshkopi. Problemet e shumta duheshin zgjidhur. Kush do të vinte në shkollë? A do të kishte shumë kërkesa? Çfarë do të mësonin në këtë shkollë? A do t'i lejonin prindërit fëmijët të mësonin alfabetin latin? Kishte akoma njerëz që e kundërshtonin këtë. Të tëra këto i përballoi dhe për të gjitha pati mbështetjen e Raif Kadiut. U rregjistruan 16 nxënës e më 14 prill 1914 u hap shkolla e parë shqipe në xhaminë afër përroit të Peshkopisë me mësues Haki Sharofin. Është e para shkollë shqipe në qytet e hapur me miratim qeverie. Me parë alfabeti i gjuhës shqipe mësohej nëpër bodrume, izma e vende të fshehta. Shkolla e parë shqipe vazhdoi punën vetëm 6 muaj. Atë e mbylli Esat Pashë Toptani, i cili grisi flamurin shqiptar e vendosi atë turk në mes të qytetit. Të mësuarit në këtë xhami vazhdoi nga Raif Kadiu në mejtep. Haki Sharofi shkoi në Trojak, në konakun e Elez Isufit dhe vazhdoi t'u mësonte gjuhën shqipe djemve të Elezit dhe të afërmve të tjerë të tij. Ky të mësuar ishte privat e shumë kohë nuk u pagua Hakiu. Atje vazhdoi deri në vitin 1923. Haki Sharofi u emërua drejtor i internatit të Kastriotit, që filloi punën në dhjetor 1923. Me punën e kujdesshme e këmbëngulëse të Haki Sharofit u kthye në shkollë model, nxënës të së cilës edhe pse shkolla ishte vetëm 5 vjet, u bënë punonjës të administratës. Internati i Kastriotit u bë një shkolle kombëtare. Atje mësonin e bashkëjetonin nxënës shembullorë nga Dibra, qytete të tjera, Kosova, Dibra e Madhe, Shkupi etj. U bë edhe qendër e edukimit patriotik. Synimi i tij nuk ishte vetëm të siguronte një rrogë. Në zemrën e Hakiut kishte edhe ndjenja të fuqishme për jetën e banorëve të këtyre viseve. Ai dëshironte që fëmijët e të gjithë Dibrës të arsimoheshin. Në vitet 1923 – 24 ai nxiti fshatarët e dy Gjoricave, Cerenecit e Viçishtit për ndërtimin e një shkolle. Për këtë i prezantoi ministrisë së Arsimit kërkesën e këtyre fshatrave për ndërtimin e një shkolle. Më 9 shkurt 1924 dorëzoi në këtë ministri kërkesën e krahinarëve të Maqellarës për të hapur shkollë në Herbel, ku do të mësonin fëmijët e Dovalanit, Grezhdanint, Erebares, Pekës e Pjecës dhe Trepçës. Zgjodhi Herbelin sepse atje banonte një pakicë ortodokse. Qëllimi i Hakiut ishte që kësaj pakice t'i vinte në ndihmë dhe të bashkëjetonin fëmijët e këtyre fshatrave pa dallim besimi.

I mbeshtetur fort në interesat e kombit dhe porositë e fesë Islame u bë iniciator për të hapur një shkollë femrash në qytetin e Peshkopisë. Edhe këtu mësimet e fesë ishin shtrembëruar. Hakiu e dinte se feja Islame urdhëron arsimin e femrës. "Një mësuese e aftë, jo vetëm që ka me rritë e stervitë nënat e ardhshme, por shpresohet që të udhëheqë edhe nënat e sotme", kishte bindjen Haki Sharofi. Kjo shkollë u hap në qytetin e Peshkopisë në vitin 1924 nga mësuesja Nazmie Pasholli. Edhe për këtë u dilnin përpara vështirësitë e krijuara në shekuj. Mbështetje kryesore edhe për këtë problem që myftiu Raif Kadiu. Haki Sharofi dha mësim edhe në Krumë edhe në Vlorë. Ai njohu mirë dhe ishte shumë i shqetësuar në shpirt për gjendjen e varfër të popullit tonë siç ishte edhe për gjuhën shqipe. Me 10 / 4 / 1929 ai shkruante: "Pengimi më i madh tani për shkollë është varfëria e pashembull e këtij populli. Ç'do të bëjë mësuesi, kur nxënësit e shkretë, të zhveshur e të zbathur, të unët pa libra e pa lëndë shkollore, po vjen në shkollë duke u dridhur prej dimrit e prej urie." Të gjitha këto së bashku nuk e dorëzuan Haki Sharofin. Ata i dhane energji të mesojë fëmijët e popullit për të hedhë bazat e shpëtimit për të ardhmen. Në vitin 1931, ai së dyti kthehet në medresenë e Tiranës për të dhënë mësimin e gjuhës shqipe, në shkollën më serioze të Shqipërisë së atëhershme. Ai e vazhdoi mësuesinë deri në vitin 1951. Nxënësit e tij Shaban Demiraj (ish kryetar i akademisë së shkencave), Vexhi Buharaj, Vexhi Demiraj, Hivzi Shehu (Diber), Sali Ferati (Hoxha), Selim Muça, Ahmet Çaushi, Mehmet Shehu (Limjan), Medi Cani (Borove) etj., kanë patur kënaqësinë më të madhe se kanë pasur mësues Haki Sharofin.

Ai provoi dy herë burgun. E burgosi Ahmet Zogu. E burgosi edhe regjimi komunist pse nuk tregoi pasurinë e Sali Vuçiternit. Ai njihte mirë gjuhën turke, osmanishte, persishten, frëngjishten etj. Ai vitet e fundit punoi si shqipërues i osmanishtes në gjuhën shqipe. Haki Sharofi i futur thellë në problemet e popullit tonë, i pasqyroi ata me ndjenja të fuqishme dashurie, dhembshurie e gëzimi në shkrimet e tij. Gjuha Shqipe, bashkimi kombëtar, lufta për liri e pavarësi dhe vënia në rrugën e përparimit ishin tematikat e shkrimeve të tij. Ata ishin himn për rininë dhe popullin shqiptar. Krijimet e tij: "Flamuri Kombëtar", "Drin o lum i xhanë", "Një malësori", "Lutje për prindërit", "Lavdërim hyjnor" ishin thirrje që nxisnin edhe ngrinin peshë zemrat e atyre që i dëgjonin.

Seid Najdeni, Haxhi Vehbi Dibra, Haki Sharofi, Raif Kadiu, të cilët i nisën të arsimuarit në mejtepe, medrese, universitete Islame, sfiduan traktatin e Shën Stefanit, Kongresin e Berlinit, vendimin e ambasadorëve të Fuqive të Mëdha në Londër, të cilët, që të gjithë, bënë përpjekje të ndanin popullin e Dibrës në dy pjesë, shpirtërisht dhe në pozicion gjeografik. Këta lindën e u arsimuan në Dibër të Madhe, derdhën gjithë energjitë e tyre këtej kufirit që caktuan këta fuqi të mëdha e qëllimi i tyre ishte të ketë vazhdimësi të përjetshme lidhja e gjakut prej shqiptari të dibranëve në të dy anët e kufirit. Ata lanë detyrë për brezat e ardhshëm të vazhdojnë deri në përjetësi gjuha shqipe në të dy anët, lidhja martesore, marrëdhëniet kulturore dhe ekonomike, të mbështesim njëri-tjetrin sa herë t'i dhembë koka njërës palë dhe të luftojmë së bashku të gjitha ato dalje që synojnë të krijojnë shqetësime në të dy anët e kufirit. I ngjan shqiponjës me dy krerë por me një trup.

E kam në kujtesë mësuesin tim Haki Sharofi, viti shkollor 1950-1951 – në medresenë e Tiranës. E donim fort. E prisnim çdo mëngjes të vinte e i dilnim përpara me vrap për ta përshëndetur. Ishte gjithmonë shumë i pastër. Vishej me shumë prezencë. I shkonin shumë shalli i bardhë e i punuar me dorë në qafë, pantallonat e hekurosura dhe këpucët gjithmonë të bojatisura, aq sa kujtoje se vishte çdo ditë këpucë të reja. Ishte shume serioz, trup shkurtër e i shpejtë në ecje. Tregonte shumë dinamike. Kur profesor Hakiu dilte nga drejtoria e i drejtohej klasës, tërë nxënësit vraponin për të zënë vend në heshtje të plotë, ngriheshim në këmbë e nuk uleshim deri sa të na thoshte: "ulu". Në klasë edhe miza kur fluturonte dukej se e respektonte mësuesin, nuk dëgjohej zhurma e saj. Fliste me ndjenja, veçanërisht kur na rekomandonte tregime letrare ose nga shkrimet. Na dukej se mësuesi dhe ne përjetonim realisht përmbajtjen e tregimit.

Këto vlera edhe tani pas 100 vjetësh, por edhe në të ardhmen na detyrojnë të përulemi para tyre dhe t'i respektojmë.

** Myfti i Dibrës*

Rruga e Arbërit nr. 99

takim

Përkujtohet në Tiranë 60-vjetori i semimaturës
(klasës së shtatë) të parë të shkollës së Kastriotit

Takim vëllazëror, si **60 vjet** më parë kur ishin fëmijë

Nga **ALI HOXHA**

Më 7 qershor 2014 një grup shokësh nga Dibra, ish-nxënës të shkollës shtatëvjeçare të Kastriotit, të cilët i kryen mësimet në vitet 1951-1954, u mblodhën në Tiranë për të përkujtuar 60-vjetorin e mbarimit të klasës së shtatë, që përkon njëherësh edhe me 63-vjetorin e fillimit të ciklit të sistemit të arsimit 7-vjeçar në shkollën e Kastriotit. Viti 2014 përkon edhe me 90-vjetorin e Internati "Dibra" të Kastriotit.

* * *

Shkolla fillore në Kastriot është hapur për herë të parë 90 vjet më parë, në vitin 1924, në sistemin me pesë klasë dhe me konvikt, prandaj njihet me emrin "Internati "Dibra" i Kastriotit", në të cilën morën mësimet e para fëmijët nga zonat e veriut si: Dibra, Mati e Luma, ndërsa si nxënës të jashtëm vijonin edhe djem të fshatrave për rreth Kastriotit.

Shkolla 7-vjeçare e Kastriotit është vazhduese e drejtpërdrejtë e Internatit "Dibra" të Kastriotit, pavarësisht se pas djegies së saj gjatë Luftës së Dytë Botërore, ajo në reformën arsimore të vitit 1946, u kthye në sistemin me katër klasë. Ndërsa në vitin 1951, në Kastriot u hap për herë të parë klasa e pestë e ciklit të sistemit 7-vjeçar. Ajo është e treta shkollë në rrethin e Dibrës pas asaj të qytetit të Peshkopisë (1946) dhe më pas të asaj të Shupenzës.

Mësuesi i parë që hapi klasën e pestë ishte z.Muntas Nasufi, nga Maqellara, kurse drejtor shkolle për atë vit shkollor 1951-1952 ishte Ahmet Laçi, njëherësh dhe mësues në ciklin e ulët.

Në vitin e dytë shkollor 1952-1953, kur u bënë dy klasë (të pestë e të gjashtë) z.Xhelil Kulemani, u emërua drejtor për të dy ciklet, njëherësh edhe mësues i lëndëve të shkencave natyrore: si matematikë, fizikë etj. Kurse në vitin shkollor 1952-1953, kur u plotësuan të tria klasët (kl V-VII) kuadri arsimor u rrit në katër mësues, u emëruan dhe dy mësues të rinj të ardhur nga Shkodra: z.Hiqmet Dizdari dhe z.Ismail Simiça, dy maturantë të sapodiplomuar në shkollën Pedagogjike të Shkodrës, të cilët punën në arsim e filluan për herë të parë në Kastriot të Dibrës.

E veçanta e kësaj klase, klasës themeluese të ciklit të arsimit 7-vjeçar të vitit shkollor 1951-1952 të shkollës së Kastriotit, është se të gjithë nxënësit e regjistruar në atë klasë në shtator 1951, ishin vullnetarë të ardhur kryesisht jashtë zonës së detyrimit arsimor, nga Arrasi, Fushe-Alia, Laçesa, Blliçja e Rrenzi, në veri, dhe pastaj nga Sohodolli, Borovjani, Kishaveci e Rreth-Kale. Kurse në vitin e dytë, rrethi i nxënësve u zgjerua edhe nga katundet Sinë, Arras, Mustafej, Limjan, Vranjt e Shimçan etj.

Veçoria e dytë e kësaj klase është se, duke qenë vullnetarë, të gjithë nxënësit ishin djem, pasi në atë kohë konservatorizmi që pengonte shkollimin e vajzave, ishte ende i fortë.

Së treti, duhet theksuar këtu se, me përjashtime të rralla, pothuajse të gjithë nxënësit e asaj klase do të ishin kuadrot e parë të ardhshëm të zonës në sektorë të ndryshëm të ekonomisë e të kulturës, kryesisht arsimtarë, agronomë, mjekë, inxhinierë etj. pse jo, edhe politikanë, bile dhe disidentë (prej kësaj klase janë evidentuar dy të arratisur politikë dhe të dy të burgosur politikë).

Takimi i datës 7 qershor 2014 ishte takimi i tretë i radhës, sepse takimi i parë me rastin e 20-vjetorit, është organizuar në gusht 1974 në Peshkopi dhe i dyti me rastin e 25-vjetorit po në Peshkopi. Ndërsa kësaj here ky takim u organizua në Tiranë, pasi shumica prej tyre është vendosur me banim në rrethe në Tiranë, Durrës, Berat, Shkodër etj. Organizatorë të këtij takimi ishin Ali Hoxha, Lutfi Pira dhe Halit Bushi. Në fillim u mendua që takimin ta bënim në Kastriot, por për shkak të vështirësive të largësisë nga një rreth në tjetrin, si dhe të moshës,më i riu i asaj klase sot është 74 vjeçar, u vëndos që takimi të bëhej në qendër të Tiranës, te kompelksi Tajvan, më 7 qershor 2014.



Lista emërore e klasës së shtatë të vitit 1953-1954 të shkollës së Kastriotit ishte si vijon: Abas Bushi (Kishavec), Abdulla Halimi (Sohodoll), Ahmet Abdia (Sohodoll), 4-Ali Bitri (Laçes), 5-Ali Hoxha (Laçes), 6-Bajram Kadria (Bellovë), 7-Besim Sina (Rreth-kale), 8-Faik Dika (Manërkolli) (Rrenzë), 9-Haki Kaloshi (Kandërr), 10-Halit Bushi (Kishavec), 11-Hamdi Pira (Kishavec), 12-Hasan Hata (Brest i Poshtëm), 13-Ilias Suli (Çuni) (Fushë-Alie), 14-Jonus Shehu (Borovjan), 15-Lutfi Pira (Kishavec), 16-Maliq Kacani (Fushe-Alie),17-Mustafa Kurdedja (Sohodoll), 18-Nazif Koltraka (Kukej), 19-Ramis Bitri (Laçes), 20-Rasim Loka (Kishavec), 21-Rasim Kaloçi (Brest i Poshtëm), 22-Selman Kaca (Kishavec), 23-Sulejman Bajraktari (Arras), 24-Sulejman Koltraka (Kukej), 25-Shaban Raska (Laçes), 26-Shefki Sina (Rreth-kale), 27-Tofik Çanaku (Kukej), 28-Xhafer Mërdini (Sohodoll), 29-Xhemal Mani (Rreth-Kale), 30-Zek Muja (Kandërr).



Nga **HALIT BUSHI**

PËRSHËNDETJE DISI GAZMORE, SIÇ ISHIM NË MOSHËN TONË FËMINORE

Ishim fare të vegjël e me njëri-tjetrin të panjohur,
Kur na mblodhi shkolla n'atë kodër, jo për t'u ngrohur
Por për të mësuar e për t'u shkolluar
Se rrugë të gjatë na duhej për të përshkuar,
Mësues Mentasi e Xhelili vëndas, Ismaili e Ismeti nga Qytet' i Shkodrës
Na mblidhnin çdo ditë rreth vetes, si zogjtë e klloçkës.
Kur nga lodhja e padija, ne me zë të lart "cicërinim"
Mësuesit e dashur, me thërmija dijesh "gojën na e zinin"
Has pas hapi ne rriteshim e ata na mësonin
Dhe erdhi një ditë që në volejboll kundër tyre luftonim.
Kur dilnim fitues, Avdulla Halimi ja "thoshte culës",
Ne nga rrjeta s'e ndanim "topin e Sulës";
Dikush na tha: i vutë mësuesit në pikë të hallit,
Juve do të ju marrohen edhe thinjat e ballit!
Por ne ishim e mbetëm miq,
Fjala e tij nuk i doli hiq!
Jetë e SHËNDET JU UROJ, shokëve e mësuesve që rrojnë!
Kujtim, dashuri e respekt, ATYRE QË NA MUNGOJNË!

Në këtë takim erdhi Sulë Koltraka nga Dibra; Halit Bushi nga Berati; Sulë Bajraktari nga Shkodra; Nazif Koltraka nga Durrësi; kurse Ali Hoxha, Lutfi Pira, Bajram Kadria, Faik Dika dhe Xhemal Mani ishin mikpritësit. Po ashtu, përmes telefonatës ishte i pranishëm edhe Tofik Çanaku nga Peshkopia, i cili për arsye shëndetësore e ishte të pamundur të merrte pjesë në këtë takim.

Ali Hoxha bëri apelin e të gjithë ish-shokëve të klasës, të gjallë apo të vdekur, sipas alfabetit, i hartuar mbi bazën e fotografisë së klasës, dalë në pranverë të vitit 1954, si dhe duke e plotësuar për ata që mungonin në foto.

Duke llogaritur në këtë klasë edhe dy ish-nxënësit A.Bitri dhe F.Dika, të cilëve shërbimi ushtarak u ndërpreu klasën e shtatë në mes të vitit shkollor, si dhe dy të tjerët: B.Kadrinë dhe M.Kacanin, të cilët qenë transferuar për t'i ndjekur studimet me bursë në Peshkopi.

Takimi u zhvillua në një atmosferë vëllazërore, duke kujtuar me nostalgji disa nga momentet më prekëse që ishin ruajtur në kujtesën e të pranishmëve për ngjarje të ndodhura 60-63 vjet më parë.

Së pari, rikujtuam me respekt e dashuri, njëherësh edhe me dhimbje të gjithë ata mësues e nxënës që kanë kaluar në botën tjetër, duke filluar, së pari, me Ramis Bitrin, i cili në lule të rinisë, pasi mbaroi shkollën profesionale mekanike 2-vjeçare në Kuçovë, sapo filloi punën si eskavatorist, vdiq aksidentalisht në krye të detyrës, për hapjen e themeleve të Kombinatit Ushqimor të Tiranës, në lule të rinisë në vitin 1958, duke u bërë kështu edhe "dëshmori i parë i punës" për hapjen e themeleve të asaj vepre, që i ka rezistuar kohës edhe sot, ndonëse tashmë e privatizuar.

Po kështu, në moshë të re, pa arritur të dyzetat vdiq edhe Ilias Çuni (Suli) dhe më pas të tjerët, si Besim Sina, vdiq në emigrim në Sh.B.A. larg atdheut, edhe pse arriti ta vizitojë atë në kohën e demokracisë. Duke vijuar më tej me të tjerët si Abdulla Halimi, Ali Bitri, Hamdi Pira, Maliq Kacani, Rasim Loka, Selman Kaca, Shaban Raska, Shefki Sina dhe Xhafer Mërdini në nderim të të cilëve, u mbajt edhe një minutë heshtje nga të pranishmit.

Më pas, secili prej nesh tregoi nga një ose disa episode që i ruante në kujtesën e tij për ngjarje të asaj periudhe, nga të cilat po riprodhojmë këtu në ligjëratë të drejtë atë të Halit Bushit që e kishte pregatitur me shkrim një ditë më parë, enkas për këtë takim.

Në fund, para se të shpërndaheshim, u ra dakort që, nëse do të jetë e mundur, të mund të mblidheshim edhe një herë në Kastriot, në fillim të vjeshtës së këtij viti, në një mënyrë më të organizuar, nëse do të arrihet një bashkëpunim edhe me drejtorinë e shkollës në Kastriot dhe të Drejtorisë Arsimore të Qarkut të Dibrës për të rikujtuar njëherësh të dy përvjetorët e kësaj shkolle: edhe 60-vjetorin e semimaturës së parë, edhe 90-vjetorin e Internatit të Kastriotit.

Thirrje per sponsorizim

SHTËPIA BOTUESE "M&B" KA NË PROCES BOTIMI DISA LIBRA ME VLERA HISTORIKE, KULTURORE DHE KOMBËTARE PËR DIBRËN DHE GJITHË SHQIPËRINË:

Individë ose biznesmenë që dëshirojnë të bëhen bashkëkontribues në këto projekte, mund të na shkruajnë

në email: mbbotime@gmail.com/ botimemb@gmail.com ose në tel: 069 20 68 603. *Faleminderit!*

studim

Sfondi i këtyre veprave është ndërtuar mbi ngjarje të vërteta historike, kurse drama e personazheve është thurur mbi koncepte sentimentale dhe me tone melodramatike.

Gruaja dibrane në veprën e Haki Stërmillit

Nga **MENTOR HOXHA**
Master Shkencor në "Studime Letrare"

Dramat "Dibrania e mjerueme", "Dashuri dhe besniki", dhe "Agimi i lumnueshëm" "janë ndërtuar mbi episode të vërteta të kohës...

Stërmilli e paraqet gruan dibrane "jo vetëm si një shoqe besnike e të virtytshme, por edhe si luftëtare për mbrojtjen e interesave të atdheut...

Përsa u përket prurjeve dhe talenteve letrare, "periudha e viteve '30 -të, ose siç quhet ndryshe periudha e Pavarësisë apo periudha ndërmjet dy Luftërave Botërore, njihet si periudha më e çmuar dhe më frytdhënëse[1]. Një shkrimtar i shquar i këtyre viteve, i ndjeshëm kundrejt kohës e halleve të popullit, të cilat i përjetoi me vuajtje, ishte Haki Stërmilli[2].Nga krijuesit letrarë dibranë të së kaluarës, Haki Stërmilli pat bërë emër si rrallë ndonjë tjetër, sidomos me romanin e tij të mirënjohur sentimental *Sikur t'isha djalë*, i cili përjetoi një sukses të jashtëzakonshëm në kohën kur u botua, në vitet '30 të shekullit të kaluar. Botimi i parë i këtij romani, ai i vitit 1936, me një tirazh prej 1100 ekzemplarësh u shit shpejt, për më pak se një vit, kurse botimi i dytë, një vit pas (1937), doli në pesë mijë kopje. Dhe kjo ndodhte në një kohë kur Shqipëria kishte rreth një milion banorë dhe një shkallë tejet të lartë analfabetizmi, që përfshinte rreth 80% të popullsisë së përgjithshme.Edhe pse receptimi i gjerë i një vepre, nuk është gjithmonë tregues i vlerës së saj, megjithatë shndërrimi i romanit *Sikur t'isha djalë* të Haki Stërmillit në "bestseller", siç do të thoshim me gjuhën e sotme, është një fakt interesant dhe i pakalueshëm historiko-letrar[3].

Krijimtaria e Haki Stërmillit është e gjerë dhe e larmishme. Përfshin 12 vepra të gjinive të ndryshme.Talenti i tij u shfaq në vitet '20 -'30 me dramat "Dibrania e mjerueme" (1923), "Dashuni dhe besniki"(1923), "Agimi i lumnueshëm"(1924), "Irena e bukur"(1929), "Tania" (1930), "Kosovarja (1931-tragjedi), "Burgu" (1935-ditar),"Sikur t'isha djalë" (1936 -roman). Pas çlirimit u botuan "Trashëgimtarët tanë" (1950-dramë),"Kalorësi i Skënderbeut"(1965-roman), "Shtigjet e lirisë" (1967-ditar) dhe një vëllim me skica e tregime (1982). Është marrë dhe me studime e folklor të cilat i ka përmbledhur te "Fyelli i Dibrës" dhe "Dibra në prag të historisë" (dorëshkrim). Korpusi i tij letrar është botuar në 4 vëllime. I pari përmbledh romanet "Sikur të isha djalë" dhe "Kalorësi i Skënderbeut". I dyti, dramat "Dashuni e besniki", "Agimi i lumnueshëm", " Irena e bukur", "Tania", "Kosovarja", "Luftëtarët tanë" dhe "Trashëgimtarët tanë". I treti ka skica, tregime e publicistikë të shkruar në vitet '20 -'50. Ka nfragmente nga ditari "Burgu" dhe një fragment nga dorëshkrimi i romanit "Afsh dhe hove zemrash", i shkruar gjatë Operacionit armik të Dimrit 1943-1944, i katërti përmban ditarin e luftës "Shtigjet e lirisë", shkruar gjatë dimrit 1943-1944. Në këto vepra ka shumë ngjarje e personazhe nga Dibra.

"...Dibranët e veprave të Haki Stërmillit portretizohen me vetëdije të lartë kombëtare, ... si: Skënderbeu, Moisi Golemi, Hoxhë Voka, Elez Isufi, Mersim Dema, Ismail e Sadullah Strazimiri, Izet Bej Maqellara, Hafëz Sherif Langu e Eqerem Cami, Qamil Daci, Rifat Miza, Dine Bej Maqellara, Sejfedin Agë Pustina, Abdurrahman Tërshana, Safet Bej Kodra, Maliq Zeneli e deri te heroina dibrane Ibe Palikuqi dhe luftëtarët e tjerë të Lëvizjes Nacionalçlirimtare[4].

Dramat "Dibrania e mjerueme", "Dashuri dhe besniki", dhe "Agimi i lumnueshëm" "janë ndërtuar mbi episode të vërteta të kohës, disa herë me personazhe realë, marrë nga ngjarjet dramatike të Dibrës[5]. Në vitet '20 -'30 kur shkroi e botoi veprat kryesore të tij, gruaja dibrane dhe ajo shqiptare ndodhej në një pozitë të rëndë ekonomike e shoqërore. Statusi i saj në jetë e shoqëri ishte i kufizuar brenda mureve të shtëpisë, pa u përfshirë në çështje kombëtare ku cilat varej fati i atdheut dhe fati i saj për një jetë më të mirë dhe të barabartë me atë të burrave. Këto zakone e ligje të egra mesjetare të pashkruara dhe të trashëguara ndër shekuj, e kishin kthyer atë në një skllave, madje kishin ndrydhur dhe jetën e saj intime. Shumë nga veprat e tij, kanë në fokus gruan dibrane dhe përpjekjet e saj për të fituar liritë dhe të drejtat e saj të mohuara ndër mijëvjeçarë. Që në tregimet e para "Trimëria e gruas shqiptare", "Të fejuarit" etj, dhe në dramat e viteve '20 "Dibrania e mjerueme" (1923) "Dashuni dhe besniki" (1923), "Agimi i lumnueshëm (1924), Irena e bukur" (1929), "Tania" (1930), ai u vu në mbrojtje të vajzave dhe grave dibrane dhe shqiptare përmes zbulimit të cilësive dhe virtyteve të tyre më të mira. Personazhet femërorë në këto vepra janë figura qendrore dhe atdhetare të flakta dhe bashkëshorte dhe dashnore të denja e besnike. Jo pa qëllim dramave "Dibrania e mjerueme", "Irena e bukur", "Tania" e "Kosovarja" ai u vuri për titull emrat e kryepersonazheve femërorë.

"Sfondi i këtyre veprave është ndërtuar mbi ngjarje të vërteta historike, kurse drama e personazheve është thurur mbi koncepte sentimentale dhe me tone melodramatike[6].

ATDHETARIA E GRUAS DIBRANE NË VEPRAT E STËRMILLIT

Stërmilli e paraqet gruan dibrane "jo vetëm si një shoqe besnike e të virtytshme, por edhe si luftëtare për mbrojtjen e interesave të atdheut[7]. "Në radhë të parë paraqitet si atdhetare e mirë e pastaj si qenie që ngjall adhurim te të tjerët[8]. Nailja, Tushja e Lushja në dramat "Dibranja e mjerueshme", "Dashuri e besnikri", "Agimi i lumnueshëm", janë gra të reja që atdhetarinë dhe besnikërinë ndaj bashkëshortëve dhe të dashurve të tyre luftëtarë e atdhetarë e kanë kryefjalë të ndjenjës dhe të shpirtit të tyre. "...Nailja në "Dibranja e mjerueme", Tushja në "Dashuri e besnikri", Lushja në "Agimi i lumnueshëm" janë figura që bartin porositë e shkrimtarit dhe shprehin botë të pasur ndjenjash[9]. Me to pulson ardhmëria për të cilat ato japin edhe jetën[10]. Këto drama trajtojnë ngjarje historike nga epokat më të shënuara kombëtare të mesjetës dhe të luftërave që i prinë pavarësisë[11]. Janë ndërtuar mbi episode të vërteta të kohës, disa herë me personazhe realë, marrë nga ngjarjet dramatike të Dibrës[12].....Roli pozitiv që i jepet gruas në këto drama është bërë me qëllim që ajo të bëhet model guximdhënës për gruan në përgjithësi. Nailja, Tushja dhe Lushja u përkasin shtresave të ndryshme shoqërore, por që idealin e kanë të përbashkët: çlirimin e atdheut dhe përkrahjen e trimave të lirisë. ...Nailja dhe Tushja, jetën e kuptojnë si gëzim vetëm pranë të dashurve të tyre luftëtarë. Kanë lexuar shkrim e lexim të bindura se me dije më mirë mund t'i ndihmojnë atdheut të robëruar[13]. Për ta, dashuria për atdheun e pushtuar është më e fortë se ligjet e egra të kanunit që ndalonin pjesëmarrjen e tyre përkrah burrave që luftonin kundër pushtuesit. "Duke qenë të vetdijshme se atdheu është në rrezik ata nuk kursejnë asgjë për t'iu bashkuar të dashurve të tyre në këtë luftë të përbashkët për liri të atdheut[14]. Ky mendim i drejtë i tyre, që është fryt, jo vetëm i edukatës liridashëse, por edhe i emancipimit të tyre nuk miratohet nga burrat, të cilët mendojnë se vetëm ata janë të lindur për ta mbrojtur nderin e atdheut. Duke e konceptuar në këtë mënyrë konfliktin dramatik, Stërmilli u kundërvihet pikëpamjeve të vjetëruara të mashkullit për gruan. Sipas letërsisë së traditës dhe sipas normave zakonore, të ngulitura në vetëdijen kombëtare, është e natyrshme se burri duhet të luftojë dhe të vritet për ideale të larta atdhetare. Stërmilli, duke e ditur se kjo mënyrë e të menduarit s'ka ardhmëri, guximin e gruas i'a kundërvë atij të burrit. Gruaja pa i'u trembur syri, do të niset në luftë. ...Ky virtyt që u atribuohet grave, duke i madhëruar ato, shndërrohet në një thirrje të përgjithshme: në luftë për liri[15]. Dialogu midis Nailes dhe Tushes dëshmon qartë që ata kishin vendosur të luftonin përkrah të dashurve të tyre luftëtarë edhe sikur ata t'i vrisnin. **"***U shkojmë mbrapa në daçin le të na vrasin!,* -thotë Tushja. *-Shkojmë, shkojmë!* -i'a kthen Nailja. Tushja dhe Nailja vetëm shprehin dëshirën të shkojnë në luftë..., ndërsa Lushja në "Agimi i lumnueshëm"me ta takuar të dashurin e vet, ndonëse është vetë me të në shtëpi, në vend që të bisedojnë për dashuri fillon të bisedojë për çështje të atdheut. Lushja menjëherë e shpreh dëshirën që edhe ajo përkrah tij ta japë ndihmën për atdhe. Suf Bujari, i dashuri i saj e gërget duke i thënë se nuk kishte dëgjuar ndonjëherë se gratë luftojnë dhe pas kësaj shpërthejnë ndjenjat atdhetare të Lushes, prandaj me ton të ngritur i thotë të dashurit: "*Si?! Nuk e dij z. e jote qi shumë herë grat kanë marrë gjakun e burravet të tyne dhe kanë luftue me anmik?!...Edhe ne jemi të bijat e atyne nënave qi kanë ditë me luftue me anmik*! (Agimi i lumnueshëm, Tiranë, 1924).

Lushja, edhe pas kundërshtimit të Sufë Bujarit niset në luftë. Pas vrasjes së tij ajo është e vetmuar dhe një herë më shumë ka arësye të luftojë[16]. Nga dialogu i Dan Bokës dhe Lushes e shohim dhe një herë atdhetarinë e Lushes, -ajo do të marrë gjak për Sufin, shqiptarinë dhe Dibrën[17].

Dan Boka: Po ç'të duhet ty pushka moj Lushe!?.

Lushja: Më duhet për me luftue me anmik, për me marrë gjakun e mikut, gjakun e burrit, gjakun e Shqiptarit, me luftue për Dibrën.

Dan Boka: Udh e mbarë moj shqiptare, udhë e mbarë! (Agimi i lumnueshëm,1924).

"Me dashuri të veçantë, ka dhënë në tragjedinë "Kosovarja", Asimenë, si një luftëtare e paepur dhe plot virtyte, e barabartë në luftë në mes të barabartëve.

DASHURIA, BUKURIA DHE BESNIKËRIA E FEMRËS DIBRANE

Krahas atdhetarisë, Stërmilli na zbulon dhe disa karakteristika të spikatura të femrës dibrane, siç janë guximi, trimëria, fisnikëria, dashuria, bukuria, besnikëria etj. "Nailja dhe Tushja në "Dibranja e mjerueme" janë dy të reja që dashurinë ndaj Zenelit dhe Ali Vorfit e shprehin lirisht pa u ngurruar nga prindërit e tyre. Dashuria e tyre, në vitet e stuhishme të luftës është një dimension njerëzor që egërsinë historike i'a sjell një ngrohtësi. Dashurinë e tyre, e paraqet nëpërmjet letrave në fillim e më vonë në mënyrë të drejtpërdrejtë. ...Tushja është më e ngathët në shprehje të ndjenjave të veta për dallim nga Nailja, letra e së cilës është plot gjakim rinor. ... Dashuria e Nailes me Zenelin paraqitet në fillim dhe në fund të dramës. Autori e bën këtë për të treguar se në vitet e luftës vështirë se mund të realizohet dashuria[18]. Në letrat e para të saj kuptojmë se ajo e do të dashurin e saj Zenelin "*më fort se vetëhen*". Kjo dashuri nuk venitet as pas vdekjes së tij, këtë e zbulon biseda mes Nailes dhe Tushes: "*Ah! due të shkojmë në Dibër Tushe, q'i ta shof makar vorrin e Zejnelit e mbasandej të vdes e kënaqshme aty afër atij vorri due... të vdes, aty due me mbarue!!! S'ka me më kalbë dheu i zi... pa me pame... vorrin e Zejnelit... q'i t'a lemoj me dorë*". (Dibranja e mjerueme).

E zjarrtë, e pastër dhe e fuqishme është edhe dashuria e Lushes me Ali Vorfin në dramën "Dashuri e besnikëri". "Nga dashuria e madhe që Tushja kishte për të dashurin e tij, e përcjell atë nëpër fushëbeteja, por pas vdekjes së tij ajo bën vetvrasje[19]. Në prag të vdekjes, i dashuri i saj Aliu "e ndien tërë përkujdesjen e Tushes". Bashkëbisedimi i tyre në këtë çast ndarjeje të përjetshme është prova më e qartë e dashurisë dhe e besnikërisë bashkëshortore;

Aliu: *Tushe mos më harro!*

Tushja: *Ali! Ali! Mbas teje për mue asht haram jeta*! (Dashuri e besnikëri, Tiranë, 1923).

"...Fjalët e saj të fundit para vetëvrasjes "*por ç'të baj*" janë arsyetim i këtij akti mizor. Përfundimet tragjike i japin dashurisë ngjyresë romantike[20].

E pastër dhe plot ndjenja përshkruhet dhe dashuria e Lushes për Sufë Bujarin: "*Në dasmë të daj Rexhës, kur kjem pam, më pat thanë ca fjalë ke kroji, poshtë, por unë isha habitë e s'dijta t'i përgjigjem. Por me gjith këtë ai deri atëherë nuk më kish kallzue nji dashuri aq të madhe sa qi t'ia besoshe krejtësisht. Po atë natë ato fjalë të shkurta, po aq të thekshme m'a ç'poj krahërorin e m'a përvëloj shpirtin...Hot! Sufa im! shpirti im... vdiq..., u vra po unë?... Si t'a bëj? Pa atë s'mund të roj, jo! Ah! U shofsha unë e zeza qi s'munda me e marrë gjakun e tij*". (Agimi i lumnueshëm).

"Drama "Irena e bukur" trajton një subjekt të marrë nga epoka e Skënderbeut, dhe pikërisht konfliktin në mes Lekë Zaharisë dhe Lekë Dukagjinit, për shkak të princeshës së bukur Irenës. ...Ai vë në dukje sedrën feudale, ...po në të njëjtën kohë na zbulon karakterin e Irenës, botën e saj shpirtërore[21]. Plot pathos është dhënë dhe dashuria midis Dijes dhe kosovarit Shpend Rrëfeja, një djal trim, besnik, me ndjenja fisnike, i rritur në një familje atdhetare.

"Dashuria e tyre zë pjesën më të madhe të veprës. Është një dashuri e sinqertë dhe e fuqishme, shpeshhere plot lektisje, me ngjyra të forta të kohës[22]. Lidhja e tyre kalon nëpër situata e sprova të ndryshme, ajo mplekset me problemet e skllavërisë së gruas[23].

TRAGJIZMI I PERSONAZHEVE FEMËRORË TË STËRMILLIT

Përgjithësisht, Haki Stërmilli e paraqet dashurinë vetëm në mënyrë tragjike. "...Jepet fati i vështirë i dashurisë, ku krahas çasteve lirike, flitet për peripeci e drama të dhimbshme që shoqërojnë të rinjtë në jetën e tyre[24]. "Gruaja në këto drama është personazh tragjik[25]. Tushja e dramës "Dashuri e besnikëri" hap pas hapi e përcjell të dashurin e vet Ali Vorfin nëpër fushëbeteja, por pas vdekjes së tij bën vetvrasje[26]. Po ashtu edhe Lushja dhe Nailja nuk kanë një fat të lumtur, pasi "në vitet e luftës, vështirë se mund të realizohet dashuria[27]. Kushtet në të cilat jetojnë shqiptarët nuk ofronin mundësi as për jetë të rëndomtë. Në këso rrethanash çdo dashuri ishte e gjykuar të përfundojë tragjikisht[28]. Lushja në dramën "Agimi i lumnueshëm" gjatë tërë jetës nuk kishte pasur çaste të lumtura dhe pas vdekjes së të dashurit të saj, Suf Bujarit, e pushtojnë kujtimet. Tash ajo është e vetmuar dhe nuk sheh zgjidhje për fatin e saj, por t'i qëndrojë besnike Sufit deri në vdekje[29]. Dashurinë tragjike të femrës shqiptare, Stërmilli e jep edhe në tragjedinë "Kosovarja" përmes dy të rinjve të dashuruar Asimesë dhe Mujës. Midis peripecive dhe sakrificave të mëdha kalon edhe dashuria e "Irenës së bukur" te drama "Irena e bukur" dhe e Tanies te drama "Tania". Edhe pse kemi të bëjmë me një temë zakonesh, autori rreh të na tregojë se konceptet patriarkale dhe zakonet e këqija të trashëguar nga pushtuesi nuk e kanë penguar popullin shqiptar të manifestojë, kur e ka dashur nevoja, vlerat e larta shpirtërore. Kështu, në raste të caktuara malësori është ngritur mbi konceptet patriarkale për të nderuar gruan dhe ka njohur barazinë në mes burrit e gruas.

(Vijon në numrin e ardhshëm)

1. Mentor Hoxha, Fotografia dhe kamera, pasioni i çmendur i Erenest Koliqit, "55", 29 janar 2014, fq. 22.
2. Historia e Popullit Shqiptar, vëllimi III (Akademia e Shkencave e Shqipërisë), Botimet Toena, Tiranë, 2007 fq. 394.
3. Agim Vinca, "Në Dibër të Poshtme gjeta rrënjët e të parëve të mi", intervistë dhënë Mentor Hoxhës, Rruga e Arbërit, Nr. 98, qershor 2014, fq. 9.
4. Arian Kadiu, Dibra e Madhe (Shehri i Dibrës - monografi), "Dita 2000, Tiranë 2003, fq. 111.
5. Nasho Jorgaqi, "Këngëtar i të drejtave të gruas shqiptare" në parathënia e romanit "Sikur t'isha djalë", të Haki Stërmillit, Sh.B "Naim Frashëri, Tiranë, 1967, fq. VIII.
6. Nasho Jorgaqi, Parathënia, Haki Stërmilli, vepra letrare 1, fq. 17, Sh. Botuese "Naim Frashëri", Tiranë, 1982.
7. Po aty.
8. Resmije Kryeziu, vep. cit. fq. 162.
9. R. Kryeziu, vep. cit. fq. 170.
10. R. Kryeziu, vep. cit. fq. 157.
11. R. Kryeziu, vep. cit. fq. 156.
12. N. Jorgaqi, "Këngëtar i të drejtave të gruas shqiptare..., vep. cit. fq. VIII.
13. R. Kryeziu, vep. cit. fq. 157.
14. R. Kryeziu, po aty.
15. R. Kryeziu, vep. cit. fq. 158.
16. R. Kryeziu, vep. cit. fq. 159.
17. Po aty.
18. R. Kryeziu, vep. cit. fq. 170.
19. R. Kryeziu, vep. cit. fq. 159.
20. R. Kryeziu, vep. cit. fq. 172.
21. N. Jorgaqi, Parathënie në "Haki Stërmilli, Vepra letrare 1, fq. 21.
22. N. Jorgaqi, Parathënia, në Haki Stërmilli, vepra letrare 1, fq. 27.
23. N. Jorgaqi, Parathënia, në Haki Stërmilli, vepra letrare 1, fq. 28.
24. N. Jorgaqi, Parathënia, në Haki Stërmilli, vepra letrare 1, fq. 16.
25. R. Kryeziu, vep. cit. fq. 172.
26. R. Kryeziu, vep. cit. fq. 159.
27. R. Kryeziu, vep. cit. fq. 170.
28. R. Kryeziu, vep. cit. fq. 171.
29. R. Kryeziu, vep. cit. fq. 171.

Rreth vëllimit poetik “Simfonia e ikjes” të poetit, inxhinierit të minierave, Kujtim Biba

Të dëshmosh **të vërtetat** e sojit fisnik të **poetëve**

Nga **MEVLUD BUCI**
Studiues, kulturolog



Kujtim Biba duket se i përket fisit fisnik të poetëve, poetëve autentikë me veten e tyre që dëshmojnë për veten, për brezin e tyre, për kohën dhe bashkëkohësin, pa bërë asnjë kompromis me të vërtetën. Poezia për të nuk është “zanat’, por ujëvarë që i rrjedh nga brenda shpirtit, një ekzistencë e re, pavarësisht nga bota, pavarësisht nga gjithçka që e rrethon.



Fiset e vëllazërimit, të provave atdhetare, të Katundit të Vjetër të Qafë Murrës, fiset Biba, Nika, Manreka, Miha, Shehu, Perhati, Daçi, Duka, Prrejsi janë përvoja e unitetit.

Fisi Biba i Katundit të Vjetër të Qafëmurrës, familja atdhetare e bujare e brezave, Ramadan, Shaban, Hysen, Zenel, Selman, Fiqiri, Dervish, Imer, Hazis, Rustem, Ferit e Ramazan Biba e plot të tjerë, fiset me unitet vëllazëror në kohëra, të Katundit të Vjetër, Katër-Grykët, Qafëmurra, Dibra, koha e kombi tashmë kanë edhe poetin Kujtim Biba.

Kujtim Biba nga Qafë Murra e Dibrës ka shkruar vetëm një libër, një libër me poezi dhe thotë diku në dy fjalët që shoqërojnë hyrjen si parathënie se ndoshta ky do të jetë libri i parë dhe i fundit. Kjo jo për faktin se nuk ka se çfarë të shkruaj, pasi me poezitë e këtij libri ai dëshmoi se ka shumë për të thënë dhe, për hir të së vërtetës, i thotë në një mënyrë tepër origjinale e të pandikuar nga askush, përveçse nga vetvetja e tij. Arsyeja e këtij refuzimi duhet kërkuar ndoshta në atë që vetëdija e tij prej poeti nuk e pranon të rëndomtën, nuk e pranon ushtrimin e dhuntisë letrare e poetike në veçanti si një “profesion”, siç bëjnë dhjetëra e qindra të vetëshpallur poetë të kohës sonë, që nuk bëjnë gjë tjetër veçse “rrahin ujë në havan”.

Kujtim Biba duket se i përket fisit fisnik të poetëve, poetëve autentikë me veten e tyre që dëshmojnë për veten, për brezin e tyre, për kohën dhe bashkëkohësin, pa bërë asnjë kompromis me të vërtetën. Poezia për të nuk është “zanat’, por ujëvarë që i rrjedh nga brenda shpirtit, një ekzistencë e re, pavarësisht nga bota, pavarësisht nga gjithçka që e rrethon.

Akti poetik i Bibës në këtë libër është i plotë dhe i mjaftueshëm për të dëshmuar se ai është poet, është nga soj fisnik i poetëve dhe ka dalë në rrugën e poezisë si një misionar dashurie, për të na përcjellë një copë horizont të ëndrrës së tij.

Jeta e tij prej bohemi, siç thotë dhe vetë diku, e ka shtyrë në një rrugëtim të vështirë drejt jetës dhe poezisë, duke pranuar se i përjet një brezi që rreket të firmos dy humbje të mëdha, ndoshta me dy sisteme krejt të kundërt me njëri-tjetrin. Të parin e quan mohim në emër të jetës, të dytin dështim dhe ky dështim, kjo dhimbje, ky vakum, ky horizont gri ku përplaset ëndrra dhe realiteti është “lënda e parë”, lënda kryesore e poezisë së tij.

“Vjeshta në shpirt” përthithet e shuhet në “gjuhën memece”, “kujtesa e fëmijës” eklipsohet nga “zërat e jetës”, “hëna vajtimtare” ndjek pas “fluturën në livadh”, që nuk është gjë tjetër veçse hija e një dashurie të ikur etë kthyer në një mungesë të gjatë etë trishtë. Motivet e poezive të Bibës janë jetësore, mbresa dhe përjetime vetjake, koha e premtimit dhe zhgënjimit që kacafyten e japin e marrin me njëra-tjetrën në një duel të pakohë.

Poeti i këndon Peshkopisë, “qyteti i duarve të zbrazura dhe syve të zhgënjyer”, i këndon trishtimit të ndarjes, mallit të mikut të mirë, ditëve që ikin duke lënë pas konture dhimbjeje e mungese, “detit plot mister e bukuri”, ngazëllimit të ditës së re që zbardh mbi lëndinë etj.

“Kur mora në dorë poezitë e tij (të Kujtim Bibës), -shkruan në pasthënien e tij redaktori, shkrimtari I mirënjohur Ramiz Gjini, ajo që më bëri përshtypje, ishte piëkrisht ai tharm i domosdoshëm, pa të cilin nuk mund të ngjizet arti i poezisë, ndërsa, kur është fjala për disa rregulla të njohura nga pikëmpamja e strukturës së vargut, Kujtimi qe kokëshkretë në reagime…”

I vendosur në shtratin e tradicionalizmit poetik, në atë guvë burimore ku është folku, zërat e ngrohtë lirikë që vijnë nga etnopsikika poetike kolektive, Biba nuk mbetet rob i kësaj tradite, por me origjinalitetin e zërit të tij, me tonet aq të ndjeshme e kumbuese, me lirizimin dhe spontanitetin e tij, e pasuron këtë traditë me imazhe dhe struktura të reja poetike.

Ajo që në të vërtetë përbën individualitetin e poetit është freskia e motiveve, marrja e “lëndës së parë” poetike nga jeta e gjallë njerëzore, nga raportet e unit të tij me kohën dhe bashkëkohësin dhe jo nga skemat libreske, ndikimet dhe spostimet akrobatike, siç bëjnë mjaft poetë, që nuk shkruajnë veteveten, nuk janë vetvetja, por ndihen të kompleksuar nën hijen e të tjerëve.

Poezia e autorit Kujtim Biba nuk vjen nga shtampat deklerative, nga agjustimet dhe ilustrimet rozë të realitetit, por nga një njohje e thellë e objektit poetik, nga fuqia e ndjenjës dhe intensiteti i emocionit, që vë në lëvizje turbinën e mendimit për të prodhuar energjinë poetike, që na vjen me anë të vargjeve të ndjerë e të ngrohtë, plot ritme e temporitme të brendshme.

“Shqetësimi përplaset në shpirtin tim
Si grerëza etërbuar nmë xhamin e dritares.

Më grric dhe më mundon
Me orë dhe ditë të tëra

Më thoni, ju lutem:
A është zemra si dritarja që hapet
Apo si xhami që thyhet

(Poezia “Shqetësim” fq.48)

Poeti e tejshtrin botëvështrimin e tij në hullinj të njohur përjetimesh, por mënyra se si ai vështron në këta hullinj është befasuese; duke sjellë ritme dhe melodi të hazdisura e trillere, që të rrëmbejnë e të bëjnë për vete.

Ky shpalim i poetit, sjell me vete një aromë të veçantë poetike, risinë e riciklimit të bukurisë, si një kumt ndjellës drejt harmonisë dhe përsosmërisë, në kufijt mes realitetit të rëndomtë që ushtron presion dhe ëndrrës së kulluar, si produkt i mirëfilltë poetik. Në këtë vijë poeti mbjellë farë buzëqeshjesh, dhimbjesh, malli, ëndërrimi, flirti, magjijimet e ditës dhe mëkatët e natës, një minbotë të pasur e të pastër, që është një ftesë për ta vizituar në çdo kohë…

Në qendër të këtij fokusimi është fjala njeri, raportet e tij me të ngjashmin, me kohën, me bashkëkohësin, me anën hyjnore të botës, me filozofinë e mbijetesës dhe të ecurisë së brezave.

Vargu i thjeshtë por elegant i Bibës nuk kërcet, nuk kërkon të duket, por është i vetëmjaftueshëm për atë çfarë kumton dhe si e kumton, me një natyrshmëri dhe sponanitet për t’u admiruar.

Kujtim Biba na përcjell në këtë libër një përjetim vetjak të shumëzuar me shumë ëndrra, përjetime, ndjesi, emocione, mesazhe, të cilave iu përgjigjen struktura poetike të zhdërvjellëta dhe të shprehura me mjete stilistike të shumta.

Libra të tillë me poezi, si ky i poetit Kujtim Biba tregojnë për mundësitë e mëdha shprehëse dhe imazhinuese të poezisë së re shqipe, e cila tashmë e çliruar nga dogmatizmi, në një tendencë të bukur për të kapur kohën e ikur, po sjell në rrugën e saj poetë të vërtetë, të rinj e të vjetër, të prirjeve e tendencave të ndryshme, që janë vetveteja dhe të gjithë së bashku i japin pulsin e duhur artit tonë poetik…


Në qendër të këtij fokusimi është fjala njeri, raportet e tij me të ngjashmin, me kohën, me bashkëkohësin, me anën hyjnore të botës, me filozofinë e mbijetesës dhe të ecurisë së brezave.

Vargu i thjeshtë por elegant i Bibës nuk kërcet, nuk kërkon të duket, por është i vetëmjaftueshëm për atë çfarë kumton dhe si e kumton, me një natyrshmëri dhe sponanitet për t’u admiruar.

Kujtim Biba na përcjell në këtë libër një përjetim vetjak të shumëzuar me shumë ëndrra, përjetime, ndjesi, emocione, mesazhe, të cilave iu përgjigjen struktura poetike të zhdërvjellëta dhe të shprehura me mjete stilistike të shumta.

Libra të tillë me poezi, si ky i poetit Kujtim Biba tregojnë për mundësitë e mëdha shprehëse dhe imazhinuese të poezisë së re shqipe, e cila tashmë e çliruar nga dogmatizmi, në një tendencë të bukur për të kapur kohën e ikur, po sjell në rrugën e saj poetë të vërtetë, të rinj e të vjetër, të prirjeve e tendencave të ndryshme, që janë vetveteja dhe të gjithë së bashku i japin pulsin e duhur artit tonë poetik…

Botim i ri



FEHMI KALOSHI
KALOSHËT E DIBRËS

Botimet M&B
ISBN: 987-9928-172-31-0
Nr. faqeve: 224
Çmimi: 1000 lekë

Kur lexon monografinë “Kaloshët e Dibrës” të autorit Fehmi Kaloshi, mësojmë se Kaloshët e Dibrës janë një fis shumë i shquar e luftarak, të një gjaku me Kastriotët dhe Skënderbeun, fis i cili shquhet për shumëçka, por tri janë dallesat kryesore të tij: trimëria, besa dhe bujaria.

Monografia “Kaloshët e Dibrës” është e vështrimit historik, me çka duhet të kuptojmë se autori ka rrokur më së pari ngjarjet historike, duke ndjekur rendin kronologjik që prej gjenezës deri në ditët tona. Autori i saj, Fehmi Kaloshi, ka një meritë të madhe dhe të padiskutueshme, se jetën e këtij fisi të madh, të cilit edhe i përket, nuk e ka parë të shkëputur nga jeta e popullit të trevës ku ka jetuar dhe jeton edhe sot.

Kaloshët bëjnë pjesë në Malin e Çidhnës, që është një prej maleve më të dalluar në Nëntë Malet e Dibrës. Çidhna ka qenë përherë në ballë të luftërave dhe kryengritjeve të popullit të Dibrës. Nuk ka luftë dhe kryengritje në Dibër që nuk e ka pas bazën e saj të nisjes në Çidhën.

Fehmi Kaloshit jep një ndihmesë të madhe për t’u kuptuar dhe interpretuar drejt disa ngjarjeve të historisë dhe disa figura kombëtare.

Diktatura enveriste iu kundërvu egërsisht familjes së madhe të Kaloshëve, duke burgosur, vranë me gjyq e pa gjyq dhe internuar të gjithë për motive politike, pa asnjë përjashtim. Kush i shpëtoi plumbit dhe burgut, u internua shumë vite me radhë, deri në ditët kur filluan proceset demokratike në vendin tonë, në mars 1991.

Autori ka marrë nëpër duar dhe ka analizuar një dokumentacion të gjerë. Ai ka shfrytëzuar me mjeshtëri kujtimet e bashkëkohësve dhe të bashkëluftëtarëve të Kaloshëve, duke i parë ata, në lidhje të ngushtë me popullin e zonës dhe të tërë trevës së Dibrës, në lidhje me shtëpitë e para të kësaj treve dhe të trevave të tjera. Materiali mbi të cilën është ngritur kjo monografi është i plotë, vjen prej burimeve të ndryshme, të besueshme dhe shpeshherë prej atyre që kanë qenë vetë protagonistë të ngjarjeve. Kjo e bën monografinë më të afërt me lexuesit, më të ngrohtë e më intim.

Fehmi Kaloshi, edhe pse ka qenë vetë i persekutuar politik, edhe pse ka pas anëtarë të familjes të burgosur dhe të ekzekutuar për motive politike antikomuniste, nuk tregohet hakmarrës. Ai vetëm kërkon drejtësi dhe drejtësia fillon që nga shkrimi i historisë në mënyrë shkencore.

(Marrë me shkurtime nga parathënia e librit, shkruar nga Vasil Tabaku)

recensë

...Kudo që të shkoni, në çdo cep të Shqipërisë, fushë, mal apo bregdet, ju do të gjeni kënaqësinë dhe relaksin e munguar, sepse ajo tashmë konsiderohet "sekreti i fundit turistik i Europës" e krejt Globit...

Një **libër** me shumë **vlerë** për turizmin shqiptar

Nga **XHAFER MARTINI**

Kur më bie në dorë ndonjë libër i mirë, kam dëshirë t'ua bëj atë të njohur lexuesve dhe të interesuarve, për vet faktin se sot është shumë e vështirë që, në morinë e botimeve, të zbulohen dhe të vlerësohen më të merituarit. Sot promovohen me pompozitet dhe ngrihen në qiell për gjoja vlerat e tyre libra që as nuk e meritojnë ta marrin atë emër. Sot u kushtohen emisione televizive dhe u hapen faqet e shtypit të përditshëm paçavureve pa asnjë vlerë vetëm e vetëm se gjoja janë shkruar nga "personalitete" të njohura ose nga njerëz që kanë para dhe e shtrijnë sundimin e saj edhe në një fushë kaq delikate siç janë botimet.


Kur më ra në dorë libri "Turizmi shqiptar" me autor gazetarin e njohur Xhelal Marku, e lashë atë për një farë kohë në bibliotekën time pa e prekur. Por, kur në një ditë që e quajta të përshtatshme, fillova ta lexoj, mbeta i befasuar nga përmbajtja shumë e pasur, stili i të shkruarit, objektivi i fiksuar i autorit për t'i shërbyer sado pak vendit të tij dhe, më në fund, qëllimi i përmbushur dhe detyra e kryer me nder.

Mund ta filloj në dhjetëra mënyra shkrimin tim për këtë libër, por më duket se nuk mund të fillohet më mirë se sa thirrja plot pasion të përmbajtur me anën e të cilës autori u drejtohet turistëve të vendit të vet dhe të gjitha vendeve të Globit, thirrje të cilën unë e quaj një prozë poetike, plot dashuri dhe krenari për Shqipërinë dhe bukuritë e saj: "Shqipëria turistike, vendi i mikpritjes, i qetësisë dhe i bukurive të rralla natyrore, i burimeve të shumta kurative, i klimës së preferuar dhe i ditëve të shumta me diell, i trashëgimisë së pasur historike e kulturore, i resurseve të pafundme turistike, pret krahëhapur dhe me bujarinë e saj karakteristike, vizitorë nga e gjithë Bota. Mirë se vini në Shqipëri, ku do të befasoheni me mrekullitë, që i ka falur asaj natyra, por edhe të ndërtuara me aq pasion e dashuri nga vetë duart e shqiptarëve. Ndaj, kudo që të shkoni, në çdo cep të Shqipërisë, fushë, mal, apo bregdet, ju do të gjeni kënaqësinë dhe relaksin e munguar, sepse ajo tashmë konsiderohet "sekreti i fundit turistik i Europës", por edhe një konkurrente e denjë dhe dinjitoze e tregut turistik të rajonit e të krejt Globit. Mirë se vini në Shqipërinë turistike, tashmë me imazhin e ri të saj, e cila vazhdon të qëndrojë në listën e dhjetë vendeve më të preferuara të Botës, që rekomandohet nga mediat më prestigjoze, si destinacioni i parë turistik për t'u vizituar nga pushuesit e huaj!"

Kjo është ftesa dhe thirrja e dashurisë për atdheun, nëpërmjet të cilës autori i saj, jo vetëm për shkak të patriotizmit, por edhe për shkak të dijeve të thella dhe të gjithanshme, bëhet zëri i Shqipërisë. Ne që jetojmë në Shqipëri dhe e duam atë si nënën tonë, e dimë që Zoti i ka falur shumë të mira dhe shumë begati, por dimë gjithashtu që populli i kësaj mrekullie, me përjashtim të dy për qind të tij, jeton në mjerim dhe varfëri; ne dimë, gjithashtu, që dora e njeriut dhe kujdesi i tij nuk i përshtaten kësaj Zonje të Madhe dhe të nderuar, se janë vetë shqiptarët, pikërisht soji i saj më i ulët që nuk duan askënd veç vetes së vetë, që ia shfrytëzuan bukuritë dhe begatitë për t'u pasuruar vetë. Por Xhelal Marku është edhe poet, madje poet rilindas, që nuk ia bën goja dhe nuk i thatë dora të bëjë pohime të tilla, sidomos pse u drejtohet të huajve, dhe se ai, nga dashuria që ka për Shqipërinë, ngre edhe njeriun shqiptar në nivelet e duhura dhe e vendos atë na raporte dashurie dhe mirënjohjeje që duhet të ketë çdo njeri me atdheun e vet. Ai e di se pyjet janë shkatërruar, se një pjesë e madhe e perlave shqiptare janë dëmtuar, se hekuri dhe betoni janë futur në det, se pishat e mrekullueshme janë prerë për të "mbjellë" vila të pasurit, se detet, lumenjtë e liqenet janë të ndotur, se plehrat po na marrin frymën, por atij nuk i bën zemra t'i thotë këto. Ai e do atdheun e dhe kështu siç është, kështu siç e kanë katandisur ata që e kanë në dorë ta ndërtojnë dhe ta lulëzojnë. Mua thirrja e tij më kujton vjershën e bukur të Çajupit:

"E dashur mëmëdhe,
të dua edhe kështu si je,
por kur të të shoh të lirë,
do të dua më mirë!"

Ky libër nuk është një guidë turistike, por një vepër shkencore, një enciklopedi e vërtetë ku



Shqipëria turistike, vendi i mikpritjes, i qetësisë dhe i bukurive të rralla natyrore, i burimeve të shumta kurative, i klimës së preferuar dhe i ditëve të shumta me diell, i trashëgimisë së pasur historike e kulturore, i resurseve të pafundme turistike, pret krahëhapur dhe me bujarinë e saj karakteristike, vizitorë nga e gjithë Bota. Mirë se vini në Shqipëri, ku do të befasoheni me mrekullitë, që i ka falur asaj natyra...

ka edhe histori, edhe kulturë, edhe gjeografi, edhe art, letërsi, gjuhësi, besime fetare, pasuri folkloristike e kulinare, faunë dhe florë, arkitekturë, civilizim dhe qytetërim të lashtë e të ri, pika turistike, male, relieve, vijë bregdetare dhe plazhe, muze dhe arkeologji, liqene dhe lumenj, gjire dhe ishuj, produkte artizanale, pazare dhe ekspozita, rrugë dhe parqe natyrore etj. etj. Është libri më i plotë për Turizmin Shqiptar shkruar me dashuri dhe profesionalizëm. Libri ndahet në tri pjesë që autori i ka quajtur kapituj kryesorë: Pjesa e parë ka të dhëna historike për turizmin shqiptar në shekuj. Këtu trajtohen probleme të tilla, si: Turizmi shqiptar në shekuj, Potencialet turistike të Shqipërisë, Pozita gjeografike dhe resurset turistike të Shqipërisë. Njohuritë shkencore mbi popullsinë, klimën, kulturën, monedhën, ngjarjet më të rëndësishme nëpër të cilat ka kaluar Shqipëria, Flamuri, Emblema, Sistemi Politik, Kushtetuta, Mikpritja shqiptare në shekuj, figurat më të shquara historike dhe të artit e të kulturës, Kuzhina tradicionale, Pasuria folklorike, Arti, Letërsia, Besimet fetare dhe harmonia midis tyre, cilësitë dhe veçoritë dalluese të shqiptarëve, kalatë, arkitektura, Parqet kombëtare, Ujërat e Shqipërisë duke përfshirë këtu dhe ato kurative, sportet sfiduese, rrugët dhe monumentet e kulturës etj:, etj., jepen me masë, pa shkaktuar mbingarkesë dhe mërzitje tek lexuesi. Meqë libri ka karakter njohës dhe promovues të vlerave kulturore, në këtë pjesë përshkruhen me një thjeshtësi mbresëlënëse, por edhe me saktësi dhe bukuri stili, pasuritë e trashëgimisë sonë kulturore, si: Kalaja e Ali Pashë Tepelenës, Kalaja e Bashtovës, e Beratit, e Borshit, Drishtit, Elbasanit, Gjirokatrës, Kaninës, Krujës, Lezhës, Lëkurësit, Margëlliçit, Elbasanit, Petrelës , Rozafës etj. bashkë me pamjete tyre mahnitëse, të fotografive me ngjyra të cilësisë së parë. Stili i të shkruarit është shumë i përshtatshëm për një vepër të tillë. Libri përshkohet nga dashuria për atdheun dhe krenaria kombëtare, por fraza nuk është pëlcitëse dhe patetite. Xhelali, duke qenë njeri që ka jetuar shumë mesa natyrës, siç duket ka marrë prej saj ekuilibrin dhe harmoninë, aq shumë të nevojshëm në jetë, sidomos kur shkruan një libër si ky që ruajtja e masës është domosdoshmëri. Në vazhdim, krahas ndërtimeve të hershme, jepen edhe parqet kombëtare si ai i Dajtit, Thethit, Lurës, Divajkës, Llogarasë, Drenovës, i Luginës së Valbonës, i Qafë Shtamës, Velipojës , duke vazhduar pastaj me plazhet kryesorë të Shqipërisë: Velipojës, Shëngjint, Gjirit të Lalëzit, Durrësit, Golemit, Divjakës, Plazhet e Gjirit të Vlorës, Rivierës etj. Pastaj vinë ujërat termale, vendet turistike ku mund të kalohen pushimet dimërore, sportet me të cilat mund të merresh si skitë, alpinizmi, treningu (ngjitjet në vende të ndryshme), speleologjia(eksplorimi i shpellave), çiklizmi malor, aeronautika, peshkimi, raftingu (sportet ujore), hipizmi. Për të gjitha këto sporte autori jep shumë të dhëna interesante, por me masë dhe me cilësi shkrimi, që lexuesi mëson pa u mërzitur për të gjitha këto mrekulli të vendit të tij që rrallëkush i di sado i shëtitur dhe me kulturë të jetë. Çdo zë shoqërohet me fotografi artistike të cilësisë shumë të lartë.

Në këtë kapitull nuk mungon edhe një nënkapitull i tillë: "Informacion për shtetasit e huaj që duan të vizitojnë Shqipërinë", ku jepen me hollësi rrugët ajrore, rrugët detare me portet përkatëse, pikat e ndryshme të kalimit të kufirit, distanca në kilometra në rrugë tokësore të çdo qyteti të Shqipërisë nga kryeqytetit-Tirana. Vend të gjerë zënë produktet artizanale në Shqipëri dhe tregu i tyre.

Në Pjesën e Dytë të këtij libri autori e ka me opinione dhe mbresa të turistëve të huaj për Shqipërinë, plus artikuj, vlerësime dhe publikime të mbledhura nga shtypi i huaj dhe vendas. Autori ka bërë një punë të shkëlqyer shkencore duke mbledhur të gjitha të dhënat, intervistat, artikujt, librat që kanë botuar të huajt që nga fillim i shekullit XVII e deri më sot, duke i paraqitur ato në mënyrë tërheqëse për lexuesin shqiptar, cili ka pak ose aspak njohuri për një fushë të tillë, që lidhet jo thjesht me krenarinë kombëtare, por edhe me të ardhmen e tij ekonomike të Shqipërisë. Vendi ynë, me resurset që ka, begatohet vetëm me turizmin sikur atë ta ngrejë në rangun e turizmit botëror. Shqipëria turistike ka tërhequr vëmendjen të huajve, të cilën, një pjesë e tyre, e kanë vështruar vetëm si vend ekzotik, me syrin e eksploratorit dhe të aventurierit kokëkrisur, siç ka edhe plot të tjerë që tregojnë edhe rrugët dhe mundësitë që ka ky vend për të hyrë në turizmin modern, duke plotësuar ato kërkesa dhe duke përqafuar ato vlera që të integrojnë me Europën dhe vendet e tjera edhe në këtë fushë kaq të rëndësishme të jetës. Alpet e Shqipërisë janë bërë objekt jo vetëm adhurimi dhe poezie, por edhe studimi të një karakteri të thelluar, si burime shumë të mëdha për turizmin malor të këtij vendi të vogël. Në revistën prestigjoze "Buletin i Shoqërisë Gjeografike italiane", më 1931, botohen dy shkrime shumë të vëllimshme, prej rreth 60 faqesh, që pothuaj zënë krejt revistën. Titujt e këtyre shkrimeve janë: "Vëzhgime të bëra gjatë një udhëtimi në Malësinë e Madhe", shkruar nga Batista Florida dhe "Gjurmë të periudhës së akujve në Malësinë e Pindit të Epirit", shkruar nga Aldo Setini. Turistë të tjerë që kanë vizituar vendin tonë në të kaluarën, nuk kanë qenë thjeshtë njerëz që kanë ardhur për të vizituar një vend dhe për të kaluar disa ditë larg rrëmujës dhe rrëmetit, por kanë qenë studiues që kanë lënë shkrime me vlerë të madhe edhe për të sotmen; shumë prej shkrimeve të tyre ruajnë vlera të qëndrueshme, sepse japin ide dhe tregojnë rrugë të sakta për zhvillimin e turizmit shqiptar. Ja si shprehet njëri prej tyre: "Brigjet shqiptare, në pamjen e parë, nuk paraqesin ndonjë gjë tërheqëse, me përjashtim të bukurisë së egër të brigjeve të Jugut prej Vlorës dhe tutje. Por kjo pjesë e Shqipërisë që në pamjen e parë nuk duket interesante, fsheh brenda vetes pasuri të mëdha turistike, e ndoshta edhe ndonjë madem floriri, të cilin duhet ta vëmë në lëvizje për shfrytëzim. Aty kemi edhe plazhet të cilët më të bukur dhe më të mirë nuk i gjen të kërkosh tërë Detin Mesdhe, ndoshta tërë Europën" . Të huajt që kanë vizituar Shqipërinë në ato kohëra kanë bërë studimin e tokës dhe të maleve, të fushave dhe të brigjeve, të deteve dhe lumenjve, duke e vlerësuar bregdetin shqiptar si më të bukurin dhe më të përshtatshmin për plazhe, me brigjet e cekëta dhe të rrafshëta, me rërën e mrekullueshme , me një reliev që, ndihmuar nga dora e njeriut, bëhet konkurrues në botë. Vlera të mëdha që të huajve nuk u kanë shpëtuar, janë edhe "gërmadhat e kohës së vjetër e të mesme", të ruajtura në kulla dhe kala qytetesh, si: Butrinti, Pojani dhe shumë monumente të tjerë, veçanërisht ndërtimet artistike, siç janë në radhë të parë xhamitë, kishat dhe objektet e tjera të kultit, që mund të kthehen në faktorë të fuqishëm të turizmit shqiptar. Megjithëse mbretin Zog e kemi quajtur të prapambetur dhe anadollak, ai ishte i tillë që e vlerësonte shumë hapjen e Shqipërisë ndaj të huajve dhe bënte çmos që të huajt, sidomos ata të vendeve të zhvilluara, të njiheshin me Shqipërinë dhe ta propagandonin bukurinë dhe virgjërinë e natyrës shqiptare. Këtij qëllimi i shërbeu edhe vizita e 500 turistëve francezë në qytetin e Durrësit dhe Tiranës, në vitet tridhjetë, të cilëve u janë vjelur mendimet dhe vërejtjet jo vetëm për t'i pasqyruar në shtypin e kohës, por edhe për t'i pasur si program pune për zhvillimin e turizmit shqiptar. Turistët francezë u veshën me kostumet tona kombëtare, që i pëlqenin aq shumë dhe ashtu, të veshur si shqiptar, qëndruan gjithë atë ditë që vizituan Shqipërinë. Mesazhi i tyre ishte i thjeshtë dhe i qartë: "T'i ruani dhe t'i donin veshjet kombëtare, sepse ato janë një pasuri e madhe e këtij vendi, sepse ato ju lidhin jo vetëm me të kaluarën, por edhe janë dëshmitarë të historisë dhe të kulturës suaj, të identitetit dhe të krenarisë kombëtare. Veshjet tuaja janë të bukura dhe të shëndetshme, të bëra nga një popull jo vetëm me gusto dhe me shije, por edhe me një ndjenjë të hollë të përshtatjes dhe të harmonizimit me natyrën dhe klimën e vendit". Tani këto veshje nuk ekzistojnë më, një pjesë e tyre mund të kenë kaluar në duart e ndonjë tregtari surrogat, që, përveç fitimit, nuk njeh asnjë vlerë tjetër. Ne, shqiptarët veshjen e kemi të bukur dhe krenare, por vetë nuk jemi krenarë për origjinën dhe të kaluarën tonë. Kam parë, fjala vjen në Austri, veshje popullore, kostume popullore në të gjitha dyqanet ku shiten rroba. Austriakët, vasha dhe djem, pleq dhe plaka, të rinj dhe me moshë mesatare, për festa, për dasma dhe për gëzime të tjera familjare, vishen me rroba kombëtare dhe ndihen shumë krenarë për veshjen që kanë. Kostumet tona kombëtare, qoftë për gra, qoftë për burra, janë të ndritshëm, plot ngjyra, plot dritë dhe vezullime, që nxjerrin në pah bukurinë e njeriut dhe i sigurojnë atij lëvizje të lira dhe harmonike.

"Shqipëria ka një të ardhme të madhe turistike", shkruan një sportist gjerman, Karl Karolh, që ka botuar një libër për vendin tonë me titull "Në thellësitë e Shqipërisë" (Durch Albaniens Scluchten), që ndodhet në Bibliotekën Kombëtare, por që askush nuk e merr ta përkthejë. Libri është me përshtypjet e vetë autorit gjatë një udhëtimi aventuroz me kaone përgjatë Luginës së Drinit të Zi, nga burimi deri kur derdhet në Detin Adriatik. Autori përshkruan Shqipërinë e viteve dyzet, duke përfshirë në libër edhe përshtypjet e një gruaje dhe të një burri që bënin pjesë në ekipin e tij. Karl Karolh është kampion i Gjermanisë në këtë lloj sporti. Libri është i shoqëruar me 54 foto të realizuara nga vetë sportistët, gjatë udhëtimit nëpër gjithë Shqipërinë, që nga Ulqini e deri në Shkup.

Një shkrim shumë interesant është ai me titull: "Shqipëria, si ishte dhe vizioni i së ardhmes", shkruar nga Jeremy Seal. Marisa Fumagalli në shkrimin "Shqipëria, tokë me bukuri të rrallë", jep me saktësi dhe stil elegant bukuritë e natyrës shqiptare, që i ka të rralla shoqet në botë. Ky publikim bëhet në gazetën italiane "Corriere della Sera", në seksionin online, ku flitet për Shqipërinë dhe mrekullitë natyrore që ofron ky vend për turistët e huaj. Publicistja Marisa Fumagalli thotë që në Shqipëri mund të kalojë pushimet ai turist që ka shpirtin e udhëtarit, që është kurioz, i gatshëm për gjëra të reja dhe që nuk kërkon perfeksionin. Shkoni dhe zbuloni tokën që fsheh bukuri të rralla, shkruan ajo, shikoni një det transparent, plazhe të pandotura, pyje, lumenj, male dhe vende të shumta arkeologjike.

(Vijon në numrin e ardhshëm)

Çidhna dhe Dibra, në breza do krenohen me historinë e tyre të shkruar me gjak e sakrifica.

570 vjetori i Betejës së Torviollit



Fitorja e Skënderbeut në betejën e Torviollit ishte një fitore historike dhe guri i brilantit në gjerdanin e fitoreve të tij për 25 vjet rresht kundër hordhive osmane...

(Vijon nga numri i kaluar)

Nuk ka të dhëna për ndonjë marrëveshje paraprake me Venedikun për furnizimin e ushtrisë së Lidhjes me materiale dhe armatime. Por vërtetohet me dokumente se kishte marrëdhënie tregtare midis Republikës së Venedikut dhe disa krerëve të Lidhjes (Skënderbeu, Balshajt, Spani etj). Këto furnizime ishin kryesisht me armë, ushqime dhe veshmbathje nëpërmjet detit në skelat e Durrësit, Lezhës, Shkodrës dhe Ulqinit.

Kalatë më të rëndësishme ishin: Kalaja e Krujës, Shkodrës, Lezhës, Danjës, Stelushit, Sfetigradit, Petralbës dhe Kalaja e Çidhnes (Qafë Kalaja midis Çidhnës dhe Lurës). Përveç kalave, strehimet e popullsisë përdoreshin dhe "kalatë natyrore" si Çidhna e Poshtme dhe Sina, Lura, Grama etj.

FORCAT E ALI PASHËS

Forcat që komandonte Ali Pasha, i përkisnin forcave kryesore osmane të përqendruara në Shkup. Nuk ka të dhëna për pjesëmarrje të ushtrive të tjera vasale të sulltanit, por nga të dhëna anësore mund të ketë patur pjesëmarrës të vasalëve nga bullgarët.

Në kohën e Sulltan Muratit të II-të, organizimi ushtarak ishte mbi bazë pashallëku, me një pasha kryekomandant. Pastaj vinin komandantët me titull "bej", "aga" etj.

Në Betejën e Torviollit morën pjesë më shumë kalorës (spahinj) dhe më pak këmbësorë (azap) të cilët merreshin më shumë me përgatitjen e terrenit të luftimeve, furnizimit me materiale dhe ushqime dhe ngritjen e çadrave.

Ky argument vlen pasi distanca e largët e udhëtimit nga Shkupi në Torvioll ishte më shumë se 200 km. Këta mund të ishin dhe ushtarë të rekrutuar nga zonat e veprimeve luftarake ose nga ushtria e rregullt. Ushtria osmane, gjatë luftimeve ka përdorur shpesh dhe grupe zbulimi dhe terrori paraprak ndaj popullsisë duke vrarë, grabitur dhe djegur pronat dhe shtëpitë e banorëve "të pabindur".

Nuk ka të dhëna se në luftimet e Betejës së Torviollit janë përdorur "jeniçerët", të cilët angazhoheshin më të shumtët e rasteve kur luftimet i komandonte sulltani.

Por duke parë rëndësinë që kishte për sulltanin kjo betejë për nënshtrimin e Skënderbeut dhe Lidhjes, mund të ketë patur dhe forca jeniçerësh.

Nga përshkrimet letrare dhe historike të betejës nga autorë të ndryshëm, mund të konfirmohet se ushtria osmane nuk ka përdorur artileri (ushtria osmane dispononte në këtë kohë artileri të lehtë dhe të rëndë me topa të derdhur në hekur dhe bronx, gurëhedhëse etj). Por me qenë se kjo betejë nuk bëhej për marrjen e ndonjë kështjelle, ushtria pjesmarrëse në betejë nuk ishte e kompletuar.

Ushtria osmane, sipas përshkrimeve, mund t'i ketë ngritur çadrat në Fushën e Thatë të Kastriotit me një avancim deri në Kodrat e Ostushit.

Po të kemi parasysh numrin e ushtarëve pjesëmarrës, vija e frontit mund të ketë qenë 1 km në gjerësi dhe thellësi.

Rrjeshtimi luftarak i ushtrisë osmane ishte:

Skalioni i parë, harkëtarë, shtizarë

Skalioni i dytë, kalorës dhe këmbësorë (shpatarë)

Rrjeshtimi i ushtrise së Lidhjes ishte:

Forcat kryesore që komandonte Skënderbeu (rreth 3000 luftëtarë) në skalionin e parë kishin kalorës dhe harkëtarë, pastaj këmbësorë (shpatarë). Kjo forcë qëndronte përballë ushtrisë osmane në mes të Fushës së Torviollit.

Forcat e Lidhjes ishin grupuar në katër grupe të tjera të gatshme (kalorës dhe këmbësorë) të fshehura në pyjet e dendura të dushkut rreth fushës së Torviollit në lindje, veri dhe veri lindje (ku sot mund të jenë Kodrat e Çeliasit, Rrafshet e Shumbatit, kodrat rreth fushës dhe Salbatër), në pritje për t'i sulmuar në befasi nga krahu lindor dhe pas shpine. Taktikë që Skënderbeu e ka përdorur me sukses gati në të gjithë betejat e hapura dhe në mbrojtje të kështjellave.Këto forca komandoheshin nga Moisi Golemi, Hamza Kastrioti, Tanush Topia, Pal Dukagjini dhe Gjergj Balsha, Pjetër Spani etj.

DINAMIKA E BETEJËS

Përshkrimi i dinamikës së kësaj betejë, si nga autorë shqiptarë dhe të huaj, por edhe osmane, ka nota glorifikimi, por vlerësohet si një nga betejat më të ashpra që ka zhvilluar Skënderbeu në përballje frontale. Shpejtësia, befasia, trimëria dhe zhdërvjelltësia në përdorimin rracional të forcave ishte karakteristikë e luftimeve të Skënderbeut. Natën duke u gdhirë e nesërmja e luftimeve, në kampin e Ali Pashës u ndezën zjarre të mëdha dhe ushtria e tij po bënte presion duke filluar festimet para kohe.

Skënderbeu dha urdhër të fiken të gjitha zjarret dhe mbretëronte një qetësi për t'i treguar ushtrisë osmane se po i trembej forcës së saj. Në pyjet përreth fushës së luftimeve ushtria e Lidhjes e ndarë në grupe prej 2000 deri në 3000 luftëtarë priste lajm nga Skënderbeu për mësymje anësore dhe pas shpinë.

Goditja e fortë në qendër të rreshtimit të ushtrisë osmane dhe çoroditja me sulme anësore dhe pas shpinë, e copëzoi sulmin frontal osman dhe krijoi mundësinë e eliminimit të saj. Kalorësia prej 3000 luftëtarësh në qendër të komanduara nga Skënderbeu filloi sulmin mbështetur me rreth 2000 harkëtarë e shpatarë.

Një grup tjetër rezervë komanduar nga Kont Urani dhe Ajdin Muzaka, mbështeste forcat kryesore në rast të thyerjes apo dobësimit nga ana jugore e fushës. Luftimet në afërsi dhe dyluftimet trup me trup i hoqën mundësinë e përdorimit të harkëtarëve dhe shigjetarëve osmanë për dëmtimin e forcave të Lidhjes. Forcat e Lidhjes, duke e njohur më mirë terrenin, luftonin me mësymje të shpejtë dhe tërheqje duke e futur ushtrinë osmane në kurth vdekjeprurëse.

Goditja ballore e Skënderbeut dhe mbështetja nga Vrana Konti dhe Ajdin Muzaka, si dhe goditjet anësore dhe prapa nga Moisi Golemi e Hamza Kastrioti bënë që ushtria e Ali Pashës të luftojë në disa fronte duke lënë në fushën e betejës me mijëra të vrarë dhe robër.

Kujtojmë se komandantë si Skenderbeu, Hamzai, Ajdini dhe Moisi Golemi, vinin nga rradhët e jeniçereve dhe ishin ushtarakë profesionistë që e njihnin me rrënjë taktikën e luftës së forcave osmane.

Shumë autorë flasin për 15000 të vrarë dhe mijëra robër. Një shifër me unifikuese është se kjo betejë përfundoi me 12000 ushtarë osmanë të vrarë dhe 2-3000 robër. Nga ushtria e Lidhjes rreth 2000 të vrarë (Në disa autorë 150 të vrarë, shifër jo e saktë).

Nga forcat e Lidhjes u plagos rëndë dhe vdiq në këtë betejë Ajdin Muzaka.

Nuk ka dokumente historike, por shumë autor dhe gojëdhëna thonë se Ali Pasha u kap rob i fshehur në një ferrë afër Drinit, ku në breza është quajtur "Ferra e Pashës". Tjerë

Zgjedhja e Fushës së Torviollit për t'u përballur me ushtrinë e Sulltan Muratit të II, rrit krenarinë e të gjithë shqiptarëve dhe në veçanti të popullsisë së Çidhnës dhe Dibrës mbarë.

përshkruajnë se ushtria e Ali Pashës, në ikje e sipër u sulmua dhe gjatë rrugës në kthim, dhe përfundoi e përgjysmuar në Shkup dhe më vonë në Ederne, duke i raportuar humbjen Sulltan Muratit të II-të.

Shumë autorë (përfshi dhe M.Barletin) përshkruajnë se ushtria e Lidhjes mori plaçkë të madhe lufte, flamur, veshje dhe armatime dhe shpërbleu komandantët dhe ushtarët që u dalluan për trimëri. (Zakonisht ky ishte dhe parim i shumë ushtrive mesjetare në beteja). Me përfundimin e kësaj beteje, ushtria e lidhjes u fuqizua më shumë armatime e pajisje kapur ushtrisë osmane. Skënderbeu, pas kësaj beteje arriti të formojë një ushtri me mbi 15 000 luftëtarë, me të cilët u nis për në Krujë.

Lidhja e Lezhës provoi rezultatin e bashkimit dhe doli më e fortë për t'u përballur në beteja të tjera kundër hordhive osmane.

Kjo betejë u vlerësua nga shumë vende të Ballkanit, Europës dhe Vatikani. Kujtojmë se shumë beteja të tjera që u zhvilluan në Ballkan përfunduan me humbje, si në Fushë Kosovë dhe Nish, ku kishin luftuar koalicione midis shtetesh e principatash të fuqishme të Europës Qëndrore dhe Ballkanit.

Fitorja e Skënderbeut në betejën e Torviollit ishte një fitore historike dhe guri i brilantit në gjerdanin e fitoreve të tij për 25 vjet rresht kundër hordhive osmane.

Zgjedhja e Fushës së Torviollit për t'u përballur me ushtrinë e Sulltan Muratit të II, rrit krenarinë e të gjithë shqiptarëve dhe në veçanti të popullsisë së Çidhnës dhe Dibrës mbarë. Kjo nuk ishte një rastësi. Kjo krahinë i vazhdoi traditat e saj luftarake në shekuj për mbrojtjen e trojeve të veta, kundër perandorisë Osmane, Serbisë e forcave të tjera pushtuese duke dhënë një kontribut historik në mbrojtjen e trojeve shqiptare dhe formimin e shtetit shqiptar.

Çidhna dhe Dibra, në breza do krenohen me historinë e tyre të shkruar me gjak e sakrifica.

HYSEN REPA

Qershor 2014

homazh

Homazh për infermieren Rahime Elezi - shembull për të gjithë

Në punën e saj Rahime Elezi ka treguar profesionalizëm, humanizëm të lartë në shërbim të pacienteve të saj, dhe ka qenë një shembull i mirë për të gjithë kolegët.

Këto ditë u nda nga jeta znj. Rahime Elezi, e cila për rreth 40 vjet, me bluzën e bardhë shërbeu ditë e natë të sëmurëve që nga Dibra deri në Tiranë.

Rahime Elezi (Kaziu) u lind në fshatin Shenlleshen të komunës Zallë-Dardhë. Ajo mbaroj arsimin e mesëm mjekësor. Që nga viti 1973 deri në vitin 1996 ajo ka shërbyer në spitalin e Sllovës.

Pas kësaj periudhe ajo ka shërbyer pranë poliklinikës nr. 7 në Kodër –Kamez në Tiranë në detyrën e infermieres dhe kryeinfermieres.

Në punën e saj ajo ka treguar profesionalizëm, humanizëm të lartë në shërbim të pacienteve të saj, dhe ka qenë një shembull i mirë për të gjithë kolegët.

Kur bisedon me kolegët e saj, ato shprehen se Rahimja ishte një specialiste mjekësie. Mjekët kanë mësuar shumë nga eksperienca e saj, dhe në veçanti nga mënyra se si ajo komunikonte me pacientët, duke ua lehtësuar sado pak sëmundjen.

Në nje ëtakim që kam patur para disa kohësh me të ndjerën Rahime Elezaj, në bisedë e sipër më tregoi një histori rrënqethëse të punës saj.

"Në dimrin e madh të vitit 1985, më 2 janar, isha turni i natës në spitalin e Sllovës. Pas një nate ku ra shumë borë, dhe desh u rrezikuam nga shembja e çatisë së spitalit, të nesërmen në mëngjes u njoftuam se në fshatin Zall-Kalis një gruaje në lindje i rrezikohej jeta. U njoftua që të vinte helikopteri nga Tirana për ta marrë, por koha ishte shumë e keqe, dëbora kalonte mbi 2 m, mjegulla ishte shumë e dendur dhe helikopteri nuk mund të ulej në këtë zonë.

Unë, - tregonte Rahimja, sëbashku me shoqen time të punës, Xhevrie Shehun, vajtëm në fshatin Zall-Kalis tek e sëmura, ku qëndruam mbi 10 dite, duke i bërë një shërbim intensiv mjeksor, duke I shpetuar jeten gruas dhe femijes..."

Për merita në punë ajo është dekoruar nga Presidiumi i Kuvendit Popullor.

Rahime Elezi, kjo punonjëse e palodhur, me një shpirt të madh humanist, ka shërbyer natë e ditë në Kodër-Kamëz, aq sa njerëzit e identifikonin me Nënë Terezën. Ajo u sëmur rëndë dhe disa herë u shtrua në spitalin Nr.1 në Tiranë, por shërbimi në këtë spital, siç tregon i shoqi, nuk iu bë siç Rahimja u shërbentë të sëmurëve të saj".

Rahimja ishte jo vetëm një punonjëse e aftë, humaniste dhe e palodhur, por edhe një grua, një nënë dhe një bashkëshorte e shkëlqyer. Ndaj për në banesën e fundit e përcollën qindra njerëz, nga Dibra dhe Tirana.

E kujtojmë me respekt këtë punonjësë të palodhur, këtë mjeke të palodhur, këtë grua humane! U prehtë në paqe!

Ilmi Dervishi

Më shumë se 500 dibran i dhanë lamtumirën e fundit birit të tyre **Blerim Miftari**

STATEN ISLAND NY: Në pëcjelljen e tij, për në jetën e amnueshme familja Miftari - të afërmit e tij, miqt, dashamirët dhe shokët e tij të fëmijërisë - mbarë komuniteti dibranë në zonën e Tri_Shtetshit, me të gjitha ritet fetare, i dhanë lamtumirën e fundit 33 vjeçarit Blerim Billy Myftari.

Blerim Billy Miftari, 33 vjeçar vdiq në mënyrë paqësore në spitalin University Hospital (Bergen -Newark NJ) më 28 korrik 2014 i rrethuar nga ana e nënës, vëllezërit, motrat dhe anëtarët e tjerë të familjes së tij të dashur.

Furnerali i tij u zhvillua në shtëpinë mortore të Qendrën Islame Kulturore Shqiptare (AICC), në Canal Street në Staten Island - dhe e kryen liderit fetar të kësaj xhamie. Kurse, varrimi i tij mbas faljes së xhenazes u krye në varrezat e Xhamisë së Staten Islandit në ROUT- 33 në kantonin Milestone të New Jersey-t.

Kjo dhimbje e madhe, lidhet me prejardhjen e tij familjare, me ardhjen e tyre në SHBA, punën e shqiptarëve të Amerikës - ashtu si të gjithë emigrantët e tjerë, të cilët e kan nisur jetën e tyre në diasporë, që nga punët e vështira dhe deri tek suksesi dhe kontributi i tyre për kombin tonë.

Mbasi, kan qenë më shumë se 500 dibran që i dhanë lamtumirën e fundit birit të tyre - dje në mesditë duke shprehur edhe një herë respektin e madh për këtë të ri shqiptarë, që vdiq në lule të moshës së tij - në mërgim. "Çka tregon tha veprimtari i komunitetit Rrape Ruci, jo vetëm atë se sa respekt kan dibranët për familjen Miftari - por se shqiptarët e Amerikës, janë shumë të lidhur me njeri tjetrin pa dallim feje apo krahine - shqiptarët e Amerikës, shtoi Ruci, dinë të ndajnë të mirën dhe të keqen me njëri tjetrin si një familje e madhe me gjak shqiptari ".

Të njëjtën përshtypje me Rucin, dhe të gjithë kortezhin pothuajse ndau me këtë rast dhe një i afërt i famijes Miftari - veprimtari Bedri Sela - teksa mes dhimbjes që e kapluar - shprehu respektin e tij të thell për këtë djalë, që ishte si tha ai "shembull i dashurisë, dhe respektit, tek të gjithë atë që patën rastin t'a njohën, atë, si nga familja, e tij por edhe nga të afërmit, miqt dhe shokët e tij - familjes i iku një pjesë e trupit të tyre



Blerim Billy Miftari, ishte pjestar i familjes Miftari, një familje dibrane me tradita të vyera patriotike, e cila gëzon një respekt të veçantë nga i gjithë komuniteti shqiptar në SHBA. Ai ishte një i ri nga kjo familje, që ka vazhduar të zgjerojnë të kuptuarit e njerëzve dhe kulturave të ndryshme në komunitet, duke vënë në rend të parë familjen, kombin e tij dhe më gjerë...

- kurse, miqve dhe shokve një i dashur dhe mik i tyre, për jetë" tha Sela.

Dhjetra qytetarë ishullorë në Staten Island në sheshin para lokalit Pronto Pizza - në mbrëmje dhe gjatë gjithë ditës, ndezën qirinjë, dhe vendosën lule dhe kartolina, me fotografinë e tij duke u lutur për shpirtin e tij .

Fëmija i dashur më i vogli i Tasim Miftarit - një emigrant nga Dibra, i cili emigroi në SHBA, pesë dekada më parë, u nda nga jeta pas një sëmundje të shkurtër dhe të pashërueshme, thanë mjekët.

I lindur 14 Tetor 1981 në ishullin e Dibranëve - Staten Island, ishte fëmija i fundit i prindërve Tasim dhe Laze Miftari. Blerimi mori kurse në teknollogjinë kompjuterike, duke fituar një diplomë dhe u bërë një webmaster - mjeshtër i faqeve në internet. Ku ai dizenjoi faqen e internetit të kompanisë së familjes së tij me 5 lokalet e njohura të pica restoranteve Pronto Pizza - në ishullin e Staten Island.

Ndërkohë, gjatë jetës si një qytetar i këtij ishulli, ai u bë me shumë miq dhe shok, shqiptarë, por edhe amerikan dhe komuniteteve të tjera. I njohur për përgatitjen e tij të plotë, webmaster dhe teknologjinë kompjuterike, u dallua sidomos kur ai dizenjoi spotin televizivë në televizionin lokal të ishullit Staten Island - për 5 dyqanet Pronto Pizza. Pronto Pizza - me të pestë lokalet e saj në Staten Island - thuhet se ka qenë e përfshirë e ndihmat që u mblodhën komuniteti i këtij ishulli - për përballimin e dëmeve të shkaktuara nga stuhia Sandy në vitin 2012.

Veprimtari Ylber Pilku, tha se "Blerim Billy Miftari, ishte pjestar i familjes Miftari, një familje dibrane me tradita të vyera patriotike, e cila në komunitet gëzon një respekt të veçantë nga i gjithë komuniteti shqiptarë në SHBA . Ai ishte një i ri nga kjo familje, që ka vazhduar të zgjerojnë të kuptuarit e njerëzve dhe kulturave të ndryshme në komunitet, duke vënë në rend të parë familjen e tij - kombin e tij dhe më gjerë."

Ish kryetari i Komunës Dibër e Madhe, zoti Imer Ollogu - në librin e ngushëllimeve në rrejtin social facebook shkruan " Familja Miftari, shumë vështirë për të gjetë fjalë për ngushllim, por unë do të vazhdoj t'i ruaj kujtimet e mira nga kontaktet me Blerimin R.I.P. për t'a ngushlluar vehten. Mendoj se të paktën edhe Ju duhet t'a provoni të njëjtën, për të gjetur "qetësinë" e duhur. Atij do i shëndris jeta në Parajsë sepse ashtu ishte edhe në këte botë. Të rroni ju që ta kujtoni Blerimin" shkruan Ollogu.

Beqir SINA

Do na mungojë **Fisniku** me fisnikërinë e tij!

Unë nuk e kam takuar Fisnikun! Nuk kam folur asnjëherë drejtpërdrejtë me të, por kjo nuk na pengoi të mos bisedonim dhe shkëmbenim mendime. Të komunikonim mes emaileve ishte një kënaqësi e madhe, jo vetëm për mënyrën se si i sillte çështjet, por edhe për kulturën që i trajtonte ato, prekjen e problemit, por edhe tolerancën dhe mirëkuptimin. Ai, së bashku me vëllezërit e motrat, ishte një aktivist për sensibilizimin e çështjes së Rrugës së Arbërit dhe për probleme të tjera që pengojnë Dibrën për t'u zhvilluar dhe integruar!

"Dibra jonë këndej po t'kurret, ekonomikisht, demografikisht dhe në çdo aspekt tjetër zhvillimor dhe kulturor, por brezi ynë, edhe pse në masë të larguar nga vendlindja, mbetet jetësisht e interesuar për të." Qëllimisht nuk përdora frazën 'fatin e saj', sepse shumë nga ne, edhe me fjalët që përdorim, përpiqemi t'i ikim fatalitetit, si kategori sociale dominuese ndër shqiptarë.

Dibranët e kësaj ane momentalisht i mundon edhe fakti se po planifikohet ndërtimi i hidrocentralit të Urës së Boshkut, i cili sipas ekologëve, do ta shkatërrojë ekosistemin e kësaj ane, ngjashëm siç bëri ndërtimi i hidrocentralit të Spiles 40 e sa vjet me parë. Këtë çështje përpiqemi ta ngremë si problem. Sa do ta arrijmë është pikëpyetje e madhe dhe a duhet mjaftuar me kaq? Diçka duhet bërë, së paku për të mos humbur tërësisht besimin", - shkruante ai një email pak muaj më parë.

Fisniku ishte edhe një aktivist për çështjen e rrugës së Arbërit. Ashtu si babai i tij, Shehat Marku, rrugën e Arbërit e kishin njërën nga ëndrrat e mëdha.

Dhe kjo ëndërr nuk ishte një ëndërr ndërtimi rruge, por ëndrra e bashkimit të trojeve shqiptare. Ai u angazhua për mbledhjen e firmave për peticionin e Rrugës së Arbërit, në takime të drejtpërdrejta me zyrtarë të qeverisë së Shkupit dhe partive shqiptare atje. Dha ide për aktivizimin e biznesit në këtë proces.

Kur humbëm Fisnikun nuk e besova! Në fillim mendova se do të ishte ndonjë aksident, por më pas mësova prej miqve të tij se kishte 13 vite që vuante nga një sëmundje e rëndë! Por ai asnjëherë nuk e shfaqi, nuk u dorëzua! Edhe kur ishte i sëmurë në shtrat, më tregonte një kushëri i tij, ngrinte gishtin lart për të treguar se "Mos u mërzisni, mirë jam!"

Numrit të telefonit nuk i rashë kurrë t'i dëgjoja zërin! Por brenda meje e shoh dhe e ndjej se do na mungojë Fisniku me fisnikërinë e tij!

U prehsh në paqe Fisnik Marku!

Bujar Karoshi

PANAIRI I LIBRIT I AUTOREVE DIBRANE



Botimet M&B në bashkëpunim me Qendrën Kulturore Peshkopi, në kuadër të zhvillimit të edicionit të 20-të të Odës Dibrane, do të organizojnë në Peshkopi në datat 2-5 Tetor 2014, PANAIRIN E LIBRIT TË AUTORËVE DIBRANË.

Ftohen autorët dhe Shtëpitë Botuese që të marrin pjesë me botimet e tyre në këtë festival.

Për më shumë informacion:

Tel. (04) 22 33 283
069 20 68 603
068 65 08 441
067 30 73 265
E-mail: mbbotime@gmail.com

Pajtohu në gazetën *RRUGA E ARBËRIT*

***Merr versionin* PDF ose kopjen print duke filluar me 50 lekë/muaj**




Gazeta ofron faqet e saj për REKLAMA apo NJOFTIME të ndryshme për biznese dhe individë.

ÇMIME TË ARSYESHME
për faqet me ngjyra dhe bardh e zi.


Për individët, njoftimet deri në 50 fjalë (1/16 e faqes) ofrohen falas!

Për informacion:
E-mail: rrugaearberit@gmail.com
Tel: +355 69 20 68 603



Firmos *dhe* **komento peticionit** *në* **change.org**

http://www.change.org/en-GB/petitions/complete-the-construction-of-the-arb%C3%ABri-road-nd%C3%ABrtoni-sa-m%C3%AB-shpejt-dhe-me-standarde-rrug%C3%ABn-e-arb%C3%ABrit?utm_campaign=petition_created&utm_medium=email&utm_source=guides



Të gjitha informatat me rëndësi, si shkrime, intervista, lajme, video dhe audio, lidhur me mbrojtjen e lumit Radika mund t'i gjeni në:
http://saveriverradika.com

cyan magenta yelloë black